ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 10 KORRIK 2021. NUMËR 138 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

(Biseda është pjesë e serisë "Letërsi Ballkanike-Letërsi Botërore". Kjo bisedë është zhvilluar në 13 Janar 2021 në Universitetin e Humboldt-it, Berlin. Belfjore Qose është profesoreshë e Letërsisë Botërore sh. XX, pj. 1 dhe e Letërsisë Ruso-Sllave në Universitetin e Tiranës. Vesna Goldsworthy është profesoreshë e "Shkrimit krijues" në Universitetin e Ekseterit dhe në Universitetin e Anglisë Lindore. Christian Voss është profesor dhe shef i Departamentit të Studimeve Sllavo-Jugore në Universitetin e Humboldt-it, Berlin, si dhe drejtor dhe themelues i Qendrës "Përtej kufijve".)

EKZOTIZMI MES EUROPËS DHE BALLKANIT ËSHTË I DYANSHËM

(fq2-4)

Kjo bisedë është zhvilluar në 13 Janar 2021 në Universitetin e Humboldt-it, Berlin.

In memoriam: PETRIT RUKA

POET I FJALËS, I POEZISË SË BUKUR

Nga Sadik Bejko (fq.14)

Kur na ikën një poet, një mik, një bashkëkohës, nuk ka gjë më të mirë se të kthehesh e të lexosh edhe një herë poezinë e tij. E lexon me ndalesa nga gulshet që befas të mblidhen në grykë. I ke lexuar më parë, i ke dëgjuar dhe të recituara nga kolegu yt poet...

"Kronikat e Mjegullës" i Bashkim Hoxhës, botohet në rumanisht

HISTORIA NË SHNDËRRIMET E MJEGULLËS

Nga Cristiana Maria Hâncu (fq.9)

"Autoportret me teleskop" i Besnik Mustafajt botohet në greqisht

NJË ROMAN PËR "KONFLIKTIN" NDËRMJET POLITIKANIT DHE SHKRIMTARIT

Nga Emilio Solomou (fq.8)

Tregimi i Kadaresë, "Ur-Libri" dhe 1986, vitvdekja e Jorge Luis Borges

""UR-LIBRI" DHE VITI 1986

Nga Enver S. Morina (fq. 16)

Romani "Pragu i braktisjes" i Andreas Dushit

MOSHA E SHKRIMTARIT, KUR ROMANI I NJË TË RIU ËSHTË VËRTET I RI...

Nga Visar Zhiti (fq. 10)



Ese për poezinë e Jeronim de Radës

NJË NGJYRË ME EMRIN DASHURI

Nga Rudolf Marku (fq. 13)

Jeronim de Rada, duke qënë poeti më i talentuar i poezisë lirike shqiptare, dhe poeti më origjinal i saj, është njëkohësisht dhe poeti më i keqshpjeguar në letrat shqipe. Poema e tij " Skenderbeu i Pafan,, (i Pafat) duket si një referencë e ndjellshme e fatit të vetë Poetit dhe e vepres së tij.

KËSHILLA TË MREKULLUESHME NGA 25 AUTORË TË FAMSHËM MBI ARTIN E TË SHKRUARIT

Nga Emily Temple (fq.20)

PSE ROMANI "NJËQIND VJET VETMI" ËSHTË PËRJETËSISHT I DASHUR

Nga Veronica Esposito (fq.18)

BIBLIOTEKË

Franz Kafka (fq. 19)

Bisedë me të dehurin

Petrit Ruka (fq. 14)

Shami të zeza qiellore

Ndahet nga jeta shkrimtari i njohur qipriot,

PANOS IOANNIDES

Nga Ombra GVG (fq.7)

Biografia e Jovan M. Bizhytit për Gjeneral Spiro Moisiun

NJË BIOGRAFI QË NA E JEP TË PLOTË FIGURËN E GJENERAL MOISIUT

Nga Prof. Dr. Nasho Jorgaqi (fq.9)

(Biseda është pjesë e serisë "Letërsi Ballkanike-Letërsi Botërore". Kjo bisedë është zhvilluar në 13 Janar 2021 në Universitetin e Humboldt-it, Berlin. Belfjore Qose është profesoreshë e Letërsisë Botërore sh. XX, pj. 1 dhe e Letërsisë Ruso-Sllave në Universitetin e Tiranës. Vesna Goldsworthy është profesoreshë e "Shkrimit krijues" në Universitetin e Ekseterit dhe në Universitetin e Anglisë Lindore. *Christian Voss është profesor dhe shef i Departamentit të Studimeve Sllavo-Jugore në Universitetin e Humboldt-it, Berlin, si dhe drejtor dhe themelues i Qendrës "Përtej kufijve".)*

EKZOTIZMI MES EUROPËS DHE BALLKANIT ËSHTË I DYANSHËM

Vesna Goldsworthy është profesoreshë e "Shkrimit krijues" në Universitetin e Ekseterit dhe në Universitetin e Anglisë Lindore. Në librin e saj të parë "Shpikja e Ruritanisë, Imperializmi i imagjinatës" (1998) ajo zbaton paradigmën konstruktiviste dhe orientaliste në Evropën Juglindore dhe përshkruan stereotipat për Ballkanin në shënimet e udhëtimeve të evropiano-perëndimorëve dhe në kulturën popullore që nga miti i Drakulës. Një përmbledhje e ngjeshur e këtij libri referencial mund të gjendet në antologjinë "Ballkani dhe kufijtë mendorë", botuar në gjermanisht në vitin 2004 nga Karl Kaser në enciklopedinë austriake Wieser. Lexuesi i vëmendshëm mund ta kuptojë edhe vetëm nga titulli se, që njëzet vjet më parë, Goldsworthy shumë më tepër dhe shumë më krijuese nga një "akademike e zakonshme", kështu që ajo filloi të merrej me letërsi.

Libri i saj me kujtime i vitit 2005, "Luleshtrydhet e Çernobilit", tregon historinë e fëmijërisë dhe rinisë së saj në Serbinë jugosllave. Përkthimi gjermanisht me titullin "Heimweh nach Nirgendwo" ("Mall për askundin") u vlerësua shumë nga Elke Heidenreich-i, e cila pas karrierës së saj si artiste kabareje u bë mjaft e njohur si recensuese librash në televizione dhe radio të ndryshme. Libri u prit shumë mirë!

Poezia e Goldsworthit tek "Engjëlli i Selanikut" dhe tek romanet e saj të fundit, si "Gorsky" dhe "Monsieur Ka" transmetojnë përvojën e saj personale të migrimit, akulturimit, perceptimit ndërkulturor dhe të keqkuptimit në Londrën e Luftës së Ftohtë mes ballafaqimit të blloqeve Lindje-Perëndim. Romani i saj i ardhshëm "Perdja e hekurt" rrëfen për një lidhje dashurie mes lindjes dhe perëndimit, ndërmjet një princeshe "të kuqe" të privilegjuar në një shtet satelitor sovjetik në vitet 1980 dhe Iasonit, një poeti të ri të talentuar anglo-irlandez në fillimet e tij.

EKZOTIZIMI I DYANSHËM: EVROPA DHE BALLKANI

B. Qose: Po e nis bisedën me librin tuaj "wShpikja e Ruritanisë, Imperializmi i imagjinatës" në të cilin ju analizoni imagologjinë për Ballkanin nëpërmjet dy burimeve kryesore, imagjinatës letrare dhe kujtimeve të mirënjohura (kryesisht prej zonjave udhëtare), ku në të dyja rastet faktet përzihen me trillimin apo, së paku, ndikohen prej perspektivës. Më duket mjaft interesante që Ballkani është trajtuar si një hapësirë 'ekzotike', kryesisht prej romantikëve, apo nisur vetëm nga imagjinata për *tjetrin*. Më lind pyetja "Sipas kujt është ekzotik?". Disa vite më parë përktheva një artikull të Kazuo Ishiguros menjëherë pasi ai fitoi çmimin Nobel në Letërsi, në të cilin ai shprehte me sinqeritet se kultura britanike i dukej 'ekzotike', me familjen mbretërore dhe tërë rregullat e ndërlikuara të sjelljes në shoqëri. Për këtë arsye, ai krijoi një protagonist tepër 'ekzotik' te romani "Dita e mbetur", duke qenë se ky personazh përfaqësonte për të thelbin e kuriozitetit të tij për kulturën britanike. Nga ana tjetër, letrarët dhe udhëtarët anglezë i konsideronin ekzotike vendet e Evropës Lindore që ishin ndikuar a ishin pjesë e kulturës bizantine dhe otomane. Kjo është një dukuri e vjetër ndërsa ne nuk kemi qenë të kujdesshëm për përgjegjësitë tona, si p.sh., vargjet e Bajronit për Ballkanin jepen mësim ende në shkollat tona pa ndonjë analizë kritike, a thua se ai synonte të përshkruante në mënyrë realiste shqiptarët e shekullit të 19-të! Çfarë mund të bëhet për t'i analizuar në mënyrë kritike këto burime të imagologjisë për Ballkanin në Evropën Perëndimore dhe, ç'është më e rëndësishme, si mund t'i vendosim ato në kontekstin e duhur duke kuptuar qëllimin, gjendjen dhe perspektivën e autorëve në kohën e tyre? Ju e arrini këtë nëpërmjet librave tuaj, por e kam fjalën për ndikuesit tek publiku i gjerë, media, shkolla etj.

V. Goldsworthy: Mund të trajtoj shumë çështje lidhur me këtë. Pikë së pari, ju keni shumë të drejtë kur thoni se unë kam prirjen të përqendrohem tek letërsia për Ballkanin. Deri më tani, kur u referohem teksteve joletrare, prirem të përqendrohem te gratë që shkruanin për Ballkanin. Edhe pse "Shpikja e Ruritanisë" tenton të jetë e kuptueshme për çështjen që mbulon, kur e nisa këtë kërkim, isha veçanërisht e interesuar për letërsinë e atyre shkrimtarëve që shkruanin për Ballkanin pa e vizituar kurrë atë.

Para se të merresha me letërsi, isha profesoreshë e Letërsisë Angleze dhe specialiteti im ishte shekulli i 19-të. Më tërhiqnin veçanërisht romancierët që shkruanin për Ballkanin pa shkelur kurrë në gadishull! Sa më pak të dinin ata, sa më të çinteresuar të ishin për Ballkanin, aq më shumë më interesonte letërsia e tyre. Doja të dija se çfarë dinin në të vërtetë këta shkrimtarë për Ballkanin kur thoshin se nuk dinin asgjë. "Nuk di asgjë për Ballkanin", por cila ishte ajo bërthamë dijeje që vijon të këmbëngulë? E nisa studimin tim në periudhën e fundit të 1980-ës duke u përqendruar kryesisht tek Rumania, me shkrimtarë që shkonin nga Bram Stoker-i e deri tek Olivia Manning. Doli që kjo na paskësh qenë një zgjedhje fatlume pasi, pa dijeninë time, historiania Maria Todorova po përgatiste librin e saj për Ballkanin dhe ajo u përqendrua kryesisht te shkrimet historike dhe faktuale. Pa e ditur, ne po plotësonim njëra-tjetrën nëpërmjet fokusit të ndryshëm akademik.

Isha veçanërisht e interesuar për këto paraqitje fiksioni sepse, duke jetuar në Angli, e dija se kanë një ndikim të pabesueshëm. Siç e përmenda më lart, ia nisa nga Rumania rreth tridhjetë vjet më parë. Do tregoj një moment anekdotik. Punoja në Kolegjin e Birkbeck-ut, në Universitetin e Londrës dhe mendova se tregoja kurajë nëse unë si serbe bëja një studim shkencor për përfytyrimin e Rumanisë nga britanikët, sepse asohere nuk kisha vajtur ende në Rumani dhe nuk flisja rumanisht. Por shumë prej kolegëve në Departamentin e Anglishtes menduan se e njihja Rumaninë në majë te gishtave dhe se mund të lexoja rumanisht.

Kjo situatë më dëshmonte qysh atëherë diçka për Ballkanin. Në departamentin e Anglishtes kombet ballkanike shiheshin pak a shumë



si të ndërkëmbyeshme. Kini parasysh që flasim për fundin e viteve '80: përpara luftërave në Jugosllavi dhe kur ende asnjë shtet ballkanik nuk ishte futur në BE. Po kështu, njëherë kishim të ftuar një akademik nga Universiteti i Budapestit dhe mua më kishin ftuar për të përkthyer! I njëjti përfundim i nxituar. Edhe njerëzit të miredukuar ngatërronin Beogradin me Bukureshtin e me Budapestin. Në njëfarë mënyre ishte argëtuese që mund të punoja për Rumaninë dhe të tjerët të mendonin se dija gjithçka për të.

Te Rumania (Bram Stoker-i dhe vampirët e tij, veçanërisht Drakula) gjeta bërthamën për projektin e librit tim të ardhshëm. Isha e vetëdijshme se në këtë anë të botës, në Britani, në Amerikë, mund të jesh katër - pesë vjeç në parashkollor, kur akoma nuk di shkrim e këndim, nuk di asgjë për Ballkanin por Drakulën e njeh! Ke dëgjuar për vampirët, ke dëgjuar për Transilvaninë. Po flasim për imazhe në hartën mendore të fëmijëve të parashkollorit. Kur vjen Halloween-i ata veshin maska dhe flasin për Transilvaninë. Drakula ishte pikënisje e natyrshme, pasi përfaqësonte mënyrën se si fiksioni i popullarizuar kolonizon imagjinatën e cilësdo moshe. Dhe ja si funksionon: Bram Stokeri ishte krejt i painteresuar për Ballkanin si rajon, i interesonte vetëm si ushqim për letërsinë e tij.

Letërsia e grave është një çështje tjetër, mund të mbaj një leksion të tërë për të. Më interesojnë gratë pjesërisht për shkak të interesit tim akademik feminist dhe kuptova se gratë angleze që vizituan Ballkanin (dhe Belfjorja që po flet me mua nga Shqipëria me siguri e njeh Edit Durhamin), mund të bëheshin "burra" nderi sapo shkelnin atje. Ato trajtoheshin me atë lloj respekti me të cilin trajtoheshin burrat dhe u jepej lirihyrje në vende në të cilat nuk kishin asnjë mundësi të futeshin në vendin e tyre. Pra, për gratë britanike Ballkani ishte një hapësirë lirie dhe fuqie që u mungonte në vendin e tyre. Edit Durhami është shembulli më i mirë. Veçanërisht, në fund të shekullit të 19-të, gratë bënin një jetë me shumë kufizime, p.sh., kujdeseshin për prindërit e tyre të moshuar sikurse dhe Durhami. Në shtëpitë e tyre ato ishin si në kurth dhe papritur shkonin në Ballkan dhe bëheshin versione femërore të Bajronit, meqë e përmendët.

Shtresa e tretë e pyetjes, meqë po përpiqem ta mbuloj të gjithën, ka të bëjë me mënyrën se si ne ballkanasit i konsiderojmë gjithë këto shkrime. Keni absolutisht të drejtë! Ju përmendët Bajronin dhe Shqipërinë, ndërsa për ish Jugosllavinë mund të përmendnim Tenisonin dhe Malin e Zi: në fakt neve na pëlqejnë këto portretizime romantike të vetes. Në njëfarë mënyrë, për ne, më e rëndësishme se çdo gjë është që na kanë vënë re shkrimtarë kaq të mëdhenj.

Thelbi i pyetjes suaj shumë komplekse, dhe do e përmbledh përgjigjen time, është: ekzotike sipas kujt? Ne jemi dyanshmërisht ekzotikë: për shqiptarët Bajroni është po aq i çuditshëm dhe ekzotik sa ata për të. Lexoj përmbledhjen në parathënien e "Luleshtrydheve të Çernobilit" dhe shoh të njëjtën gjë. Kur po shkoja në Angli, fqinja ime solli "Lartësitë e stuhishme" që të mbështeste mendimin e saj se në Angli do isha e mjerë, se moti anglez ishte i tmerrshëm. Në imagjinatën e saj, ai ishte vendi i shiut fshikullues dhe i shqopishtave të egra dhe ndoshta dhe i Heathcliff-it që vraponte përmes tyre drejt meje. Por ky ekzotizim i Anglisë, i parë prej qendrës së Beogradit, nuk ka pasoja politike. Fqinja ime nuk kishte asnjë fuqi, njësoj siç ne, si një vendi i vogël, nuk mund të kemi kurrë fuqi mbi Anglinë. Ndërsa sjellja britanike kundrejt Ballkanit ka pasoja politike që janë shumë më tepër ndikuese. Pra, ekzotizimi funksionon në të dy kahet, por mua më interesonte drejtimi i fuqisë.

C. Voss: Ju përmendët librin e Maria Todorovës "Të imagjinosh Ballkanin" (1997) që doli pothuaj në të njëjtën kohë me librin tuaj të botuar më 1998. Librat tuaj janë shumë të ngjashëm, por përplotësues, sepse Todorova thekson rëndësinë dhe efektivitetin e diskursit ballkanologjik ndërmjet politikanëve dhe vendim-marrësve. Pyetja ime shkon në skajet e ndërtekstorësisë. Po ju jap një shembull - vitin e kaluar grupi teatror kosovar i Qendrës Multimedia shfaqi një video me titullin "Kthimi i Karl May-t, një dramë argëtuese për popullin gjerman" në Volksbühne-in e famshëm, këtu, në Berlin. Ata kishin marrë shkas nga përshkrimet e jashtme negative dhe ekzotizuese të shqiptarëve të autorit të famshëm perëndimor, Karl May-t. Gjithsesi, askush nuk i njeh këto romane në Gjermani. Po përpiqem të them se pa ndërtekstorësinë, tekstet nuk kanë fuqi diskursive - ndaj ç›mund të themi për jehonën dhe rrezen ndikuese të teksteve që keni shqyrtuar në 1998, cila është situata në Britaninë pro—Brexit-it, a e ndikon kjo procesin e integrimit të Ballkanit Perëndimor deri më sot?

V. Goldsworthy: Nëse u kthehemi viteve '90, një nga gjërat e rëndësishme dhe ndoshta fatmira për bursën ballkanologjike, është se Maria dhe unë mbuluam territore të ndryshme, pa e njohur njëra-tjetrën. Frymëzimi im teorik mbështetej në radhë të parë në punët e Edward Said-it për orientalizmin. Artikulli i Milica Bakic-Hayden-it për orientalizmat e ndërfutura doli në vitin 1992, ndërsa unë isha në gjysmë të punës për doktoratën time, që më vonë do bëhej libri "Shpikja e Ruritanisë". Libri "Shpikja e Evropës Lindore" i Larry Woolf-it u botua kur unë po mbaroja doktoraturën: kjo më tregonte se diçka do të ndodhte.

Po të isha ballkanologe, do të kisha rënë në kontakt me konceptin e Maria Todorovës për librin që më parë. Kisha vetëm studimin e saj të 1987-ës në bullgarisht, një panoramë faktuale për shënimet e udhëtimeve të britanikëve. "Të imagjinosh Ballkanin" është një punë e pasur historike dhe një mbështetje e fortë edhe për librin tim. Unë vija nga rrethanat e bursës për Letërsinë Angleze, prandaj isha i interesuar për romanet angleze, veçanërisht për fiksionin, por gjithashtu edhe për mënyrën sesi ndikimi i fiksionit transmetohet dhe shkallëzohet nga fuqia e filmit.

Një prej tipareve të përbashkëta të shumë librave që kam shqyrtuar, qoftë "Drakula", qoftë "I burgosuri i Zendës", apo historitë e "Ekspresit të Orientit", është se në shumicën e rasteve romanet do të ishin harruar po të mos kishte qenë fuqia e filmave. Në shumë raste, mbi këta libra janë bërë dhjetëra filma, disa madje bëhen filma çdo dekadë dhe ritransmetohen. Ndonjëherë më duket se Drakula ribëhet çdo vit!

"Shpikja e Ruritanisë" në këtë kuptim merret me industrinë e madhe të argëtimit. Kam dëgjuar se po del një version i ri i "Vrasje

në Ekspresin e Orientit", nuk e di sa versione kanë dalë. Kur je nga ish Jugosllavia të duket e pabesueshme sesi një vend aq i mërzitshëm sa fushat e veriut mund të jetë vendngjarja e kaq shumë filmave. Vinkovci, vendngjarja e romanit të Agatha Christie-t është një kryqëzim hekurudhor. Më duket si Slough-i këtu në Angli. Meqë po flasim mes Tiranës dhe Berlinit: zgjidhni vendin më të mërzitshëm të Shqipërisë apo të Gjermanisë, ku takohen pesë rrugë hekurudhore dhe ai është Vinkovci juaj. Në realitet ai është qindra kilometra fushë, por në film është një vend ekzotik, malor, me dëborë të përhershme, ku ndodhin gjithfarë misteresh.

Vëzhgova fuqinë dhe rezonancën e filmit. Ju përmendët një çështje të rëndësishme për Karl May-n: nëse këto libra janë harruar, a duhet t'u isha kthyer dhe t'i ringjallja duke i bërë sërish të famshëm? Shumë prej romaneve që kam shqyrtuar janë të mirënjohur për shkak të ekranizimit, por me të vërtetë ka qindra të tjerë që u referohem tek "Ruritania" që janë tërësisht të harruar dhe më mirë që janë harruar. Shpesh, një shkrimtari i ecën fati me një roman me histori nga Ballkani: pas "Drakulës", Bram Stoker-i shkroi një roman të keq, ngjarjet e të cilit ndodhnin në Mal të Zi. Anthony Hope shkroi nja 6 romane pas Ruritanisë. romani i tij "Sofia e Kravonisë" është vërtetë i dobët.

Askush nuk i lexon më sot këto romane përveç studiuesve, pasi nuk janë cilësorë. Janë plot me paragjykime tronditëse. Ç'më duhej t'ua kujtoja njerëzve? Mund të pretendoja se ishte thjesht interes studimor, por në fakt jam fajtore sepse disa botues kanë ribotuar disa prej romaneve për të cilat ngjalla interes.

Nëse vërtet po punoja kundër paragjykimeve për Ballkanin, a nuk duhet t'i kisha hequr mënjanë ato romane dhe t'i lija të harroheshin në pluhurin e bibliotekave? Një prej arsyeve që nuk veprova kështu është sepse u trondita nga sasia e këtyre librave. Nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX kishte vite kur dilnin 20 apo 30 romane të mirënjohura në vit për Ballkanin. Dilnin nga shtypi gati çdo muaj! Etja për sensacionalizëm ballkanik nuk shuhej. Ishte si të thuash një përmbytje me tituj. Ballkani, ose siç quhej asohere Lindja e Afërt, ishte vendi i mirënjohur i misterit.

Lexuesit anglezë ishin krejt të pavetëdijshëm për këtë trashëgimi letrare, njësoj si gjermanët për produksionin për Karl May-n. Kur lexonin "Ruritaninë" ata pyesnin veten "Kush janë këta shkrimtarë? Vërtetë kishin kaq ndikim, kaq rëndësi?" Kishin, por për fat të mirë janë harruar.

Sa i takon Post-Brexit-it: nuk di çfarë të them, për mua personalisht është shumë e çuditshme të jetoj në një vend që e ka lënë Evropën, ndërsa vij nga një vend që kërkon dëshpërimisht të hyjë në BE. Kam një imazh të dyfishtë tërë kohës. Në Britani askujt nuk i intereson më se kush dhe kur futet në BE, ndërsa në Ballkan çështja e pranimit është dëshpërimisht e rëndësishme.

Në Angli sot nuk dëgjon më për Ballkanin dhe besoj se nuk ka gjë të keqe. Tek "Shpikja e Ruritanisë" kam cituar Barbara Jelavich-in kur thotë se Ballkani ka infektuar ndërgjegjen perëndimore në kohërat e luftërave dhe të dhunës, prandaj në këtë rast më mirë që jemi harruar. Në këtë kuptim të qenit në hije ndoshta është një fat më i mirë.

B. Qose: Tek "Shpikja e Ruritanisë" you analizoni diferencën mes përfaqësimit dhe krijimit të një imazhi të caktuar. ""Një kolonizim i tillë imagjinativ" i krahasuar me "kolonizimin ekonomik" duket si proces i pafajshëm: një fuqi kulturalisht më e madhe shfrytëzon burimet e një vendi, duke imponuar kufij të tjerë në hartën e tij mendore dhe duke krijuar ide, që duke reflektuar mbrapsht, kanë fuqinë të formësojnë realitetin." Është e qartë se kur një kulturë dominuese dhe ndikuese ka një imazh të caktuar për një kulturë tjetër, ajo ka fuqinë e pashmangshme për të krijuar hartën e saj mendore. Mua më intereson me të vërtetë për hartën mendore që krijon tek vetja individuale, përkatësisht tek ballkanasi që ndikohet prej një imagologjie të tillë. Shqiptarët, kur emigrojnë, largohen më së paku me pakënaqësi nga vendi i tyre dhe duan të ndihen pjesë e kulturës së re, të cilën ata e perceptojnë si superiore, prandaj ata fillojnë të besojnë atë që dëgjojnë për veten dhe vendin e tyre. Nga ana tjetër, ne e perceptojmë Evropën si një kulturë të largët, si një vend të ndryshëm edhe pse gjeografikisht jemi pjesë e këtij kontinenti. Të qëllon të dëgjosh prindër grekë që krenohen se fëmijët e tyre studiojnë në Evropë, ndërsa në Shqipëria media stërpërdor pyetjen "Kur do të futet Shqipëria në Evropë?" dhe jo "në Bashkimin Evropian"! Nuk mund të rri pa përmendur Ernesto Sabaton me romanin "Për heronjtë dhe varret", në të cilin ai, ironikisht, i referohet adhurimit që ka Borgesi për kulturën britanike "vetëm ai që nuk është evropian mund të jetë eurocentrist, ai që është evropian, është thjesht evropian". Si mund t'i shpëtojmë këtij kompleksi dhe vetes së imagjinuar që shtrembëron edhe faktet më të padiskutueshme për veten tonë?

V. Goldsworthy: Thelbi i punimit tim është kjo ide e përveçme e evropianizimit dhe ky lloj oshilacioni që përshkruhet kaq shkëlqyeshëm në pyetjen tuaj. Do thosha se kjo është disi e brishtë, pasi si koncepti i Ne dhe koncepti Ata, shkon e vjen, apo jo? Nuk e di si është në Shqipëri, por jam e sigurt që në ish Jugosllavi dhe, veçanërisht, në Serbi prej nga jam unë, ideja e superioritetit evropian shpërfaqet shpesh: mënyra si i bëjnë gjërat evropianët është superiore, më e civilizuar se e Ballkanit. Nëse shihet ndonjë sjellje primitive në transportin publik, njerëzit thonë: Ballkan! Nga ana tjetër, ka edhe një superioritet të brishtë për vendin e origjinës. P.sh. notat janë më të vështira për t'u marrë në Universitetin e Beogradit se në Perëndim, studentët tanë janë më të mirë se ata evropianë, shkollat tona janë më të mira, ne lexojmë më shumë etj. Ne duam që fëmijët tanë t'i bëjnë studimet e masterit diku në Perëndim edhe pse është mjaft e vështirë që kur të kthehen t'u njihen ato diploma siç duhet.

Ballkanasit e përkufizojnë veten gjithmonë si tashmë 'brenda Evropës', madje në zemër të saj (ballkanasit janë djepi i Evropës, evropianët e parë) dhe si të jashtëm që duan të futen dhe presin të pranohen. Ju thatë në pyetjen tuaj se Evropa është sinonim i BE-së. Kjo është e nënkuptuar edhe në konceptin relativisht të ri të Ballkanit Perëndimor. Duket sikur thjesht të të thërrasin "perëndimor" është një farë çmimi ngushëllues. A është Shqipëria në Ballkanin Perëndimor?

Duket për të qeshur, pasi nëse Serbia është në Ballkanin Perëndimor, ku është Ballkani Qendror? Ku është Ballkani Lindor? Vetë vendet ballkanike filluan të ndryshojnë, pasi BE-ja po luan me të njëjtat imazhe dhe paragjykime. Pra një grup vendesh në mes të gadishullit, duke filluar nga Shqipëria dhe duke u ngjitur drejt Serbisë, Bosnjës, si një vrimë në bagetë, apo simite, apo gjevrek (quajeni si të doni), na qenka papritur Ballkani Perëndimor. Sikur Todor Zhivkov-i dhe Nikola Çaushesku të ngriheshin nga varri, nuk do habiteshin. Harta mendore është pikërisht e tillë, diçka e përfytyruar, jo reale. Gjeografia imagjinare është pjesë e idesë sime për kolonizimin imagjinar, nuk mendoj se termi Ballkani Perëndimor, si i tillë, ka ekzistuar para viteve '90.

Kur shkrova së pari "Shpikja e Ruritanisë" pyesja veten nëse kisha të drejtë që e theksoja kaq shumë këtë ide, krahasimin e kolonizimit fizik - mënyrën si Britania me fuqinë e saj shfrytëzoi në mënyrë direkte disa vende të botës – me situatën e përfytyrimit të një vendi, shfrytëzimin e resurseve të tij me imagjinatë, duke përdorur një vend për vendngjarje për vepra letrare në dukje naive. Mendova a kisha të drejtë apo po e ekzagjeroja? Ma kanë marrë hakun në fakt, sepse shpesh kam parë sa shumë ndikohen dhe mbështeten proceset politike vendimmarrëse nga këto ide. Sigurisht që mund të mos jetë e njëjta gjë në mënyrë sipërfaqësore. Nuk është e njëjta gjë si kur shkatërrohet industria e pambukut në Indi, duke e përmbytur tregun me prodhime të lira angleze, apo kur Graham Greene-i shkruan një libër për një fshat plot baltë dhe e quan Suboticë, duke injoruar faktin që Subotica në të vërtetë është një qytet i bukur dhe i kulturuar i stilit art-nouveau. Por pasojat janë paralele. Kur merr vendimin që një qytet i bukur art-nouveau është një fshat plot baltë me njerëz primitivë, kjo duhet terezitur. Është analog në njëfarë mënyrë dhe po kaq tinëzar si veprim.

Belfjore, pyetjet tuaja bashkëpunojnë bukur në dy drejtime. Brenda Ballkanit ne i përdorim të njëjtat imazhe kundër njëri-tjetrit. Fqinji në veri apo jug është primitiv derisa shkon matanë detit. Pra, kur je në Slloveni dëgjon paragjykime për Kroacinë, në Kroaci për Bosnjën dhe Serbinë, në Serbi për Shqipërinë etj. I kemi brendësuar këto ide.

Nga ana tjetër, ju përdorni çështjen e qendrës dhe të periferisë dhe këtu dua të ndalem tek kjo çështje delikate. Po flisnim njëherë me mikun tim, shkrimtarin Afrikano-Jugor J. M. Coetzee, për idenë e qendrës dhe të periferisë dhe ai tha se teksa rritej në Cape Town gjithmonë kishte përshtypjen se po rritej në periferi, që kultura ndodhte diku tjetër. Mbaj mend se iu përgjigja duke rënë dakord, por edhe duke e kundërshtuar. Teksa rritesha në Beograd kisha idenë se po rritesha në qendër të diçkaje dhe mendoj se ky është avantazhi i të rriturit në një gjuhë dhe kulturë të vogël. Kështu që nëse rritesh në Shqipëri, ti je pikërisht qendra e asaj bote, e asaj kulture. Nuk je periferia e botës së madhe anglofone siç ndihet djaloshi apo vajza nga Afrika e Jugut. Në disa aspekte jemi me fat që jemi të ndryshëm, "tjetri", të vetëkënaqur, autoktonë.

B. Qose: Do doja të vijoja me imazhin simbolik të Ballkanit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes, ose siç shkruani ju "një mbivendosje hapësirash të imagjinuara". Ky është një prej imazheve më të qëndrueshme të gadishullit. Gjuhëtari më i mirënjohur shqiptar në Shqipëri, Eqerem Çabej, shkroi "Shqipëria mes Perëndimit dhe Lindjes" duke e theksuar këtë imazh nëpërmjet një analize historike, politike, gjuhësore e, mbi të gjitha, duke analizuar rëndësinë e kësaj hapësire si hapësirë kufitare. Tek "Ruritania" ju e shtjelloni këtë imazh simbolik "perandoritë lindore dhe perëndimore me kishat përkatëse, bota islamike dhe ajo e krishterë, komunizmi dhe kapitalizmi, të gjitha u takuan dhe u përplasën në Ballkan. Ndërkohë që vetë Ballkani mund të përfaqësohet si një shumësi periferish, të cilat tragjikisht i janë mbivendosur njëra-tjetrës, ku skajet, valëzimet e qendrave të mëdha perandorake jashtë këtij gadishulli takoheshin për të krijuar forma interesante edhe ndërsa fundoseshin; identitetet individuale ballkanike janë formësuar përgjatë shekujve prej idesë së një rezistence kufitare, në të cilën ato bazonin idenë e rëndësisë së vetes. Vende te ndryshme ballkanike simbolikisht e përkufizojnë veten nëpërmjet të qenit porta, ura ose kryqëzimi ndërmjet botëve të ndryshme." Si mendoni se e ka ndikuar kjo, si megalomaninë, ashtu edhe kompleksin e inferioritetit tek vendet ballkanike? Kujtoj këtu si e konsideronin raportin me këtë pozitë të Ballkanit Shën Sava dhe Despina Cristodoulu.

V. Goldsworthy: Në zemër të imazhit për veten është ideja e qendrës dhe e periferisë. Gjithashtu, studimi i perceptimit të të qenit "Lindja në Perëndim dhe Perëndimi në Lindje", meriton më shumë vëmendje se studimi i letërsisë angleze. Në letërsinë angleze gjendet ideja e Ballkanit si një periferi ekzotike dhe ngazëlluese, por gjithsesi mbetet periferi. Në Ballkan ideja e rëndësisë së madhe të vetes rrjedh nga të qenit në kufi. Kufiri na jep ndjesinë e qendrës. Ju përmendët idenë e mbrojtësve të Evropës, Antemurale Christianitatis (mbrojtësit e Krishtërimit), muri mbrojtës i Krishterimit kundër Perandorisë Osmane. Perandoria Osmane është vetë mes Lindjes dhe Perëndimit, pra, këto koncepte mbivendosen në vazhdimësi. Po sot a e mbron Ballkani Evropën nga hordhitë e emigrantëve? Po Turqia?

Ky perceptim për veten ushqen teoritë konspirative për të cilat kemi etje. Në një farë mënyre edhe kur jemi në periferi dhe të harruar, jemi në qendër të planeve politike. Ju evokuat një imazh të bukur dhe një ujëvarë metaforash, ku del se është më me vend të mendojmë nga brenda sesa nga jashtë. Në letërsinë britanike Ballkani është një periferi absolute, fundi i botës së njohur.

"Shpikja e Ruritanisë" dhe ideja e Ruritanisë: këtu ia vlen të përmend se Ruritania ka emigruar. Kur Anthony Hope shkroi romanin e famshëm "I burgosuri i Zendës", ai vuri re se mbretëria e Ruritanisë gjendej dy orë larg Dresdenit. Sot nëse kalëron dy orë në jug të Dresdenit nuk mund të shkosh më larg se Praga. Fillimisht, Ruritania nuk ishte në Ballkan, por në Evropën Qendrore.

Versionet e shumta të ekranizuara fillojnë me një hartë, por e ndryshojnë tërë vendin duke e çuar drejt Ballkanit. Premisa është që duhet të jetë një vend i panjohur dhe një vend ku britanikët sundojnë me superioritet elegant. E kuptohet, i vetmi vend me të cilin Evropa nuk ishte e njohur, ishte Ballkani.

Kur po redaktoja variantin përfundimtar të librit, nga Departamenti i Marketingut më propozuan që të ndryshoja titullin në "Shpikja e Transilvanisë". U përgjigja se nuk isha e sigurt nëse kjo ishte një ide e mirë, pasi Transilvania është një vend i vërtetë. Ata reaguan "Vërtetë?" Nëse njëzetë e pesë vjet më parë mendohej se Transilvania ishte një vend i trilluar, mund të vazhdonim duke futur në listë (në anglisht) Syldavia-n, Slavonia-n, Slovakia-n, çdo vend që në gjuhën angleze fillon me sl-, në hartën e Ballkanit.

URAT MES ZHANREVE

Ch. Voss: Mund të kalojmë tani tek shkrimet më të fundit të Vesnës. Më duket magjepsëse shkathtësia juaj për t'u përshtatur me zhanret: A e parashikoni rendin e librave tuaj? Çfarë kështillash do na jepnit nëse do donim të ishim shkrimtarë? A ka të bëjë kjo me zhvendosjen e horizontit dhe të përvojave tuaja në një zhanër tjetër, apo është e kundërta, ju fshini biografinë tuaj duke na dhënë një përmbajtje tjetër,

por të ngjashme? Për shembull tek "Luleshtrydhet e Çernobilit" kam gjetur paralelet e mëposhtme: Ju përmendni vjehrrin tuaj, i cili ishte ushtarak në Indi dhe pas çkolonializmit mbeti i pastrehë, ashtu si ju vetë në raport me ish Jugosllavinë. Elita teknokrate britanike gjendet tek romani "Monsieur Ka", tek familja e bashkëshortit të heroinës. Pyetja ime është: ky transferim është një teknikë e zakonshme për ju, apo ju thjesht përshkruani ambientin familjar në Britani?

V. Goldsworthy: Pyetjes suaj mund t'i përgjigjem në shumë mënyra, njëra më me humor se tjetra. Mund të thosha me shaka se shkova drejt zhanreve më komerciale sepse doja të nxirrja bestseller-a, të cilat kurrë nuk dalin nga puna akademike. Por e vërteta është më komplekse. Pasi shkrova "Shpikja e Ruritanisë" kisha idenë se po rropatesha duke kërkuar një temë të madhe për një ide të madhe. Kam përshtypjen se pas viteve '1990 – këtu ndoshta do duhej t'ju pyesja ju si më i vjetër në këtë fushë – koncepti i ballkanizmit dhe i studimit tim për imperializmin e imagjinatës tek "Shpikja e Ruritanisë" nuk ishte temë e madhe gjithëpërfshirëse, për sa i përket të fituarit të bursave.

Mund të bëhej padyshim një punë e shkëlqyer, por kurrë aq iluminuese dhe përtëritëse sa tërë ç'ndodhi përgjatë viteve '90. Sigurisht që nuk mund të gjeja diçka po aq frymëzuese. Mund të kisha bërë projekte më të vogla, por edhe pse u përpoqa ta vijoja kërkimin shkencor për njëfarë kohe, nuk gjeta ndonjë gjë interesante. Shpesh ndodh kështu kur boton një libër me shumë emër: të ftojnë për të dhënë të njëjtat leksione, shkruan pak a shumë artikuj të njëjtë, por unë nuk doja këtë gjë.

Lexova shënime udhëtimesh për Ballkanin prej shkrimtarësh nga vende të ndryshme, por nuk dukej se mund të bëja me to diçka të re, sigurisht sipas meje. Më tej ndodhi rrethana fatkeqe e diagnostikimit me kancer, që më ndryshoi jetën dhe atëherë vendosa të shkruaj kujtimet e mia për t'ia lënë tim biri. Për çdo rast! Mendova që nëse nuk mbijetoj, do lë pas librin e jetës sime, të vendit tim të zhdukur, disa fotografi dhe zërin tim në to. Nuk kisha ambicie, doja vetëm të bëja diçka gjatë kësaj periudhe të errët. Më befasoi suksesi që pati libri im shumë personal, që tregonte një jetë të zakonshme. Vetëm në Gjermani libri pati katërmbëdhjetë ribotime dhe u bë bestseller në shumë vende të tjera. U dha me seri në BBC dhe "The Times". Edhe "Shpikja e Ruritanisë" qe libër i mirëpritur, por tashmë po flasim për një shkallë krejt tjetër. U ekspozova shumë në TV, në shtyp, në shumë aktivitete, i flisja çdo herë një audience të re. Jam ngazëllyer, jam kënaqur shumë, më ka pëlqyer shumë.

Në atë fazë, prapëseprapë, po të më kishin pyetur nëse do i kthehesha sërish punës akademike, do kisha thënë "Po". Kujtimet e mia mendova se ishin produkt i betejës me kancerin, pra në njëfarë mënyrë u habita për marrëdhënien që më lindi me letërsinë në këtë moshë. Nuk e kisha parashikuar fare!

Studentët më pyesnin nëse do shkruaja skenarë filmash, ç'do bëja më tej. Mendonin se isha e varur nga ndryshimi i zhanreve. Në fakt lëvizjet e mëtejshme ishin të mirëmenduara dhe graduale. Në Angli kemi audit për kërkimin shkencor çdo gjashtë vjet, që do të thotë se nuk mund të japim mësim jashtë fushës për të cilën kryejmë kërkim.

Pra, sapo shkrova një libër të suksesshëm me kujtime, karriera ime akademike ndryshoi. U ndjeva e inkurajuar të jepja mësim Shkrimin Krijues. Në fillim e vura në dyshim nëse kjo disiplinë ishte akademike dhe nëse do më pëlqente, por përfundova duke e dashuruar. Së paku për mua, mësimdhënia e Shkrimit Krijues ishte një rikthim në fillimin tim, një justifikim për të dhënë mësim Letërsinë e Krahasuar. Letërsia Botërore, ashtu siç e konceptonte Gëte dhe siç jepet mësim ende në Zagreb dhe Beograd, ishte fusha e studimeve të mia parësore dhe e vetmja gjë që doja të bëja kur isha tetëmbëdhjetë vjeçe. Pasi i erdha rrotull për një kohë të gjatë, më në fund jap mësim autorët që kam dashur gjithnjë: Tomas Manin, Çehovin, Tolstoin dhe tërë autorët që preferoj dhe gjithë kjo vetëm sepse shkrova atë libër me kujtime. Logjika institucionale ma diktoi këtë lëvizje dhe, në fakt, unë po lulëzoj aty. Nuk mund të qahem.

Për t'u ndalur tek pjesa e fundit e pyetjes suaj, po, në romane unë përdor përvojat e mia dhe të gjitha përqendrohen tek ideja e mospërkatësisë. Si mund të përkasësh kur nuk ndjen përkatësi? Kjo është tema e përbashkët dhe të gjitha format e mospërkatësisë janë të habitshme. Ndonjëherë të huajt kanë rrënjë më të thella në Angli sesa vetë anglezët, ndihen si në shtëpi aty. Në të gjitha romanet unë ndjek një dëshirë që nuk mund ta artikuloja nëpërmjet punës akademike, që ka të bëjë me të shkruarit për Londrën, të jetuarit në Londër, të zbuluarit e kësaj përvoje. Romanet janë në njëfarë mënyrë produkt i një kërkimi të gjerë dhe të fshehtë. Më pëlqen shumë kjo gjë! Për shembull për romanin "Monsieur Ka" mund të kisha studiuar jetët e emigrantëve evropiano-lindorë në Londër rreth viteve 1940 me të njëjtin rigorozitet sikur të botoja në Yale Press një libër studimor, vetëm se, në këtë rast, kërkimi nuk ka citime dhe referenca. Ka një formë shumë të ndryshme.

Ch. Voss: Le të vazhdojmë me drejtimin e shkrimeve tuaja të fundit letrare dhe le ta kombinojmë këtë me perceptimet, që janë thelbi i "Ruritanisë". Tek "Monsieur Ka" ju e zhvendosni ardhjen tuaj nga Serbia në Angli nga vitet 1980 në 1940-ën dhe heroina është një hebre nga Franca, e cila takon bashkëshortin e saj nga Aleksandria. Romani ka një ndërtekstorësi të harlisur. Nga njëra anë na rrëfehet historia e Ana Kareninës prej të birit, nipit dhe djalit të nipit, i cili përfundon në Londër. Referencat e tjera janë nga "Zonja Bovari" e Floberit dhe "Zonja me kone" e Çehovit – tri vepra që kanë për heroina gra kurorëshkelëse. Gjithsesi ndërtekstorësinë më të madh e arrini në epilog nëpërmjet homazhit që i bëni personazhit të "Romanit të Londrës" (1971) nga Miloš Crnjanski, të cilin heroina e takon shkarazi në autobus. Po i përdor këto kryqëzime letrare për t'ju pyetur se ku e vendosni ju veten, ku e klasifikoni veten. A shkruani letërsi angleze, evropiane, apo serbe? Apo këto etiketime nuk kanë rëndësi për ju?

V. Goldsworthy: Nëse do thosha që këto etiketime nuk kanë kuptim për mua, do shpëtoja nga përgjigja e gjatë, por është e pamundur që të vetëklasifikohem kaq lehtë. Nëse kërkoni në internet për mua do të shihni se më referohen si shkrimtare serbe (dikur quhesha shkrimtare jugosllave, pastaj ish jugosllave), por meqë shkruaj anglisht nuk përfshihem dot në çmime letrare serbe dhe nuk bëhem dot anëtare e institucioneve të nderit për shkrimtarët në Serbi etj. Jam e tillë në Angli, por Anglia e preferon trupën e shkrimtarëve të saj sa më ndërkombëtare. Praktikisht trajtohem si më shumë e huaj se ç'jam në të vërtetë, pasi bëj pjesë në një kulturë ku nëse gjenden dhjetë shkrimtarë në një dhomë, secili duhet të jetë nga një vend i ndryshëm. Pra, më kanë bërë më serbe se ç'jam në Serbi!

Gjithsesi, kur shkoj në Serbi më prezantojnë si shkrimtare angleze. Në vitin 2005 hapa Panairin e Librit të Beogradit, ku Anglia ishte vend nderi, si shkrimtare angleze, përfaqësuese e Anglisë. Pastaj, teksa jepja intervista për këtë eveniment, gazetarët më pyesnin "Çfarë mendoni ju si shkrimtare serbe?". Jam si kukullat ruse, hap njërën dhe gjen tjetrën.

Shpesh ndodh që Këshilli Britanik, apo ndonjë trupë tjetër britanike më dërgon nëpër ture në Evropë për të prezantuar veprën time si një prej zërave të rinj të letërsisë angleze, por kur shkoj nëpër konferenca shtypi gazetarët më pyesin për situatën në Serbi apo Mal të Zi. Kjo mund të jetë disi edhe një çështje institucionale: nëse një student do të studiojë letërsinë time, ku duhet ta studiojë atë? Për momentin ka dy doktoratura për letërsinë time dhe studentët në fjalë punojnë në një kontekst ndërdisiplinor, sepse nuk ka një departament që t'i marrë. Kjo situatë mund të jetë problem për të ardhmen e tyre profesionale. Universitetet, duke qenë vende të disiplinuara, preferojnë që ne të sistemohemi në kuti të ngushta, edhe pse letërsia ndërnacionale është letërsia e ditës sot. Unë jam një model dhe jo një përjashtim. Ka shumë shkrimtarë pikërisht si unë që nuk i përkasin një vendi ose një tjetri. Unë i përkas letërsisë angleze sepse unë shkruaj në anglisht, por letërsia ime nuk mund të studiohet vetëm në atë kontekst.

Si për ta vërtetuar këtë, ju bëni një pyetje shumë të mirëlidhur me Crnjanski-n dhe referencat ndërtekstore. Një romancier ruso-amerikan në recensën e tij për "Monsieur Ka", në Los Angeles Review of Books, e krahason romanin me një gjëzë të adhurueshme. Dashuruesit e vërtetë të Tolstoit kërkojnë shenja të shpërndara nëpër roman me kaq kujdes, sa gjetja e referencës së ardhshme duket se shpërblen gjithnjë gjuetarin. Por veç pak prej lexuesve perëndimore, apo edhe rusë, mund të kapin një mori referencash të fshehta prej "Romanit të Londrës" të Crnjanski-t.

Ngjarjet e romaneve tona vendosen në të njëjtën epokë. Princi Rjepin, personazhi kryesor i Crnjanski-t shfaqet si një pasagjer i paemër në një autobus në Londër. Lexuesi serb mund ta kapë këtë përshkrim fizik, por për lexuesin perëndimor ky përshkrim nuk mbart ndonjë kuptim. Për ditë të tëra kërkova në Bibliotekën Britanike reklamat në autobusët e Londrës për të gjetur fjalën e saktë që shkon me përshkrimin e romanit të Crnjanski-t. Ai përmend vetëm vizatimin e një zogu emu. U bëra pothuaj detektive e gjurmëve të Crnjanski-t: a e kishte trilluar vetë reklamën? Familja ime më ngacmon duke më thënë se jam e specializuar në projekte kërkimore të panevojshme. Mund të rri pesë a gjashtë ditë në bibliotekë duke studiuar nëse disa fjali në roman janë ashtu siç duhet.

Gjëja më e vështirë tek "Monsieur Ka" ishte rindërtimi i anglishtes së vitit 1947, veçanërisht i anglishtes së emigrantëve nga Evropa Lindore. Sikur nuk mjaftonte që duke shkruar në anglisht ia kisha bërë të vështirë jetën vetes, zgjodha të shkruaj në anglishte historike. Papritur kupton se fjalë të caktuara që të nevojiten, asohere nuk përdoreshin akoma. Për shembull në 1947 nuk përdorej gjerësisht fjala "ghostwriter", shkrimtar fantazmë, që shkruan vepra për dikë tjetër. Bëra fjalë me redaktorin tim në mund ta përdorja apo jo. Shkrimi i kësaj vepre në nivel gjuhësor ishte më i vështirë se i librave të mëparshëm. E tillë është marrëzia nga e cila vuajnë akademikët kur duan të përdorin tërë aftësitë e tyre studimore tek shkrimi i romaneve.

B. Qose: Në kinema nuk ndodh aspak kështu. Netflix-i e përshtat anglishten në atë të ditëve tona aq sa habitesh se çfarë dëgjon herë pas here.

V. Goldsworthy: Në një prej diskutimeve tona, redaktori u përpoq të më bindte duke më thënë: "Nëse e përfshin këtë fjalë në roman, Fjalori i Anglishtes i Oxford-it do ta përfshijë vitin e ardhshëm, duke të vënë ty në referencë". Po e bëj vetë anglishten time! (qesh)

PERCEPTIMET PËR JUGOSLLAVINË DHE "EVROPËN LINDORE"

B. Qose: Do doja të ndalemi tek "Luleshtrydhet e Çernobilit". Interesi klasik kundrejt librave me kujtime (memuareve) përtej perdes së hekurt, ka ndryshuar me kalimin e kohës. Përgjatë dhe pas rënies së sistemeve komuniste, lexuesi perëndimor kërkonte letërsinë e shkrimtarëve të mëdhenj disidentë, me qëndrime të forta politike, që tregonte sesa kurajë duhej që të luftoje tjetërsimin, të ruaje idetë e tua të pakorruptuara, të shpëtoje shpirtëroren dhe religjionin, apo qoftë edhe thjesht të jetoje sipas parimeve të vetes tënde të vërtetë. Këto tema i gjejmë tek Solzhenitsyn-i, Pasternak-u, Bulgakov-i, Miłosz-i, Trebeshina apo edhe Kundera, pavarësisht se ai vetë nëpër intervista e ka mohuar etiketimin si shkrimtar disident, duke e quajtur veten shkrimtar jopolitik. Kjo listë klasike me vepra prej vendeve pas-komuniste ka ndryshuar pa zhurmë, duke u pasuruar me libra që zbulojnë jetën përgjatë sistemeve komuniste nga shumë këndvështrime, si p.sh. në librat e S. Alexievich-it "Jeta e dorës së dytë", G. Gospodinov-it "Kam jetuar në Socializëm", këtu po fus edhe romanin tuaj "Luleshtrydhet e Çernobilit", në të cilin ju, që në fillim, na tregoni se përse e keni shkruar. Sigurisht që arsyeja është mjaft personale dhe prekëse, por nëpërmjet kësaj situate kuptohet që ju as që e kishit përfytyruar suksesin e kësaj vepre dhe ndikimin që ajo do të kishte për mënyrën sesi lexuesi perëndimor do të mendonte për jetën në Jugosllavi. Përse mendoni se ka ndodhur kjo zhvendosje interesi, prej disidentëve të mëdhenj e letërsisë së burgut, drejt jetës së zakonshme dhe personazheve të zakonshëm? A ka arsye te tjera përveç konsumimit të emrave të mëdhenj nga industria e mbingopur e librit?

V. Goldsworthy: Pyetje sfiduese! Mendoj se largimi prej narrativave dhe figurave të mëdha ka ndodhur në tërë shoqërinë, jo vetëm në industrinë e librit. Figurat e disidentëve të mëdhenj janë zëvendësuar prej zërave të zakonshëm. Alexievich-i është shembulli më i mirë sepse ajo i dokumenton këta zëra njerëzorë. Edhe në Angli, në vend të kujtimeve të figurave të mëdha, tashmë ka gjithmonë e më shumë kujtime për gra dhe burra të zakonshëm. Mjaft vizatime librash që dokumentojnë jetën e zakonshme në Mass Observation Archive (Arkiva e Vëzhgimit të Masës) të Universitetit të Sussex-it, janë pafund të suksesshme. Ky arkiv ruan zërat njerëzorë të jetëve të zakonshme.

Interesi ka ndryshuar katërçipërisht, duke përfshirë edhe qasjen politike, por kur shkrova "Luleshtrydhet e Çernobilit" kjo gjë nuk mund të parashikohej. Libri im nuk ishte oportunist pasi nuk e dija se ç'do ndodhte. Sikur të mund të parashikoja interesin e lexuesit do isha një grua e pasur! Nëse do më thoshin se libri im do kishte çerek milioni lexues (po të numërosh kopjet e shitura nëpër botë), do isha habitur krejtësisht, pasi jeta ime mua më dukej krejt e zakonshme. Teksa shkruaja "Luleshtrydhet e Çernobilit" nuk mendoja se jeta ime kishte ndonjë gjë emocionuese apo të veçantë. Mendoja se isha dhe ende mendoj se jam një njeri i zakonshëm. Gjithsesi, libri nuk u prit si i tillë. Ndoshta kjo duhet lidhur më çështjen e ekzotizimit që përmendët

ju. Lexuesit anglezë apo ato gjermanë menduan se jeta ime ishte e pazakontë! Në njëfarë mënyre edhe ekzotike! Unë përshkruaja jetën në Jugosllavinë e Titos dhe edhe pse isha e re, isha si e dalë prej muzeut. Memuari im tregon një jetë të zhdukur, njëlloj si ajo që përshkruan Nabokovi. Por duhet thënë se ka të bëjë edhe kërkimi i produktit letrar nga pjesë të ndryshme të botës, nga përvoja të ndryshme. Në vitin 2005, libri im ishte memuari i parë nga ish Jugosllavia, i cili mbulonte këtë pjesë të së zakonshmes, të së përditshmes dhe jo një histori lufte, kishte kaq shumë të tilla për atë rajon. Mendoj se industria e mbingopur e librit e meriton ironinë tuaj të përkorë.

Ch. Voss: Për mua "Monsieur Ka" ka hero Londrën dhe temë metropolin e pathyeshëm që i ka mbijetuar shkatërrimit të Hitlerit (Blitzkrieg) dhe vendmbërritje e një migracioni divers – ju e quani "cilësia kameleonike e Londrës". Jemi në vitin 1947. Tema e vërtetë për mua është procesi i akulturimit në Londër i familjeve: i francezëve Albertin-ë dhe i rusëve Karenin-ë. Veçanërisht perceptimi gjuhësor i të qenit i huaj, emigrantëve u vënë nofkën "tuppenny Munchausens", domethënë baronë falsë të varfër, që vijnë me emra dhe identitete të rreme. Kujdes, se do zbuloj pak romanin - për shkak të përvojës së të qenit të huaj dhe bashkëndarjes së kësaj përvoje, nipi i Ana Kareninës dhe heroina e romanit bien në dashuri. Keni shkruar për përvojën personale të akulturimit dhe të mospërkatësisë në Londër?

V. Goldsworthy: Historia e emigracionit në Angli është një temë implicite e romanit, e cila parashikon botën tonë globale. Duhet të keni parasysh ndoshta shembuj të njohur subjektesh të emigrantëve të cilët pastaj kthehen në vendin e tyre dhe priten krejt ndryshe. Në të kaluarën, para epokës së internetit dhe të udhëtimeve masive, emigrantët ishin më të lirë për të rikrijuar veten, qoftë për mirë, qoftë për keq.

Në 1947, zoti Alexander Korda, një regjisor i famshëm që bëri filmin "Anna Karenina" me aktoren Vivien Leigh, ishte në qendër të establishmentit (për shembull ai punësonte Churchill-in), por në fakt ai vinte prej një fshati hungarez. Emri i tij i vërtetë ishte Sandor Kellner. Pasi shkoi në Angli, ai e rikrioi veten dhe u bë një gjeni i kinematografisë. I dua shumë këto lloj rikrijimesh.

Korda sot nuk do kishte mundur ta ribënte veten në atë masë edhe në ditët e sotme. Miqtë e tij nga fshati hungarez do postonin në Facebook "Ç'bën kështu në Londër? Çfarë shpif për veten?". Bota është bërë më e vogël. Duke studiuar për Londrën e vitit 1940 zbulova se personazhet që dukeshin më shumë britanikë, në fakt ishin më të huaj se të tjerët.

Korda është një prej atyre njerëzve të vërtetë, por të ribërë që shfaqen tek "Monsieur Ka". Ka shumë të tjerë. Patrick Skipwith-i është një tjetër shembull i mirë, ai është aktori që luan Sergein. Vivien Leigh luan të ëmën, Anën. Edhe pse duket se Patrick Skipwith është emër anglez, në fakt e ëma është princesha e famshme ruse Sofka Dolgorouky, pasardhësit e së cilës i njihja në zonën ku jetoj këtu në Londër, një prej qendrave historike të jetës ruse në Britani. Prej këndej më lindi ideja për romanin.

Tek "Monsieur Ka" të krijohet ideja se asnjëherë nuk i dihet se çfarë është e vërtetë dhe çfarë trillim lidhur me identitetin. Dhe ja tek jam unë, një romanciere 'angleze' që shkruan për rusë të cilët kanë emra anglezë dhe duket sikur janë shumë anglezë, por në fakt kanë të gjithë histori të fshehta dhe askush prej tyre nuk është krejt ashtu siç duket. Albertina, rrëfimtarja franceze (e cila në fakt është hebre dhe nuk e pëlqen më Francën) shkon në një festë ku takon gjithë ata anglezë intimidues, por kur fillon të flasë me ta na del se janë krejt ndryshe prej ç'pretendojnë të jenë.

Kjo është historia e emigracionit të mesit të shek. XX, Evropa ishte në lëvizje, në kuptimin e plotë të fjalës miliona njerëz rifillonin jetën, krijonin jetë të reja me ndjesinë e përkatësisë dhe të mospërkatësisë. Në roman, paradoksalisht, i vetmi personazh që ndjen një mospërkatësi absolute është protagonisti mashkull. Ai është rritur në Indi dhe ndihet mjeran në Londër. Klima është e tmerrshme, qyteti është plot me të huaj dhe ai nuk di ku të përkasë. Ai shkon herë pas herë në Gjermani, por aty ka të tjera probleme dhe ai ndihet mjeran edhe atje, i paaftë për të ndihmuar. E gjithë bota e romanit "Monsieur Ka" është e zhvendosur, askush nuk është i fiksuar në të. Këtu qëndron bukuria e shkrimit të kësaj vepre. Krijova një botë ku realiteti fiks sabotohet pafundësisht nga rikrijimi.

B. Qose: Hapësira dhe rënia e Jugosllavisë: në memuarin tuaj, Vesna, ju përmendni se gjërat e vogla paralajmërojnë kalbëzimin e sistemit. Mund të jenë gjëra të vogla për vëzhguesin, por jo për njeriun jeta e të cilit përbëhet nga gjërat e vogla. Mund të pyesja retorikisht se sa të vogla janë në të vërtetë disa gjëra. Dua të ndalem tek mënyra se si na flet hapësira për gjëra më të thella. Në Realizmin Socialist Shqiptar gjejmë narrativën e një familjeje që dërgohet të jetojë në një zonë të re në ndërtim e sipër, gjithë baltë, periferike, e zhurmshme, por familja përshtatet dhe jeton e lumtur edhe pse është zhvendosur pa dëshirën e saj. E njëjta hapësirë në ndërtim e sipër me apartamente të parafabrikuara përshkruhet si simbol i tjetërsimit njerëzor dhe i jetës pas vdekjes së traditës tek Martin Camaj, një shkrimtar shqiptar subversiv ndaj sistemit. Është e njëjta hapësirë qytetare që trajtohet në mënyra krejt të kundërta. Në rastin tuaj ka një moment magjepsës kur ju analizoni se "vetë esenca e gjendjes evropiano-lindore ishte se shtëpia dhe familja nuk përputheshin me njëra-tjetrën". Si mund të nuhatej kalbëzimi i Jugosllavisë prej gjërave të tilla, si hapësira, hapësira e banesave, hapësira e qytetit etj.?

V. Goldsworthy: Hapësira në përgjithësi dhe hapësira e qytetit në veçanti, e shenjojnë veprën time thellësisht. Christiani dhe unë thamë që tre romanet e mia flasin në mënyra të ndryshme për Londrën, ndërsa memuari për Beogradin: dy qytete të mëdha me miliona banorë. Ideja e hapësirës urbane është diçka që më shqetëson, por ju pyesni për diçka më komplekse, hapësirën e banimit, ju pyesni se si jetët tona vendosen në hartën e hapësirës së banimit.

Rrugët e Beogradit në zonën ku banoja janë plot me shtëpi shumë të mëdha të zbrazura nga emigracioni, ku kanë ngelur prindërit e moshuar, që jetojnë vetëm në shtëpi që jehojnë, të ndërtuara për familje të mëdha në vitet '70, '80. Kjo është trajektorja e familjes sime, e jetës sime; ne jetonim në një apartament të vockël në një pjesë të bukur dhe të gjelbëruar të Beogradit. Prindërit e shitën shtëpinë e vockël për të krijuar mundësinë e strehimit për brezin e ardhshëm dhe ndërtuan një shtëpi të madhe të shëmtuar që kishte tre apartamente. Një për mua, një për motrën dhe një për ata. Ishte një mini pallat nga ata që i gjen kudo nëpër Ballkan. Unë dhe ime motër e urrenim shtëpinë e re. Ne emigruam dhe shtëpia mbeti bosh. E gjithë kjo më duket simbolike, ideja që apartamenti i vockël ku jetonim të lumtur në vitet '60 nuk na dilte dhe hapësira e re e tepruar, që prindërit e krijuan me aq mund, u braktis. Të gjithë ballkanasit kanë komunitete të mëdha diasporike.

Në këtë histori më intereson paradoksi i nostalgjisë, i mallit, ideja e të ndjerit mall për diçka që nuk të ka pëlqyer vetëm sepse të kujton jetën tënde të mëparshme. Pra, edhe kjo shtëpi që nuk më pëlqen është një prej vendeve që më ngjall mall dhe nostalgji. Zbrazëtia e saj tregon dhimbje, nuk dua të jetoj aty, por gjithsesi më merr malli. Është një paradoks që besoj se vetëm ballkanasit mund ta kuptojnë.

Kemi edhe paradoksin e kundërt të komuniteteve Gastarbeiter, të cilët kthehen në vendin e origjinës dhe ndërtojnë shtëpi identikisht të shëmtuara dhe të mëdha, duke shkatërruar peizazhet e bukura të Ballkanit, në të cilat nuk do të jetojnë kurrë, pasi investojnë në njëfarë jete të projektuar. Në të gjithë Ballkanin ka fshatra të tëra me shtëpi të mëdha të zbrazëta, të ndërtuara me para që vijnë nga Zvicra apo Gjermania, shtëpi në të cilat askush nuk do jetojë ndonjëherë.

Herën e fundit që isha në Berlin ndenja në një hotel afër liqenit Schlachtensee. Çdo natë ëndërroja sikur isha në Beograd. Pyesja veten se çfarë më bëri të ëndërroj kështu. Kuptova se ajo rrugë në Berlin i ngjante më shumë Beogradit të fëmijërisë sime sesa Beogradi i tanishëm, kishte të njëjtat stile arkitekturore, të njëjtat kopshte. Rruga kishte aromën e fëmijërisë sime, madje netëve edhe zhurma e makinave në kalldrëm ishte njësoj. Rrugët me kalldrëm dhe shtëpi të tilla nuk ekzistojnë më në Beograd. Beogradi është pushtuar nga zhvillimi i pashpirt. Ndonjëherë vende të huaja (dhe kjo gjendet në memuarin tim) na krijojnë ndjesinë e përkatësisë më shumë se vendlindja jonë e braktisur, arrijnë të na ngjallin kujtime. Besoj se paradokse të ngjashme mund të gjenden në Tiranë, nëse keni udhëtuar jashtë, sepse e di që edhe Tirana ka ndryshuar në një mënyrë të ngjashme me Beogradin.

Ch. Voss: Pyetja e fundit ka të bëjë me identitetin tuaj si serbe. Nuk doja që t'ju thjeshtoja kështu, por në formatin tonë ne ju ftojmë sepse jeni ballkanase dhe jo sepse jeni angleze. Sipas asaj që thuhet tek "Monsieur Ka", i dashuri i Ana Kareninës, oficer Vronskij, vdiq në luftën serbo-turke në vitin 1880. Nga ana tjetër fëmijëria, rinia juaj serbe dhe jugosllave është zhdukur prej librave tuaj letrarë. Libri juaj i fundit "Perdja e hekurt" gjithashtu flet për luftën e dy blloqeve botërore pas 1945-ës dhe kryesisht për Britaninë gjatë Luftës së Ftohtë. I jeni larguar temës ballkanike sepse ndiqni kërkesat e audiencës britanike apo mund të presim prej jush një roman ku ngjarjet zhvillohen në Beograd apo kudo në Serbi?

V. Goldsworthy: I kam premtuar vetes se një ditë do të shkruaj një roman në serbisht thjesht për të parë nëse e kam harruar gjuhën e nënës, apo ajo më ka harruar mua. Gjuha është gjithnjë në ndryshim. Po ju përgjigjem se nuk shkruaj me ndonjë model, mund ta quani edhe oportunizëm nëse doni. Në rastin tim as që e di se cilat janë pritshmëritë e audiencës britanike. Shtrohet edhe çështja e autenticitetit, a mund të shkruaja më për Serbinë?

Po ju tregoj një anekdotë të pesëmbëdhjetë viteve më parë. "Luleshtrydhet e Çernobilit" po ecte shumë mirë dhe më kujtohet se agjenti im i atëhershëm po diskutonte me botuesin amerikan në lidhje me botimin tim të ardhshëm. Ai më tha, duke më përcjellë kështillën e botuesit, se nuk duhet të shkruaja për njëfarë kohe një libër tjetër për Serbinë. -Pse jo?, e pyeta. "Sepse ke bërë mjaft për Serbinë, e ke kryer këtë temë, tani ec përpara." Kjo ishte logjika e botimit, e ke kryer këtë temë, ec përpara. Vetëm sepse isha nga një vend i vogël dhe kaq mjaftonte për të shkruar për të. Nuk besoj se do i kishin thënë kështu Salman Ruzhdie-s, "Ke shkruar boll për Indinë, lëre Indinë dhe shkruaj për një vend tjetër."

Paradoksi është se të qenit nga një vend i vogël është njëfarë privilegji se shihesh si specialist për atë temë, por për shkrimtarin është edhe njëfarë barre. Të gjithë njerëzit që janë prej atij vendit të vogël e shohin veprën tënde me lupë. Pra, ashtu si Crnjanski, edhe unë përdora rusët për historinë time me emigrantë. Unë doja të zbuloja Londrën pa hyrë në debatin mes Serbisë dhe Anglisë, apo në cic-micet e pozicionimit bashkëkohor serb. Rusët për mua ishin një mekanizëm çlirimi, ashtu si edhe për Crnjanskin. Mund të shkruaja për një komunitet të cilit nuk i përkisja, për të thënë disa të vërteta për Londrën. Ishte një vendim strategjik, më shumë sesa një zgjedhje për t'i shpëtuar identitetit tim.

Pra, unë mund të dua të shkruaj një roman për Ish Jugosllavinë, për Beogradin, Serbinë, në serbisht, por kjo nuk ka gjasa të ndodhë për sa kohë unë jetoj me letërsinë time. Nëse shkruan në cilëndo gjuhë të ish Jugosllavisë mund të shesësh 2000-3000 kopje librash. Mund të mendoni që jam marksiste sepse po përdor një logjikë të tillë, por modeli i botimeve dikton superstrukturën, në këtë rast, romanin që shkruaj. Për sa kohë botuesit dhe agjentët e mi presin prej meje një libër në anglisht, i dedikohem shkrimit në këtë gjuhë dhe nuk kam kohë për snobizma të tilla si të shkruarit në një gjuhë të vogël edhe nëse ajo është gjuha ime.

B. Qose: Po me ndjesinë e lirisë që jep një gjuhë tjetër, a ka të bëjë kjo? Për shembull më kujtohet Ornela Vorpsi, e cila në një prej festival letrar ku ishte e ftuar, u shpreh se të shkruarit në gjuhë të huaj ishte shkëputje nga trauma shqiptare dhe se të shkruarit në gjuhë të huaj i krijonte lirinë e domosdoshme për artisten.

V. Goldsworthy: Në rastin tim nuk është kështu. Mendoj se kjo lloj lirie iluzore zgjat deri në botimin e librit. Kur u botua "Luleshtrydhet e Çernobilit" në Angli, kutia ime postare u stërmbush me letra nga ish Jugosllavia, njerëzit më pyesnin "Pse the këtë e atë gjë?" Nuk ta jep arratisja lirinë, audienca jote është tërësisht globale. Nëse Ornela Vorpsi ka pasur atë mendim për Shqipërinë, me siguri që e ka pasur fjalën për librin e saj të parë. Në momentin që libri botohet, audienca jote është, sa globale, po aq edhe lokale në të njëjtën kohë.

Duhet të them që ekziston një çështje tjetër, ndoshta më e mirë që ka të bëjë me të shkruarit në një gjuhë tjetër për të çliruar një lloj tjetër kreativiteti. E kuptova kur shkrova për jetën time se kisha më shumë frenim kur shkruaja në serbisht. Nuk e kam fjalën për temat, por për fjalët. Do doja të përdorja shembullin e fjalëve të pista, por nuk mundem pasi kjo bisedë po regjistrohet. Në anglisht shaj si ushtar pa më ardhur zor, në serbisht nuk mundem. W. H. Auden-i thoshte diçka të tillë: Në gjuhën e nënës fjalët kanë më shumë realitet. Kur fëmija mëson fjalën "hënë", ai e sheh hënën, apo jo? Ndërsa në një gjuhë të mësuar këto lidhje janë më të dobëta, gjuha është më abstrakte.

Kur bie fjala për pjesë intime të trupit, në anglisht jam në gjendje t'i përmend me emrin e tyre, por në serbisht ndërhyn vetëfrenimi im i fëmijërisë. Kemi të bëjmë me një sjellje krejt ndryshe ndaj teksturës së gjuhës. Mund të duket për të qeshur, por këtë gjë e kuptova kur fillova t'i jepja makinës nëpër Londër me gjithë tim bir në të. Zakonisht, i shaja anglisht shoferët e tjerë, me dritare mbyllur kuptohet, vetëm për të nxjerrë inatin. Pastaj shihja tim bir dhe kuptoja se fjala f... ishte po aq e vërtetë në anglisht, sa edhe në serbisht. Kjo nuk ka të bëjë me anën akademike. Në gjuhën e mësuar tabutë janë më të pakta.

B. Qose: Pyetja e fundit: në një episod nga rinia juaj si shkrimtare e re, ju shprehni ndjesinë tuaj teksa ishit kandidate për një çmim poetik dhe pastaj emri juaj u hoq nga një botues i ashtuquajtur neo-surrealist. Çfarë kompromisesh duhet të bënte shkrimtari, përveçse të shkruante një poemë për shokun Tito?

V. Goldsworthy: Episodi me poezinë për shokun Tito është në fakt një rast i mrekullueshëm për të kuptuar veten time, po aq sa Jugosllavinë e kohës. Unë shkrova një poezi abstrakte që në zanafillë ishte për besimin tek Zoti, të cilën lehtësisht mund ta interpretoje si një poezi për besimin tek Lideri i Madh. Nuk besoja as tek Zoti, as tek shoku Tito, por poezia ishte e mirë.

Isha 23 vjeç kur poezia ime u përzgjodh për t'u lexuar gjatë festimeve të mëdha për ditëlindjen e shokut Tito, që organizohej çdo Maj në një stadium futbolli. Bëhet fjalë për vitin 1984, pra Titoja vetë kishte vdekur. 30.000 njerëz festonin ditëlindjen e liderit politik që ishte një lloj Zoti tashmë. Pjesëmarrja ime nuk ka të bëjë me kompromise për shkak të natyrës politike (siç mund të aludoni në pyetjen tuaj), pasi Jugosllavia ishte një vend tolerant, por me pamundësinë për t'i shpëtuar ideologjizimit pasi dërgon për botim një poezi dhe ndoshta me narcizizmin tim prej poeteje të re. Askush nuk më detyroi. Në fakt doja të lexoja përpara tërë atyre njerëzve, isha në të njëjtën skenë me idhujt e popit dhe të aktrimit.

Jugosllavia ishte një ndër vendet më të lira të Bllokut Lindor. E di se situata në Shqipëri apo në Rumani ka qenë ndryshe dhe se njerëzit dënoheshin për shkrimet e tyre etj. Kishte raste të tilla edhe në Jugosllavi, por mesa di unë, kishin të bënin ekskluzivisht me transgresionin nacionalist dhe jo atë politik. Unë nuk hyja as tek nacionalistët, as tek disidentët. Si shumë të tjerë nga brezi im, isha jopolitike. Ndoshta do duhet të kishim qenë më politikë, pasi duke iu shmangur politikës ua lamë vendin njerëzve me ide fikse dhe ja se çfarë ndodhi.

Kur përshkruaj momentin e refuzimit të vëllimit tim të parë me poezi, me humor unë e kam fjalën për vanitetin tim si poete e re. Tani ndjej një dozë snobizmi tek ato që kam thënë dhe ndihem fajtore. Pse duhet të thosha që botuesi ishte neo-surrealist, apo ngaqë nuk pranoi të botonte librin tim? Ndërsa cilësimi "provincial" nuk është aspak për të qeshur. Ndoshta përmbledhja ime nuk ishte aq e mirë, kush e di! Ndoshta ai zotëri kishte të drejtë. Refuzimet e rinisë na dhembin edhe kur kemi arritur majat e suksesit letrar si të rritur. Mund të isha treguar më shpirtmadhe teksa e cilësoja atë zotëri, mund të kisha krijuar një fjali më të mirë.

Përktheu: Belfjore Qose

ESSE PËR POEZINË E JERONIM de RADES

NJË NGJYRË ME EMRIN DASHURI

Nga Rudolf Marku

1.

Jeronim de Rada, duke qënë poeti më i talentuar i poezisë lirike shqiptare, dhe poeti më origjinal i sajë, është njëkohësisht dhe poeti më i keqshpjeguar në letrat shqipe. Poema e tij " Skenderbeu i Pafan„ (i Pafat) duket si një referencë e ndjellshme e fatit të vetë Poetit dhe e vepres së tij. Po citojë vetëm disa nga termat që studjuesit e letersisë shqipe kanë përdorur për krijimtarinë e de Radës për të kuptuar më mirë atë pamundësi të studjuesve të letersisë për të arritur të kuptueshmeria e vlerave të poezisë së de Radës: *''çlirimi i vendit„*- që është dhe togfjalëshi më i përdorur; *përmes komplotesh dhe kryengritjesh; aksionet revolucionare të popullit; borgjeza e madhe dhe çifligarët e saj!!!; heroizëm dhe shpirt sakrifice të rrallë patriotizmi; idetë e revolucionit; kushtrimi për çlirimin e atdheut të stërgjyshërve; vlera të spikatura shpirtërore patriotike; dritë atdheut; komploti për të përmbysur regjimin absolutist; policia e gjurmonte si një njeri të dyshimtë; baticat revolucionare; idetë e tij përparimtare; militonte në dobi të..; kundër synimeve grabiqare të fqinjëve; poemën shoqërore; nuk i kuptonte deri në fund kontradikatat klasore; mësues i popullit...".* Një arsenal termash ushtarakë dhe togfjalësha të fosilizurar broshurash revolucionare, duken si fyerja më e madhe që mund t'i bëhet Poetit i cili gjithmonë, gjatë gjitë jetes së vet, u kujdes për të krijuar një poezi delikate, gjithë ndjenjë dhe përkujdesje metrike, me një aftësi të jashtëzakonshme për të koncentruar kuptime shumë-shtresëzore brenda një njësie të vetme semantike. Poeti i imazheve më origjinale dhe më delikate që mund të gjesh në poezinë shqipe ka merituar shumë më tepër se titullin e çuditshëm Mësues i Popullit (titull kafkianesk-do të thonin studjuesit e Franc Kafkës). Një titull që zor se mund t'ia bashkëngjitësh poezisë së madhe dhe poetit të madh lirik, i cili, deri në moshën 90 vjeçare, nuk pushoi së shkruari një poezi që dallohet nga brishtësia, orgjinaliteti, lirizmi dhe ngarkesa emocionale e koncentruar maksimalisht në gjuhën poetike. De Radës do t'i shkonte më tepër parafrazimi i thënies së poetit anglez P.B. Shelley-it "Ligjëvendës i papranuar i poezisë moderne shqiptare„

2.

*Në një esse të hershëm mbi letersinë, Ezra Pound shkruan se ekziston një dallim i madh mes Poezisë që mund të lexohet me zë dhe asaj që nuk mund të lexohet me zë. Në fund të fundit, e gjithë Poezia-sipas poetit amerikan që pati një ndikim të jashtëzakonshëm në poezinë e shekullit XX- ndahet në poezinë që mund të lexohet zëlartë dhe në poezinë që nuk mund ta përftyrosh të lexuar me zë. Nuk është fjala për të thënë se cila lloj poezie ka më tepër vlerë, se sa për të dalluar dy koncepte të ndryshme poetike. Është një pikënisje për ta vështruar Poezinë si një ndërveprim i sajë me artet e tjera. Poezia që mund të lexohet me zë përceptohet nga lexuesi si një pjesë muzikore, që vlerësohet për cilësitë sonore të sajë. Nga ana tjeter, kemi Poezinë që mund ta përceptosh si një art vizual, që nuk mund ta lexosh zëlartë, Poezinë të cilen lexuesi e sheh dhe e vlerëson të shtypur në fletë, në leter, në atë mënyrë siç mund të shohi një pikturë a një fotografi a një film, dhe të cilën, për nga vetë natyra e saj, kemi dëshirë që ta lexojmë në heshtje, pa zë. Është një mënyrë tepër e vjeter e vështrimit të Poezisë. Aristoteli flet për këtë këndvështrim të poezisë, dhe po ashtu, në shekullin e parë, Horaci e përcakton poezinë "**Ut pictura poesis**„. Ndersa Naim Frashëri, Gjergj Fishta dhe Migjeni shkruajnë poezinë sonore, poezinë që të ndjellë natyrshëm që ta lexosh zëlartë, Jeronim de Rada, Zef Serembe, Martin Camaj shkruajnë poezinë vizuale, poezinë që tek e lexon me zë të ulët, lexuesi e shndrron në imazhe pamësore. Mendoj se de Rada është dhe poeti më i madh i poezisë që lexohet nënzë, i asaj poezie leximi i së ciles përherë të jep shansin e përftyrimit vizual të ndjenjave :*

Trimi e zuri e ma puthi/Na e puthi mu në buzët/ Vasha n'uj' e vërtiti faqen/Dhe lau të puthurën/Po m'atë e skuqi ujët./Nga qyteti aty afër/Duallë gratë e lan' leveret/ Skuqeshin, nuk zbardheshin/T'linato që ato lanin/ Kopshtet që vaditeshin/Gjethet i bënin të kuqe./Zogjtë që pinin atij uji/Cicërimn' e tyre humbnin.../.

Është një poezi dashurie që mund të matet, për nga forca e përftyrimit, ekzagjerimi emocional, delikatesa, brishtësia, shkallëzimi figurativ, vetëm me poezitë e famshme të dashurisë të poetit anglez Jon Donn. Një djalë ka puthur të dashuren e vet. Ajo përpiqet ta "fshijë„ duke e larë në lumë„ të puthuren e djalit. Por ja që e kuqja e së puthures (pse- E kuqe? Asossacioni i dashurisë me zjarrin, me prushin është i nënnkuptuar vetvetiu) përskuq ujin e lumenjëve. Gratë vijnë të lajnë rrobat,por ja që rrobat e tyre nuk zbardhen që nuk zbardhen. Pemët që ujiten nga uji i atij lumi çelin gjethe të kuqe; madje dhe zogjtë që pijnë ujë në atë lumë e humbasi zërin. Sepse zëri i tyre është shurdhëruar nga zëri magjik prej flauti i së puthures! Nuk njoh në poezinë shqipe një poezi më të bukur dashurie nga kjo! E denjë që të qendrojë në çdo Antologji botërore të poezisë së zgjedhur. Krahas poezive të Petrarkës, Vinjonit, Shakespear-it, Jon Donn-it. Le të citojmë vargjet e Këngës së Parë të Milosao-s, aq të njohura nga lexuesi:

Bota kish ndërruar lisa,/uji i ri në det/kaltronte n`ditn` e re;/por lumbardha e Anakreontit/në Temp rronte e moçme...

De Rada që në fillimin e poemes bën të ditur se e nis udhëtimin e vet poetik nga Tempulli i poezisë klasike (Anakreonti)- Tempulli ku merr formimin formal dhe shpirtëror. Por,ashtu siç ndodhë me krijuesit e vertetë, dhe, krejt ndryshe nga përftyrimet e cekëta snobiste të sotme, pikëudhëtimi nga Tempulli klasik jo vetëm që nuk e pengon që të arrijjë poezinë më moderne shqiptare, por në të kundërt, është poezia klasiçiste ajo që e ndihmon ta shkruajë natyrshëm atë. Vështrimi i prehtë, i etur, i sinqertë, i de Radës në Napoli dhe në fshatërat arbëreshe kap reflektimet e fundit të botës greko-romake në sipërfaqen e ujërave të botës së Kultures popullore shqiptare. Të botës shqiptare të para pushtimit turk. Dhe vetë poezia e de Radës është në fund të fundit poezia e një kombi ende të pa-Azi-stikuar. Skenderbeu dhe koha e tij janë për de Raden shumë më tepër se një figurë dhe një periudhë historike, ato janë njëkohësisht, dhe mbi të gjitha, parim estetik, kompleksitet figurativ i poezisë, gjuhë dhe ritëm. Poezia e de Radës nuk e ka vrazhdësinë e mëvonshme që shfaq poezia shqipe. Nuk e ka gurësimin e sajë të njohur, rrudhat e ballit dhe shikimet e vrazhda të sajë, nuk e ka gjuhën e rëndë me labirinthe bashktingëlloresh me intonacione veglash frymore. Në të kundërt, ajo është e brishtë, delikate si një tis mjegulle, e çliruar nga gravitacioni, e lehtë (në kuptimin që i jep kësaj fjale shkrimtari Italo Calvino). Po ta përfëtyronim poezinë e de Radës si një pikturë, mund të thonim se ngjyrat brenda tablosë balancohen në ndikimin e tyre reciprok, harmonik:

Vreshtat ishin verdhëllore/Erdh nga mali dhelpëra/ Me të lodhurat të bijat,/me të mbaruar të vjelat...

Sfondi jepet me ngjyra të çelëta, delikate përreth arabeskut të objekteve që pikturohen-dhelëpra dhe të bijat e sajë, vreshtat verdhëllore-,ndersa karakteret shfaqen në ngjyrë kafe të errët-e motra e Milosaos, Zonja Mëmë, shoqet e Rinës. Format e dritës duken se fluturojnë brenda një hapësire ajri. Thellësia, vetvetiu e nënkuptuar në çdo fjalë të poemes, krijohet nga saktësia gjuhësore dhe figurative. De Rada shfaq kudo guximin virtuoz të kompozicionit të poemes, veçse një guxim i pashpallur qëllimisht. Studjuesit dhe kritikët e letersisë janë ankuar shpesh herë për-" *Fragmentarizëm, copëzim të poezisë së de Radës.„*. Në Historinë e Letersisë Shqipe lexuesi mëson se "*Copëzimi i poemës është në përputhje me parimet krijuese të De Radës, që poezia duhet të japë kulmet e jetës dhe të shfrytëzojë nëntekstin. Veçse ky parim krijues herë-herë e kalon masën„*. Në fakt, ajo që quhet –*fragmentarizëm dhe copëzim*-dhe-*kalim mase*- në poetiken e de Radës nuk është gjë tjeter veçse fragmentarizmi i pikëpamjeve të studiusve dhe kritikëve tanë për poezinë dhe letersinë, pafatësia e tyre për ta parë vepren letrare si një tërësi, paaftësia

e tyre për të dalluar parimin e madh të retiçences poetike, atë që shumë e shumë vite më vonë nga De Rada, do bëhët një nga parimet më të rëndësishme estetike të krijimtarisë së Ernest Hemingway-t e të një brezi të tërë shkrimtarësh modern të shekulli që kaloi.

3.

Është e vertetë se de Rada ka qënë i vetëdijshëm për pjesëmarrjen në debatin e madh historik të Rilindjes. Por de Rada, si poet i madh, është i interesuar së pari për identitetin kulturor, të cilin ai e sheh si një dimension të ri të identitetit kombëtar, por dhe atij universal. De Rada është i vemendshëm ndaj kohës së vet, por kjo nuk e pengon që t'ia kushtojë të gjithë kujtesen e vet së shkuares. Dhe e shkuara ka për de Raden një dimension estetik dhe kulturor. Duke qënë një njeri teper i ditur, në mënyrë paradoksale de Rada nuk është ndër ata poetë, vepra e të cilëve ka një bazë intelektuale e cila kërkon që të paraqitet e të zgjidhet. Kur vjen fjala për krijimtarinë e vet letrare, estetika e tij krijuese dhe filozofia e tij janë më tepër intuitive,karakteret e poemave të de Radës dhe subjektet e tyre janë më tepër arketipa të rregjistruar në kujtesen gjenetike të arbëreshve- Skenderbeu dhe Koha e Lavdishme. De Rada shkruan poezinë e imazhit të Heroit më të madh mitik të shqiptarëve,mit i cili krijon subkonshin kolektiv tonë. Për de Raden, lidhja e njeriut me universin është në atë shkallë sa ç'është lidhja intime mes së tashmes dhe së shkuares. Ndryshe,madje krejt ndryshe nga ç'përftyrohet në Historinë e Letersisë Shqipe, për de Raden poezia është mbi gjithëçka një gjëndje e shpirtit. Dhe duke qënë e tillë, ajo është një sistem figurativ gjuhësor që sjell butësi, brishtësi,delikatesë, ndjenjë, sentiment,harmoni,ritëm. I tillë qe dhe vetë Poeti. Nuk është e rastit që poemat e tij kanë në pjesen më të madhe si figura qëndrore femren, gruan, vajzën : Rinen, Motren, Nënen (Milosao) ; Imotea-në, Agata-në, Frosina-në, Vantisana-në, te «Skënderbeu i pafat»; Serafina, Evoda, Parayllja, Olimpia te «Një pasqyrë e jetës njerëzore„. Karakteret njerëzore të poemave të tij kthehen natyrshëm në simbole emblematike të vendit të vet. Figura e Milosao-s merr gradualisht dimensionet e tipit. Natyrshëm ai kthehet në ikonë, ashtu siç kthehet në Ikonë vetë krijuesi i tij, de Rada.

Poezia e de Radës është poezia e *refinement*- poezia e përpunimit të formës, poezia e sofistikimit të shprehjes e të ndjenjes, e përpunimit delikat të formës, të gjuhës e të imazhit poetik, pa humbur për asnjë çast strukturen emocionale dhe konceptuale të poezisë që bëhët më e pasur dhe më e unifikuar duke u shfaqur përherë e më tepër përmes fantazisë së zjarrtë dhe ngjyrave sa të forta aq dhe delikate. Ka një ekuilibër mahnitës në poezinë e de Radës, që në fund të fundit është ekulibri i admirueshëm shpirtëror i vetë poetit. Dhe të mendosh se de Rada gjatë jetes së vet të gjatë përjetoi vdekjen e së shoqes, Madalena Melkji, me të cilen qe martuar në vitin 1850, dhe vdekjen e të katër djemve, njëri pas tjetrit. Poema Milosao mbyllet me vargun- *Po i lë si një ëndërr* ("Shkodren,qytetin tim, motren dhe shokët„). Nuk ke se si të mos pajtohesh me përftyrimin jetë-ëndërr të poetit, qoftë dhe nga përvoja e jetes së vet. Për de Raden një ëndërr e keqe, një makth, por prapë se prapë një ëndërr. Zor se mund të gjesh në letersinë botërore një jetë më tragjike nga jeta e tij. E megjithatë pati kohë të kishte korrespondencë të gjatë, krahas tjerësh, me Faik Konicen, Luigj Gurakuqin, nxënësin e vet të Kolegjit të Shën Adrianit, dhe me Zef Seremben, një poet tjeter tragjik arbëresh, po nxënës i de Radës dhe ai, po sidomos nxënës në përndjekjen besnike gati deri në imitim të fatit tragjik të mësuesit të vet të madh. Në përftyrimin e atyre pak studjuesve që e kuptuan poetin (Luigj Gurakuqi, Ernest Koliqi, Martin Camaj, Arshi Pipa dhe Ismail Kadare) de Rada është Ulisi poetik që është në kerkimin e përjetshëm të Atdheut të vet të humbur dyherësh, gjeografikisht dhe shpirtërisht. Në përftyrimin tim gjithmonë de Rada më është dukur dhe do vazhdojë të më duket si një piktor në kërkimin e ngjyres totale, në kërkimin e ngjyrës së ngjyrave, kolorit total, në kërkimin e atij kolori që mbart energjinë, harmoninë dhe magjinë e jetes njerëzore. Dhe gjithmonë kam menduar dhe do vazhdoj të mendojë se për poetin de Rada ky kolor e ka emërin Dashuri.



Ndahet nga jeta shkrimtari i njohur PANNOS IOANNIDES, një nga emrat e rëndësishëm të letërsisë së sotme qipriote

Para pak ditësh u nda nga jeta në moshën 86 vjeçare, Panos Ioannides, autor i shumë veprave të botuara në zhanre dhe në gjini të ndryshme, një nga shkrimtarët më të rëndësishëm në historinë e letërsisë qiprote.

Lindi në Famagusto, në vitin 1935 dhe studioi për "Mjetet e Komunikimit Masiv" në SH.B.A dhe më pas në Kanada. Punoi si Drejtor i Përgjithshëm i Programacionit në Radion dhe Televizionin Publik të Qipros deri në vitin 1995. Ishte themelues dhe kryetar i Qendrës së Shkrimtarëve Qipriotë "PEN", kurator i botimeve të kësaj qendre si dhe Kryeredaktor i revistës kulturore "In Focus", që del çdo tre muaj në gjuhën angleze.

Panos Ioannides filloi të shkruajë dhe të botojë vepra letrare që në moshë të vogël. Sprovat e para në poezi dhe teatër, të botuara në revistat letrare të kohës që dilnin në Qipro, datojnë në moshën njëzetvjeçare. Ndërsa përmbledhjen e pare me tregime të shkurtra titulluar "Në Qipron Eteriale", e botoi në Athinë, në Shtëpinë botuese G. Fexis, në vitin 1964. Që nga kjo kohë ai vazhdoi të shkruajë dhe të botojë pandërprerë. Eksperimentoi dhe botoi me sukses në të gjitha zhanret letrare, tregime, romane, drama, poezi, seriale radiofonikë dhe televizivë, si dhe skenarë për filma.

Edhe pse e identifikuar nëpërmjet gjuhës, letërsia qipriote ka krijuar profilin e saj të qartë dhe lehtësisht të dallueshëm nga letërsia greke. Kontributi dhe merita kryesore në krijimin e këtij identiteti i takon veprës së Ioannidesit. Studiuesi A. J. Kirby thekson se: "Edhe pse ai shpesh i merr subjektet e veprave nga historia... vlerat e këtij opusi letrar shtrihen përtej brigjeve ranore të ishullit të Qipros. Sepse, pavarësisht nga natyra e lokalizuar e ngjarjeve, temat janë po kaq universale, ashtu si te vepra Homerit".

Krijimtaria e Panos Ioannidesit, ngrihet mbi nivelin e ngjarjes që trajton. Ajo ka një dimension të pakufizur shpirtëror dhe është universale. Kritikët janë shprehur se kjo krijimtari, që është përkthyer në shumë gjuhë të botës, bën pjesë në fondin më të mirë të letërsisë së sotme greke.

Për kontributin e rëndësishëm letrar por edhe ndikimin që veprat e Ionnaidesit kanë patur në Qipro por edhe jashtë ishullit, është vlerësuar edhe më çmime prestigjoze si: "Thodosi Pierides", "Tefkrou Anthia", me çmimin e Kontributit Global të E.L.K., "G.F. Pierides", si dhe me çmimin e dramës televizive për veprën "Gregory" në Konkursin paneuropian të Sofjes në vitin 1976. Ndërsa në vitin 2007, iu akordua medalja "Nderi i Letrave", që është vlerësimi më i lartë shtetëror për letërsinë që jepet Qipro.

Për lexuesit tanë, Panos Ioannides është bërë i njohur me trilogjinë "Korbi", "Amerikë 62" dhe "Deva", të përkthyera nga Kleo Lati dhe të botuara nga Shtëpia e librit "Ombra GVG". Ndërkohë që është në proces botimi edhe përmbledhja e tij e fundit me tregime, e cila pak muaj më parë u botua në Qipro nga "Armida Books".

Me largimin nga jeta të Panos Ionnidesit, letërsisë së sotme iu shua një nga zërat më veçantë të saj.

Shtëpia e librit OMBRA GVG



(Ramiz Abdyli, "VEPRIMTARIA E KLUBIT TË SHKUPIT (1908-1912)", botoi ITSHKSH, Shkup, 2021)

GRAVURË E STILIZUAR MBI MERMERIN E KUJTESËS SONË KOMBËTARE

Nga Emin AZEMI

Monografia "VEPRIMTARIA E KLUBIT TË SHKUPIT (1908-1912)" vjen në opusin shkencor të prof. Ramiz Abdylit si gravurë e stilizuar mbi mermerin e kujtesës sonë kombëtare, e cila tash e tutje bëhet edhe më kuptimplote për arsye se historiografinë shqiptare e pasuron me një këndvështrim të munguar deri më tani, por edhe për faktin se, siç e thotë edhe autori: "motivi që më nxiti t'ia kushtoja këtë libër veprimtarisë politike dhe atdhetare klubit "Bashkimi" të Shkupit, është shqiptarësia e këtij qyteti ndër shekuj..."

Në hirin e kohëve gjithmonë ngelin gjurmët e atyre që kureshtjen e pasurojnë me njohuri të munguara, të cilat më vonë ose bëhen kronika të shkruara, ose rrëfehen si legjenda urbane. Por, gjithmonë ngelin ato kujtime të patretura nga kohët, të cilat në vete ngërthejnë palcën e identitetit material e shpirtëror të një qyteti.

Kështu ka ndodhur edhe me Shkupin, mbi historinë e të cilit janë shkruar shumë libra, monografi e kujtime të ndryshme nga autorë të huaj dhe më pak nga ata vendorë. Ky interesim për Shkupin përbënte edhe misionin thelbësor të udhëpërshkruesve, konsujve, shkrimtarëve, gazetarëve e studiuesve të shumtë për të nxjerrë në pah anët e dukshme dhe të padukshme të këtij qyteti antik, duke filluar nga zanafilla e formimit të tij, e deri te proceset e mëvonshme historike, gjeopolitike e qytetëruese, pa përjashtuar edhe ridisenjimet e nduarnduarta urbanistike-arkitektonike që janë shoqëruar me instalimin e regjimeve e administratave të ndryshme.

Nuk mund të shkruash për një qytet pa pasur fillimisht një farë ndjesie të caktuar, jo vetëm intelektuale, por edhe emocionale e njerëzore për të. Kjo ndjesi e ka udhëhequr edhe Prof.dr. Ramiz Abdylin, i cili kredon e tij botëkuptimore e shkencore e ka ngushtë të lidhur me Shkupin, këtë qytet të lashtë, nëpër të cilin kalonte nervatura kryesore e trungut etnik shqiptar. Ai jo rastësisht e ka përqendruar vëmendjen prej studiuesi pikërisht në këtë qytet, për arsye se Shkupi në dioptrinë e tij paraqet piemontin e një lavdie që kishte ndodhur por që kishte mbetur e pa trajtuar, prandaj edhe ka zgjedhur të veçojë një prej periudhave më të pasura me ngjarje dramatike (1908 -1012), që ishin të lidhura ngushtë me aspiratat e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe ideologut kryesor të saj, Abdyl Frashërit, sipas të cilit, Shkupi herë do kurdo duhet të jetë kryeqendra e Shqipërisë etnike.

Lidhjen e tij me Shkupin, Prof.dr. Ramiz Abdyli, tash së fundmi ka dashur ta shpërfaqë përmes një vepre që risjell në vëmendjen tonë lavdinë e dikurshme të këtij qyteti të lashtë.

Monografia "VEPRIMTARIA E KLUBIT TË SHKUPIT (1908-1912)" vjen në opusin shkencor të prof. Ramizit si gravurë e stilizuar mbi mermerin e kujtesës sonë kombëtare, e cila tash e tutje bëhet edhe më kuptimplote për arsye se historiografinë shqiptare e pasuron me një këndvështrim të munguar deri më tani, por edhe për faktin se, siç e thotë edhe autori: "motivi që më nxiti t'ia kushtoja këtë libër veprimtarisë politike dhe atdhetare klubit "Bashkimi" të Shkupit, është shqiptarësia e këtij qyteti ndër shekuj..."

Duke na e bërë të njohur veprimtarinë e Klubit "Bashkimi" të Shkupit, me kryetar Hamdi beun dhe nënkryetar Bajram Currin, autori hedhë dritë mbi një fazë të ndritshme të Lëvizjes sonë kombëtare, e cila e kishte vazhdimësinë e saj të pashkëputur që nga koha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e deri te shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (1912).

Veprimtaria e këtij klubi kap dimensionin më aktiv të zhvillimeve politike e kombëtare në mbarë hapësirën shqiptare, atëherë kur po finalizohej përpjekja për një mëvetësi politike e shtetërore shqiptare, ku Shkupi jo rastësisht ishte zgjedhur epiqendra e atyre zhvillimeve.

Këtu qëndron edhe rëndësia e të shkruarit të këtij kapitulli të munguar të Historisë së shqiptarëve, për arsye se deri më tani askush nuk është marrur me klubet shqiptare, dhe sidomos me Klubin "Bashkimi" të Shkupit, që ishte shprehja e drejtpërdrejt e aspiratës së Rilindasve tanë që në çdo qytet shqiptar të bëjë dritë një kandil diturie e emancipimi.

Klubi i Shkupit, i ideuar si motor që do të vente në lëvizje ndërgjegjen kombëtare, me mjete politike dhe luftarake, ishte klubi i parë politik shqiptar që u themelua në kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës, vetëm disa ditë pas klubit të Manastirit, në fund të gushtit 1908.

Arsyet ishin të shumta, por nga ajo që shkoqitet në monografinë e prof.dr. Ramiz Abdylit, kuptojmë se Klubi i Shkupit, si organizatë politike-atdhetare e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, u themelua për të dy arsye kryesore: të mobilizojë së brendshmi masat që do të ishin në funksion të rezistencës dhe të afirmojë çështjen shqiptare në rrafshin ndërkombëtar diplomatik e mediatik.

Duke qenë bërthama e një qeverie të ardhshme, që prodhonte ngjarje edhe për gazetat shqipe dhe të huaja, ky klub jo rastësisht tuboi elitën politike dhe atdhetare të Vilajetit të Kosovës, dhe me këtë dëshmoi se shqiptarët nuk ishin pa aristokracinë e tyre të mendjes dhe revolucionarët e pushkës, të cilët Shkupin e kishin zgjedhur si qendër të veprimit të tyre. Sigurisht që me këtë fakt mbase nuk kanë mundur të pajtohen autorë të lajthitur që vinin nga proveniencat ballkanike, të cilët paturpësisht gënjenin opinionin ndërkombëtar mbi, gjoja, mungesën e shqiptarëve për kapacitete shtetndërtuese. Klubi i Shkupit jo vetëm se i demantoi këto konstrukte dashakeqe propagandistike, por konfirmoi gatishmërinë dhe aftësinë e shqiptarëve për të menaxhuar situata sipas nevojave e rrethanave që kërkoheshin. Mjafton të lexohen raportet e konsujve të huaj të cilët shkruanin, bie fjala, për ditët e Shkupit të çliruar nga kryengritësit shqiptarë, në ditët dhe javët e verës së vitit 1912, ku rendi dhe qetësia publike ishin vendosur si një përfitim për të gjithë banorët e qytetit, pa dallim përkatësinë e tyre etnike e fetare.

I pagëzuar me emrin "Bashkimi", sipas shembullit të klubit të Manastirit, Klubi i Shkupit, siç na e bëjnë të ditur burimet e shumta arkivore e dokumentuese që i ka përdorur prof.dr. Ramiz Abdyli, kishte një fushëveprim mjaft aktiv, që si detyrë parësore kishte ndërgjegjësimin kombëtar të shkupjanëve më rrethinë dhe në Vilajetin e Kosovës, duke i dhënë jo pak hapësirë angazhimeve që do të kthjellonin kombëtarisht e kulturalisht edhe elementin shqiptar pro xhonturk të qytetit. Me këtë mund t'i përshkruhet edhe një meritë tjetër këtij Klubi, i cili kishte arritur të kontribuojë në orientimin properëndimor të shqiptarëve në një periudhë kohore kur për fatin e tyre vendosnin vendimet e padrejta të konferencave ndërkombëtare.

Klubi i "Bashkimi" i Shkupit e kishte hierarkinë e organizimit dhe veprimit, kurse Pleqësia ishte organi suprem që merrte vendime të rëndësishme. Pjesë e atyre veprimeve ishte edhe propaganda, që u sublimua me themelimin gazetës "Shkupi" e drejtuar nga publicisti dhe atdhetari, Jashar Erebara.

Në faqet e gazetës "Shkupi", në gjuhën shqipe dhe turqishte, u trajtua problemi kombëtar shqiptar, pozita e tij në Perandorinë Osmane, lajme të ndryshme nga trevat shqiptare, pretendimet shoviniste të vendeve fqinje, Greqisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Rusisë ndaj tokave shqiptare dhe informacione mbi ngjarjet në Perandori, Ballkan dhe në Evropë, si dhe probleme të tjera, si histori, bibliografia shqiptare, teknologjia etj.

Fryt i kësaj propagande ishte ndërgjegjësimi i shkupjanëve dhe i shqiptarëve nga qytetet tjera të Vilajetit të Kosovës për peshën që kishte në jetën e tyre veprimtaria e ideologëve e atdhetarëve të shquar, siç ishin Hasan Prishtina, Bedri Pejani, Luigj Gurakuqi, Nikollë Ivanaj, Mit'hat Frashëri, Josif Bageri, vëllezëti Topulli etj. Të gjithë këta kishin kaluar edhe ditë e net të tëra në Bujtinën e Klubit të Shkupit, prej nga shpërndanin kronikat e një qyteti që po rizgjohej nga letargjia që e kishin futur sunduesit e ndryshëm dhe mendësia e fanatikëve fetarë.

Një fryt tjetër i kësaj propagande ishte edhe ndikimi që pati në rrethet e oficerëve shqiptarë në ushtrinë osmane për të bashkërenduar veprimtarinë kombëtare në funksion të bashkëngjitjes kryengritësve shqiptarë në fushëbetejat



që do të zhvillohen më vonë në të gjitha krahinat shqiptare. Kjo atmosferë ndikoi që pas një kohe, pjesë e anëtarësisë së klubit u bënë edhe oficerë e ushtarë shqiptarë që shërbenin në garnizonin e Shkupit.

Klubi "Bashkimi" i Shkupit nuk ishte një organizëm i izoluar nga hapësira etnike shqiptare, prandaj ky ishte edhe qëllimi që me iniciativë të këtij klubi u hapën edhe klube të tjera në disa qytete të Vilajetit të Kosovës, si në Kumanovë, Mitrovicë, Tetovë e gjetiu.

Periudha në të cilën veproi Klubi i Shkupit përkon me disa zhvillimeve politike që i ndërmerrte administrata xhonturke në instalimin e frymës përjashtuese të elementit shqiptar nga jeta publike e administrative si dhe në favorizimin e alfabetit arabo-osman, një tendencë kjo në kundërshtim me vendimet e Kongresit të Manastirit që kishte përvetësuar shkronjat latine si bazë e alfabeti të ri të unifikuar

Këto marifete xhonturke janë vërejtur edhe gjatë proceseve zgjedhore, ku me të madhe u jepej hapësirë kandidatëve joshqiptarë, ndërkohë që Klubi "Bashkimi" i Shkupit, siç rezulton nga hulumtimet arkivore të prof. Ramizit, angazhohej që të votoheshin kandidatët shqiptarë me orientim kombëtar, dhe jo ata kandidatë shqiptarë që ishin në listat xhonturke, të cilët vunë interesat e tyre personale mbi ato kombëtare.

Se Klubi i Shkupit vepronte sipas një disipline dhe një hierarkie mjaft të strukturuar, flet edhe mënyra e organizimit të tij, ku si pjesë përbërëse ishte edhe Komiteti i fshehtë, një ndër komitetet më të shquara në Shqipëri, që i kushtohej kryesisht çështjeve që kishin të bënin me përgatitjen e rezistencës së armatosur që do të pasonte. Për rrjedhojë, Komiteti i fshehtë i Shkupit arriti të mobilizojë shtresat më të ndërgjegjshme të kombit përmes çetave të armatosura, siç ishte ajo e Ali bej Topallit, e cila pati një ndikim të madh në ndërgjegjësimin e popullit të këtyre zonave për kryengritje.

Duke iu referuar burimeve arkivore, autori vë në dukje se në zonat përreth Shkupit vepronin edhe çeta të tjera të cilat kishin paralajmëruan të gjitha fshatrat shqiptare të kazasë së Shkupit që çdo familje të dërgonte nga një mashkull në radhët e tyre që në bashkëveprim me kryengritësit e kazasë së Gjilanit të mbyllej Gryka e Kaçanikut.

Veprimtaria e Klubit "Bashkimi" të Shkupit nuk mund të shikohet e veçuar nga konteksti i ngjarjeve që po ndodhnin në atë hark kohor 1908-1912, dhe sidomos në fazën kulmore që u arrit me çlirimin e Shkupit. Prof. Ramizi në mënyrë eksplicite na e sjell atmosferën e çlirimit të Shkupit, duke e ndërlidhur këtë ngjarje madhore me një varg kryengritjesh që kishin ndodhur në Vilajetin e Kosovës e që kishin rezultuar me çlirimin e qyteteve të Rrafshit të Kosovës, dhe dominimit të Grykës së Kaçanikut, si formë e trysnisë mbi qeverinë xhonturke, që t'i plotësonte kërkesat e Kuvendit të Ferizajt.

Mbështetur në kronikat e gazetave të kohës dhe në raportet e konsujve, autori na e bën shumë të afërt atmosferën e çlirimit të Shkupit, e cila dominohej nga lajmet e përhapura për marshimin e kryengritësve drejt kryeqytetit Dardan Shkupit, të cilët ishin përqendruar fillimisht në pjesën veriore dhe verilindore të rrethinave të tij, rrjedhimisht në shpatijet e Karadakut të Shkupit dhe të Kumanovës.

Pjesë e kësaj atmosfere ishte edhe pritja që iu bë kryengritësve shqiptarë nga mijëra shkupjanë, të shoqëruar nga orkestrina "Zana e Malit", që ishte pjesë përbërëse e Klubit "Bashkimi" të Shkupit.

Marrja e Shkupit nga kryengritësit shqiptarë nuk mbeti pa u regjistruar edhe nga diplomatët e huaj, të cilët autori i citon me pedanteri përmes fjalëve të njërit prej tyre i cili teksa vlerësonte marshimin e kryengritësve shqiptarë në Shkup, shkruante: "*një veprim i përkryer dhe me një disiplinë të madhe*".

Autori gjithashtu sjell edhe përshtypjet e Eqrem bej Vlorës, i cili derisa po qëndronte ato ditë në Shkup, shkruante se shqiptarët e leckosur, të uritur, me këmbë të zbathura e të gjakosura *"janë sjellë si xhentlemen në qytetin e pasur të Shkupit, më mirë se ushtritë e disiplinuara*".

KU QËNDRON RËNDËSIA E KËSAJ MONOGRAFIE?

Përpos që vjen me një aparaturë të konsoliduar shkencore dhe me burime të pasura bibliografike, autori, prof.dr. Ramiz Abdyli, për herë të parë në historiografinë tonë sjell të plotë veprimtarinë e një klubi në hapësirën e dikurshme shqiptare që ishte unike.

Klubi i Shkupit fuzionoi shqiptarët e të gjitha krahinave e të gjitha religjioneve dhe u bë, kështu, zëri më artikulues i interesave kombëtare në prag të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

Meritë tjetër e këtij klubi është edhe oksidentalizimi i veprimit kolektiv të shqiptarëve, si në rrafshin politik, ashtu edhe në atë arsimor e kulturor.

Por, të gjitha këto detaje e risi nuk kanë mundur të dalin dhe të bëhen pjesë e interesimit të lexuesit të sotëm, pa insistimin këmbëngulës të autorit – Prof. dr. Ramiz Abdylit, i cili përpos tjerash këtë vepër na e bëri edhe më të dashur me stilin e tij të shkruarit konciz e përmbajtësor, një vlerë kjo që e karakterizon gjithë opusin e tij shkencor e hulumtues.

NJË BIOGRAFI QË NA E JEP TË PLOTË FIGURËN E GJENERAL MOISIUT

Nga Prof. Dr. Nasho Jorgaqi

Në historinë moderne të Shqipërisë, që nis pas shpalljes së Pava-rësisë, fisi i Moisive zë një vend krejt të veçantë. E them këtë duke patur parasysh që nga gjiri i këtij fisi dolën dy personalitete të shquara, një nga fusha e artit skenik dhe tjetri nga ajo e strategjisë ushtarake. Është fjala për artistin e madh me famë botërore, Aleksandër Moisiun dhe ushtarakun e rangut të lartë, Gjeneral Spiro Moisiun.

Ushtaraku Spiro Moisiu, hyri në jetën e shtetit të pavarur shqiptar në momentet e para të ngritjes dhe afirmimit të tij. Ndryshe nga shumica e ushtarakëve shqiptarë që vinin nga shkollat osmane dhe i kishin shërbyer interesave të shtetit perandorak turk, Spiro Moisiu ishte nga pionierët e parë që u përgatit e u afirmua në perëndim në shkollat e Austrisë, aq të njohura e të çmuara në historinë ushtarake. I brumosur me ideale patriotike dhe progresiste, erdhi në Atdhe për t'i shërbyer popullit të tij me përkushtim, sipas interesave dhe nevojave të shtetit të ri shqiptar.

Nga kjo pikpamje, në jetën e tij u reflektua e u pasqyrua historia e ushtrisë shqiptare me të përpjetat e tatëpjetat e saj. Spiro Moisiu, duke kaluar nga një sistem politiko-shoqëror në tjetrin, ku spikatën ngjarje historike të ndryshme, ai i shërbeu interesave kombëtare dhe i qëndroi besnik idealeve patriotike dhe përparimtare. I lindur me prirje ushtarake, patriot i patundur, trim dhe me një përkushtim të admirueshëm për këtë detyrë fisnike, pavarësisht nga rrethanat, ai u vu totalisht në shërbim të popullit e Atdheut.

Ai shërbeu me devotshmëri në të katër anët e vendit, nga veriu në jug, ku dhe kontribuoi me përgatitjen e angazhimin e tij në mbështetje të një ushtrie kombëtare shqiptare. Spiro Moisiu dha një shëmbull të lartë atdhetarizmi në kohë tepër të vështira, konkretisht gjatë luftës italo-greke kur tërhoqi nga fronti i luftës repartin shqiptar "Tomorri", për të shpëtuar nderin e popullit të tij. Me këtë akt trimërie e atdhetarizmi, ai tregoi se zotëronte jo vetëm një strategji të suksesshme ushtarake, por dhe një strategji politiko-patriotike.

Ky qëndrim i lartë patriotik u manifestua dhe hyri në histori, kur ushtaraku strateg mori përsipër detyrën e madhe të Komandantit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nac.Çl., që e çoi vendin në çlirimin e plotë nga pushtuesit nazi-fashist. Veprimtaria ushtarako-patriotike e Spiro Moisiut më pas do të lartësohej më shumë në kontributin e tij të çmuar që dha në organizimin dhe kualifikimin e ushtrisë sonë popullore nën pushtetin e ri të Shqipërisë Socialiste.

Nuk mund t'i mbyll këto rreshta, pa revokuar dhe një kujtim të fëminisë time, ku kam patur fatin ta shoh nga afër dhe ta takoj Major Spiro Moisiun, siç i drejtoheshin atëherë atij.

Ishte korriku i vitit 1942, kur unë djalë 10 vjeçar, shkoja shpesh për pushime tek xhaxhai i Nënës time, Llazar Bozo në

Kolonjë të Lushnjes. Shtëpia e tij ishte kthyer në një bazë lufte, mbasi e gjithë familja, ai vet, e djemtë e tij, Aleko, Koli, Irakliu dhe Petri, (dëshmor i Atdheut) vrarë nga bashkëpuntori i fashizmit, krimineli Isa Toska, militonin në lëvizjen partizane Nac.Çl. Aty ishte strehuar dhe Major Spirua, i cili sapo kish dal në ilegalitet, pasi përndiqej nga qeveria fashiste si bashkëpuntor me Frontin Nac.Çl. të luftës partizane kundër fashizmit.

Mua, si fëmijë që isha, më bënte përshtypje të thellë pamja e tij burrërore, autoriteti e respekti i madh që ai gëzonte nga njerëzit që vinin e takonin dhe mernin këshilla prej tij. Ishte koha që organizohej Çeta e Parë partizane e Myzeqesë, që u krijua në fshatin Kolonjë dhe më pas Batalioni partizan nën drejtimin e atij ushtaraku të lartë, i cili kish braktisur frontin e luftës italo-greke dhe ishte kushtuar kauzës së lirisë së Atdheut të tij.

Unë do të isha atje dëshmitar dhe në verën e vitit 1943, kur një mëngjes herët, ai bashkë me Xha Llazin (Llazar Bozo) dhe dy partizanë që i shoqëronin, hipur në kuaj, u larguan nga Kolonja. Askush nuk e dinte se ku do të shkonin, por më vonë e mora vesh se u nisën për në zonën e Darsisë e Sulovës, ku ndodhej me detyrë luftarake Batalioni partizan i Myzeqesë dhe prej andej, sipas porosive që ishin dhënë, Major Spiro Moisiu do të nisej në një mbledhje historike që do zhvillohej në Labinot, ku ishte caktuar për t'u zgjedhur Komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nac.Çl.

Kjo ngjarje më ka mbetur në kujtesë për tërë jetën. Do të mburresha më pas, që kisha patur fatin t'a njihja nga afër dhe të dëgjoja këshillat nga një figurë historike e Luftës Antifashiste Nac. Çl., siç ishte Major Spiro Moisiu.

Pas luftës, unë e kam takuar vetëm njiherë Gjeneral Moisiun, kur ai drejtonte SHNUM-in në një mbledhje pune dhe unë i dhashë të njohur. Ai buzëqeshi dhe më përqafoi duke më thënë fjalë të përzemërta, që më kanë mbetur të paharruara. Dhe më vjenë shumë mirë, që shkrimtari dhe miku im i nderuar Jovan Bizhyti, ka ndërmarë këtë punë të vyer për të shkruar biografinë e tij, një vepër të denjë për një personalitet të lartë e të nderuar si Gjeneral Spiro Moisiu.

Jeta dhe veprimtaria shumëvjeçare e këtij personaliteti për kauzën e mbrojtjes dhe pavarësisë së Atdheut, është trashëgimnia më e vyer që ai na ka lënë dhe që gjithë brezat e shqiptarëve do i jenë mirënjohës për jetë.

Këtë thesar pati në dorë shkrimtari i talentuar, prozatori dhe poeti, por dhe studiuesi e biografi, Jovan Bizhyti, që studioi dhe hartoi librin për jetën e kontributin e Gjeneral Spiro Moisiut. Ai e ka dhënë atë në portretin e tij poliedrik, patriotin, progresistin, njeriun me karakter të fortë e konseguent, burrin trim të betejave luftarake dhe ushtarakun e talentuar në një përballje të madhe, siç ishte lufta e lavdishme Nac.Çl. që solli çlirimin e vendit.

Me punën e përkushtimin, me përvojën e krijuesit të talentuar, duke çmuar më tej dhe kontributin studiues të tij, autori ka arritur të realizojë një biografi që na e jep të plotë figurën e Gjeneral Moisiut. Në ndërtimin e biografisë, janë harmonizuar kritere teknike me ato kronologjike, duke e dhënë figurën e Gjeneral Moisiut gjithnjë në rritje përmes ngjyrash e situatash dhe veprimtarisë së tij të gjithanëshme dhe intrasigjente. Ndjehet pena e shkrimtarit në zbulimin e botës shpirtërore dhe e karakterit të heroit, vepër që karakterizohet nga një rrëfim i rrjedhshëm, i bukur dhe i besueshëm, me një stil letraro-dokumentar, lakonik, me referenca arkivore, e larg fjalëve të tepërta moralizuese.

Pa dyshim, kjo vepër monografike është një kontribut i çmuar në letërsinë dokumentare, por veçanërisht në letërsinë biografike, si një shëmbull për ata që tentojnë të punojnë në këtë fushë.



- Romani "Pragu i braktisjes" i Andreas Dushit dhe një krahasim i rastësishëm me romanin "Amerika ose i zhdukuri" i Franc Kafkës -

MOSHA E SHKRIMTARIT, KUR ROMANI I NJË TË RIU ËSHTË VËRTET I RI...

Nga Visar Zhiti

Mosha e shkrimtarit të ri është e vjetër dhe mosha e shkrimtarit të vjetër është e re dhe ky paradoks ndodh vetëm në letërsi.

Shkrimtari i ri ka moshën e veprave të vjetra të botës që lexon, kurse shkrimtari i vjetër rinohet nga e reja që paraprin…

* * *

Librat e të rinjve, dihet, janë tjetër gjë nga librat e rinj, por kur librat e të rinjve janë vërtet të rinj, dua të them risi, ajo letërsi është me fat.

Dhe risitë, kur janë të qendrueshme, mbeten si të tilla, nuk dalin prej letërsisë, gjë që është më e rëndësishme, sipas meje, se sa kur futen në historinë e një letërsie, që është dhe tjetër.

Shkak i përsiatjeve të tilla u bë leximi i romanit "Pragu i braktisjes" i shkrimtarit të ri, Andreas Dushi, që, pa i mbushur 20 vjeç, në kohën e tij studentore, ka botuar dy romane dhe është bërë emër i dashur dhe me intervistat në gazetën letrare kulturore "ExLibris", që u merr shkrimtarëve të ndryshëm, patjetër më të vjetër se ai, studiuesve, përkthyesve, akademikëve, edhe jashtë vendit, deri dhe në kontinente të tjera dhe të bëjnë përshtypje jo vetëm korrektesa profesionale, pyetjet të barabarta me përgjigjet, informacioni qenësor, idetë, etj.

Nëse në intervista mëtohet të zbulohet diçka më shumë nga i intervistuari, që ka një karrierë, arritje apo lavdi, në romane, duke u zbuluar realitete të tjera, më saktë duke u krijuar realitete paralele, që s'janë më të atij që i shkruan, por shtojnë estetikën e jetës te lexuesit, emocionet, përjetimet, përftohen jetë të tjera.

Kur pashë romanin e parë të Andreas Dushit, "Marrja e gjakut", botim i "Onufrit" 2018, trajtim i një të kaluare në kufijtë e legjendës dhe mësova se autori sapo kishte dalë nga adoleshenca, pata një adhurim, jo thjeshtë prindëror, por atë të magjepsjes që të jep letërsia dhe shkruajta diçka. Andreas Dushi s'ishte thjesht i riu që premtonte, ai ishte nisja e një shkrimtari.

Dhe ja, nuk vonoi, romani i dytë, "Pragu i braktisjes", botim i "Albas" 2019. Më habiti me ndërmarrjen që Andreas Dushi, fare i ri, që do të mendonim se ende nuk ka të shkuar si shkrimtar, kërkon të në tregojë se si do të mund të jetë e ardhmja… e botës.

Nën optikën rinore, tekstet e tij plot ndjesi dhe ngjarje, me fantazi të begatë, përzierja jetësore e tyre, befasitë, japin një joshje gëzim-shqetësuese, duke krijuar një si antikronikë, madje të së ardhmes, ku ngjarjet nuk ruajnë dhe aq rendin, por pranëvënien, një urbanistikë letrare kjo, pa qetësi, larg mënjanësisë, në fund të fundit një prurje e veçantë, duke arritur më të rëndëshimen, *stilin,* përvijimet e tij. Që i diktohen dhe një jete: një *ultra-post-modernizëm*, kështu thuhet në roman. jo thjeshtë në art, por në artin e të jetuarit, të kërcënuar nga alienimi, sepse *nuk gjen një vend tjetër ku të mos mbizotërojë gjithçka që është tërësisht e gabuar*. Qortim general, o menjëhershëm. Duhet të dëgjohet klithma e njeriut mes zhurmave dhe rrëmujave, sirenave të alarmeve, të makinave të ndihmës se shpejtë, zjarrfikseve, metrove, që të çojnë kudo, veç jo te vetja, madje as tek tjetri… Kështu duket në roman.

Shqetësimet për të ardhmen, besoj, se janë po aq, në mos më shumë, për të tashmen, *urrejtja ishte pak a shumë njëlloj si dashuria…* lexojmë dhe kjo është dëshpëruese.

Ç'perspektivë po përgatitet, si po veprojmë, a dimë të jetojmë mirë, shendetshëm, që të meritohet një e ardhme sa më shumë njerëzore dhe jo vetëm sa më shumë teknologjike e një oligarkie sunduese?

Realiteti është i pamëshirshëm, duket sikur s'ka kohë për asgjë, prandaj të rinjtë s'kanë ç'presin, por ta rrëmbejnë atë, kohën që u duhet dhe duhet për të bërë vetveten dhe kohën. Rinovimi që do të sjellin, të bashkohet me përvojën e brezave, sipas një porosie, që dëgjova në një meshë, *we need trouble to grow* – na duhen shqetësime që të rritemi.

Përgjegjës për të ardhmen më shumë janë "të rriturit" sot se sa "të rinjtë" nesër.

NJË NDËRPRERJE:
NËSE DO TË FLISNIM PËR MOSHAT:

Por po flasim për librat, për letërsinë, e nisëm me të rinjtë, ku mosha s'është pengesë për arritjet, por të tjerat. Pjekuria ngjan me talentin, e dinë vetë rrugën e ardhjes. Si asosacion idesh më përsillen emra dhe mosha sfiduese. Në fakt e reja ka ardhur me të rinjtë.

Më nëpërmendet Jeronim De Rada, ishte vetëm 22 vjeç kur shkroi "Milosaon" e tij, që rilidhi poemën shqipe me atë europiane, ndërsa Naimi 40 vjeçar do të shkruante "O malet e Shqipërisë" e At' Gjergj Fishta 66 vjeç do të botonte të plotë "Lahutën e Malcis". Dy themeluesit e tregimit modern shqiptar, Ernest Koliqi 26 vjeç botoi librin e parë e Mitrush Kuteli e nisi nxjerrjen e poezive të tij që 13 vjeç. Migjeni jetoi vetëm 27 vjet dhe me 3-4 vjetët e fundit krijimtari, poezinë dhe tregimin i bëri më kritike duke çromantizuar letrat shqipe, ndërsa Kadare ishte 27 vjeç ku shkruajti romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", që jo vetëm iu shmang realizmit socialist, por kontemporanizoi romanin shqiptar me atë botëror duke marrë dhe vetë një njohje të tillë.

Jam i ndjeshëm ndaj moshave të ndërprera, ku kanë ndërhyrë dramat e rënda. Regjimi diktatorial dënoi shkrimtarë në kulmin e krijimtarisë, madje pushkatoi poetë të rinj si Trifon Xhagjika, 31 vjeç, Vilson Blloshmin më pas ende më të ri, 29 vjeç.

Shkrimtarja Musine Kokalari librin e saj të parë e botoi kur ishte 24 vjeçe, në moshën 26 vjeç themeloi një parti opozitare social-demokrate dhe në moshën 29 vjeçare e arrestojnë dhe dënohet… gjithë jeta i shkoi në burg dhe internime, pa shkruar e botuar dot më.



E njoh këtë tmerr. Thjesht po tregoj që dhe mua më arrestuan për poezitë e mia pa i mbushur 27 vjeç, ndërkohë gjimnazist kisha shkruar dhe dy drama, i ruaj ende fletoret e tyre, dua të them që u rritëm në kohë pa të ardhme, ndërsa vonë kam mësuar që arbëreshin De Rada, meqenëse e kujtuam, një shekull e gjysmë më parë, kur e kishin arrestuar në Italinë e Jugut në ato lëvizjet antiburbone, gjykatësi, me të marë vesh që ai djalosh shkruante poezi, e liroi menjëherë.

Të mësojmë nga të kaluarat. Letërsia është liria dhe dënimi. Mund të çlirojë të tjerë dhe dënon veten, po aq dënon dhe të tjerë dhe çliron veten.

Prandaj duhet të na ngazëllejnë të rinjtë. Jo vetëm duke u dëshiruar të ardhme, por duke punuar për të.

Në letërsitë e tjera shembujt kësisoj janë dhe më të shumtë, shkrimtari amerikan p.sh, Ernest Heminguej ishte 18 vjeç kur erdhi në Europë gjatë Luftë I Botërore, u plagos dhe nisi të mendojë për romanin "Lamtumirë armë", që do ta botonte kur do të ishte 30 vjeç. Ndërsa Tolstoj në pleqëri do të shkruante kryevepra e Kazanzaqis mbas moshës 65 do të bëhej i famshëm.

Ndoshta gjenerata e Andreas nuk e di se vepra të tilla ndodhte që të botoheshin dhe në shqip, por më pas ndaloheshin, siç i duhej diktarurës, sundimtarëve që gjykonin dhe letërsinë dhe artet.

Po kështu ishin të ndaluar, p.sh, poeti ruso-sovjetik Esenini, i dashur deri në dhëmbje nga brezi im, por që e vetëvranë të ri apo dhe Majakovskin e tyre. Kujtoj që të ndaluar kanë qenë poeti amerikan Walt Whitman, shkrimtarët si Remark, Steinbeck, Shollohov, etj, etj, patjetër të ndaluara ishin dhe Bibla e librat e religjioneve.

Kur ndryshuan kohët dhe shkova me punë në Itali, më ka pëlqyer të shkoja sa më shpesh librarive, të merrja libra të të rinjve; italianët, më dukej, se janë dhe më afër nesh; doja të shihja se si e shihnin botën, dashurinë, seksin, ëndrrat, prindërit, të ardhmen, si ishte ekzistencializmi i tyre, duke mos iu trembur sinqeritetit, por absurdit, svetënimit, sidomos të rejat, kishte nga ato që në librat e tyre të parë mbërrinin në çmenduri, por pa çmendurinë.

E doja revoltën e të rinjve. Ashtu siç do ta shihja dhe te im bir, Atjoni, që nisi të botojë traktate filozofike, siç po i quante, që kur ishte 18 vjeç, i dërgonte nga Italia, ku studionte dhe të pa përfunduara dot, iu botuan një vit më vonë në librin e tij "Për atë që dua(m)".

E gjitha bëhet për atë që dua(m). Nga e mira. Por *a e njohim të mirën?* – pyeste Atjoni duke më rrëqethur.

Prurjet janë të ndryshme dhe ashtu do të duhej, frymëzuese, kanë kohën e tyre, ndërsa letërsia, si të thuash, është gjithkohësi, luan dhe me moshat, siç e pamë, teksa moshat mesatare zakonisht bëjnë dhe letërsi mesatare, ndaj, e përsëris, na ngazëllejnë veprat e të rinjve. Kanë shumë rëndësi. Kërkoj porositë që dalin prej tyre. Për kë? Për askënd. Për veten? Për artin e të jetuarit me art? Për të gjitha…

* * *

Rikthehemi te "Pragu i braktisjes". Ndërkohë, rastësi natyrisht, kisha rimarë ndër duar romanin "Amerika ose i zhdukuri" të Franc Kafkës, por që ndoshta jo rastësisht bëri të krijoj disa paralele, ngjashmërira të të pangjashmave. Te i zhdukuri ka braktisje, po mendoja, te braktisja ka zhdukje.

Dhe po them prapë që brezi im, në moshën e Andreas, e kishte të ndaluar emrin e Franc Kafkës, edhe pse nuk ishte përkthyer fare. Ia mësuam emrin nga që shahej në gazetat letrare apo në leksionet e katedrave të letërsisë.

Pa dashur të bëj kritikë e analiza letrare, as recensione, *review* të librave, thjesht po flas, po tregoj një përshtypje, për freski bisede me këtë kapërcim pindarik. Dhe për hakmarrje që na lanë pa Kafkë. Mbi të gjitha për ngazëllimin estetik që më jep letërsia e te rinjve, konkretisht ajo e Andreas Dushit.

KAFKA, KUR ISHTE MË I RI SE VETJA

"I zhdukuri" është romani i pari ndër tre romanet e Franc Kafkës, e nisi kur ishte 28 vjeç, por u botua postume dhe i fundit, në Gjermani.

Dhe titullin "I zhdukuri" miku i tij, shkrimtari Maks Brod, ai që nuk zbatoi porosinë e Kafkës për t'ia djegur Veprën, duke u bërë kështu përplotësuesi besnik, i madhërishëm i një testamenti shpirtëror të pashkruar, ia botoi Veprën, ndërkaq ia ndërroi titullin romanit, ia bëri "Amerika", sepse duhej prapë një K, që Kafkën e ndillnin aq shumë, siç e kishte "Kështjella" e tij apo siç ishte personazhi tjetër, Jozef K.

Ameri-K-a e Kafkës, (në gjermanisht shkruhet me k), s'është Amerika e vërtetë, ku ai nuk shkoi kurrë, por e fantazoi atë dhe ne gjejmë shumëçka që te Kafka i mëpastajmë do të sublimohej mynxyrshëm: ikjet me asgjëkundin, fatalen me absurdin, sinqeritetin me të pakuptueshmen, dashurinë me groteskun, dënimin pa fajin, mëkatin e lindur, mundimin e pashpresë, alienimim, etj, etj.

Patjetër që është libri me humorin më të begatë të Kafkës para se ky humor të bëhej gjëmëtar.

Kemi një **K**arl të pafajshëm, adoleshent, (a thua është një *alter ego* e Kafkë vetë?), që:

1- E përzënë nga shtëpia, madje dhe nga vendi, sepse është abuzuar nga shërbëtorja e familjes, që ka mbetur shtazënë... dhe Karli mbërrin në SHBA.

Dhe mësuesi i dikurshëm, i stërvitur me dometheniet e librave, do t'u thoshte nxënësve se "klasa punëtore"/ shërbëtorët e kapitalizmit, po u qaseshin përmbysjeve me dhunë në Europë, etj, etj.

2- Kur Karli 16 vjeçar është në New York, ku Statuja e madhe e Lirisë nuk është siç është vërtet me pishtarin e lirisë në dorë, por me shpatën, ai zbulon dajën e tij dhe nuk kërkon as të fshehë të kaluarën e tij e as emrin, por përpiqet të nisë një jetë të re, pa të dikurshmen, pa kurrfarë identiteti. Daja do ta përzërë më pas për arsye marrëdhëniesh familjare dhe K. del në rrugë të madhe.

3- Bota e re ishte ende më e madhe, e zhurmshme, përpirëse, me drita, por njeriu si kudo, ende mbetej i pa ndriçuar nga brenda dhe jetës sikur i mungonte shija e përditshmërisë, zelli ndjehej i verbër.

Shokët e rrugëtimit të Karlit duken si shumë të zotë për të qenë të liq, e do të gjendej gjithmonë dikush me më shumë cmirë dhe i pabesë, Karli ndërkaq do të kompleksohet edhe më, aq sa ndihma që u jep të tjerëve, i zhbëhet në të ndërsjelltë, etj, etj.

4- Befasitë, lëniet përgjysmë të shumë gjërave, zhurma të pakuptuara, konviktet si burgjet, fushata zgjedhore absurde, hotele si qeverira festive e shtypëse, të dashura të dhjamura, kotësira serioze, që shndërrohen në rrahje ende më serioze, etj, etj. Për të gjetur punë, në fund të romanit, K. përzgjedh emrin "Negro".

Mos do të thotë se të gjithë jemi robër të punëve të tjetrit më shume se sa tonave? – do të pyeste ai mësuesi nxënësit.

5- "Amerika" e Kafkës në fund të fundit është për tjetër kontinent, atë të njeriut, në anën e natës së tij, me mbarimin e mosmbarimit, me mosmbarimin e mbarimit, (është bërë truk letrar mosmbarimi i veprave të Kafkës) dhe të një brilance të përzishme kafkiane...

ANDREASI, MË I VJETËR SE VETJA...

Rreth 110 vjet më vonë në Shqipëri, një student, Andreas Dushi, boton romanin e dytë, "Pragu i braktisjes", dhe, shtoj, është 10 vjet më i ri se Kafka në romanin e parë.

Por rendis 5 çështje dhe për këtë roman, me pakëz koment:

1- Këtu nuk kemi përzënie, por një vetëpërzënie, ikje me dëshirë, jo në Amerikë, por për atje nga u nis Kolombi për të zbuluar Amerikën, në Spanjë dhe edhe Andreas ashtu si Kafka që e vendos romanin në një vend ku s'ka qenë kurrë, e vendos në të ardhmen, ku nuk ka shkuar ende.

Protagonist është Noe Dajani. Nuk duket të jetë alter egoja e autorit dhe si për të na siguruar, në roman na del, të paktën dy herë, një personazh me emrin e njëjtë, Andreas Dushi, si në veprat postmoderne, por së bashku ata përbëjnë hijen e alter egos autoriale.

Ku po shkon shoqëria? Është një kohë kur: *Njëlloj si e qeshura, edhe e qara më duket një mbetje arkaike e trajtave të hershme njerëzore, që me kalimin e kohës shpresoj të zhduken deri sa* të treten në harresën e të ekzistuarit. – thuhet në roman. Një hop tjetërsimi ky. Shqetësues.

2- Dhe te "Pragu i braktisjes" ka shtatzani, jo shërbëtoreje, por nevojitet një shtatzani për të siguruar azilin, sipas një ligji spanjollo-europian dhe këtu fillojnë llogaritë me jetën si të ishte një biznes. Do të duhet një martesë kot, për të patur një fëmijë kot... Që pa lindur, je i thirrur për një manipulim. Pastaj s'do të duhen më as martesa, as familja, etj. Dhe nisin organizimet *duke krijuar shoqatën "Jo martesës!"* dhe pse? - *për* të ruajtur gjysmën e pasurisë të cilën as nuk e pata të rrezikuar, - tregohet në roman. Ja, pra dhe lëvizjet, sado të mëdha qofshin, kanë interesin vetiak të dikujt, papërgjegjshmërinë vanitoze të të gjithe....

3- Jeta (në Spanjë), me thyerjet (në Shqipëri), ku përzihen një donkishotizëm mitoman, sa argëtues edhe i trishtë, ngrihet mbi "sikur-in" si në teatër, që ajo që duam, edhe po s'qe e vërtetë, e shëndetshme moralisht, do ta trajtojmë si të tillë. Protagonisti, i famshëm (në Madrid), merr kurorën e mbretit të poezisë, teksa jeta zbrazet nga poezia.

4- Duke përdorur *flash-future (proleksin)* protagonisti shkon në moshat ku autori ende nuk ka shkuar dhe ndodhitë ku bota është në prag. .

E tashmja e ardhme të tremb. Flligështi deri në krenari agresive. Një jetë e çthurur, që për ata që e bëjnë, është një thurje tjetër. Kapërcimet janë pindarike. (prandaj bëra dhe unë krahasime kësisoj). E ardhmja e pa ardhur... protagonisti nga 18 vjeç bëhet 31, pastaj 40, 50, 60 vjeç dhe arrin përsiatjen: "*që të ndieja se kisha përgjegjësi karshi botës* . Pra, ka shpresa.

5- Te "Pragu i braktisjes" si te "Amerika ose i zhdukuri" me protesta nga fundi, lëvizjet janë të qarta turbullisht, me zanafillë mashtruese, plangprishëse, etj, pra zbulohet dhe mbulohet bota përreth.

Befasira personazhesh, historitë e tyre trillane dhe teksa del një Mrikë me gegnishten e saj, del dhe një *Enxhi - presidentja e Konfederatës së Vendeve Evropiane... Bashkimi Evropian është shkatërruar në çastin që u kuptua se globalizmi ishte një dështim... i suksesshëm.* Një globalizëm ku humbin identitetet kombëtare dhe vetanake, do të ishte i padëshiruar, madje i dëmshëm.

Dhe prapë kalohet te dramat e thjeshta të personazheve, ja, prift Ernesti, i riu, me mëkatet para misionit, etj, etj, prehje s'ka, vetëm kërkime. vetmi me të tjerë, të tjerë po aq vetëm. Fermat e qumshtit njerëzor, kompjuterizimi i lajmeve, laboratizimi i jetës, sikur rikthehet 84 orweliane, ndjekja e katolikëve, tërmete, Papa në ilegalitet, Vatikani i djegur, Statuja e Lirisë në New York, jo si te Kafka, por e rrëzuar mbi oqean, të duket se po shfleton një album të gjallë të Salvador Dalísë, vdekja e dashurisë njerëzore, e moralit të jetës, e të zakonshmes, etj, shuarja e dritës botërore dhe errësim për njerëzimin tjetër, të ardhshëm, se bota tani është në pragun e braktisjes, të apokalipsit...

Në moshën që kam, vërtet gjithçka dua është drita, jo pse mendoj se është ndonjë e mirë e madhe, por ngaqë e di se pa të nuk ka kuptim asgjë. Romani hedh dyshimin e duhur, atë çarje, nevojën e ndriçimit...

Alarmi që ngre "Pragu i braktisjes" është i rëndësishëm, mbrojtja e vetvetes së ardhme, e gjeneratave të reja njerëzore. të njerëzimit nga një tëhuazim asgjësues.

Ç'duhet bërë? Mua si prind më vjen prapë në mendje ajo që shkruante në një artikull të shkurtër Atjon Zhiti, po në moshën kur Andreas Dushi shkruante romanin: *Të ndërgjegjësohemi e së bashku të bëjmë një* ***kryengritje morale*** të vazhdimtë.

Dhe ky roman është një kryengritje e brendshme artistike, një krijim distopik i përshtatur me eksterieret e fantazuara, ndërtimi i të cilave duhet t'u ngjante, me krerët që çngjeshen, ndërprerjet maniake, digresionet e përsëritura, karakteret-skicuar shpejt, seriali i femrave që shfaqen si në një pasarelë, dramatike gjithsesi, deri edhe macet, edhe...

Ka një si mëdyshje në roman ku nga mosthellimet shkohet në humbella, me një si ngut, me copëzime, pa përfundime, filmik, nuk do që të mbarojë. Shtëllizja e kohës ngjan si me



shtëllizjen e një trikoje a fustani të bërë me shtiza, ku i është kapur filli, që teksa tërhiqet, veshja zhbëhet dhe shfaqet lakuriqësia. Dhe e shkrimtarit dhe e lexuesve të tij. E të gjithëve.

Mungesat sikur bëhen dhe funksionale, se të tilla janë dhe qëllimet, dhe ankthet dhe troditetjet. Protagonisti Noe duket se s'ka as veten, as arkë për ta shpëtuar në apokalips. Natyrisht nëntekstet ngërthejnë qëndrime, angazhime intelektuale, përkushtimin në mbrojtje të lotëve njerëzorë dhe të qeshurës së njeriut. Përsiatjet arrijnë deri në filozofi nihiliste, në psikoanalizë. Gjuha shpesh bëhet sentenciale, që godasin si maja thikash, por edhe poetike, aq sa pranon proza e mirë, ku mund të futen dhe poezi të mirëfillta. E tillë është poezia e zërit të fëmijës së palindur që nga parajasa. *Mami,/ Babi,/ jam unë,/ Nuk më njihni?/ Jam djali që nuk e latë të lindë./ Jo pse më abortuat si shumë miq këtu në Parajsë,/ por nuk më deshët,/ pasi nuk deshët as njëri-tjetrin!..*

Në fund të fundit ky është thelbi i krijimit. Bota do dashuri, që të lindë dhe e palindura e botës dhe të jemi prindër të jetës, áma, së bashku vetë jeta.

Pragu i braktisjes, pra, është prag, ku në anën tjetër është mosbraktisja, mosbraktisja e misionit hyjnor, e vlerave të saj tokësore, e dritës dhe e natës njerëzore.

Mesazhi i Anreas Dushit është me anën këndej të pragut, jo nga ana andej e romanit të tij dhe ai jep alarmin. Me thjeshtësinë e së vërtetës.

Nanës, asaj që sa herë frymon, frymëzon! - është dedikimi në *frontispiece* të librit. Dhe latinët e thoshin më herët: *na jepni nëna të mira që të bëhemi fëmijë të mirë.*

NË VEND TË NJË MBYLLJEJE

Andreas Dushi – profil i një krijuesi të ri, zë i veçantë dhe i bukur, përfaqësues së pari i vetes, por dhe i letrave që sjell gjenerata e tij në shekullin XXI.

Ai lindi një dekadë pas rënies së perandorisë komuniste dhe të Realizmit Socialit, që, më shablloni, më mediokri e vrastari, sundoi në Shqipëri.

Pasi u hap vendi dhe shqiptarët nisën të mërgojnë, afër në Greqi e në Ballkan deri në Rumani, kapërcyen detin dhe u dyndën në Itali e u përhapën kudo në Europë, Francë, Gjermani, Zvicër, Belgjikë, Vendet Nordike, etj, kaluan dhe oqeanin, sërish në Amerikë, me familje, me fëmijë, lindën dhe fëmijë të tjerë, që shkollohen në metropole, në universitete të njohura të botës, etj, dhe po dallohen, ka nga ata dhe në krijimtari, duke shkruar në gjuhët e vendeve ku janë.

Ndërsa Andreas Dushi studimet universitare sapo i mbaroi për gjuhë dhe letërsi shqipe në vendlindje, në Shkodër, tranzicionologjia në Shqipëri është plot me çështje e probleme si ato të varfërisë, korrupsionit, mosdënimit të së kaluarës diktatoriale, persektivës së pazbehur euroatlantike, etj, dhe duket sikur vendi ynë bën pak, shumë pak për letrat, (jo letrat për të ikur), sidomos për shkrimtarët, për mirëqenien e artistëve, por unë jam nga ata që besoj se letërsia shqipe tani është më e mirë se më parë, të paktën është e lirë, aq e domosdoshme për një letërsi dhe arritjet janë të begata.

Ndërkaq emri i Andreas Dushit ndrin yllësisht, ai që tani është një prurje e së ardhmes, një sfidë dhe shpresë dhe besim, një rekord, që ja, Shqipëria e hapur po nxjerr nga brendësia e vetes zëra. Të rinjtë duhen dashur me shpirt dhe mbështetur fuqimisht. Patjetër dhe shtetërisht. Është detyrë.

Dy romanet e Andreas Dushit, njëri që shkon në të kaluarën dhe tjetri në të ardhmen janë trualli më i mirë i një të tashmeje përbashkuese letrare. Pritet. Estetika e emocioneve, fantazia e re në fund të fundit tashmë e kanë dhënë shkrimtarin e ri.

"Autoportret me teleskop" i Besnik Mustafajt botohet në greqisht

NJË ROMAN PËR "KONFLIKTIN" NDËRMJET POLITIKANIT DHE SHKRIMTARIT

Nga Emilio Solomou

Lexuesi i romanit të Besnik Mustafaj me shumë gjasa ka iluzionin se po lexon një autobiografi. Për më tepër, protagonist-rrëfyes i librit është (ish) ministri i jashtëm dhe shkrimtari Besnik Mustafaj. Duke komentuar në libër këtë "keqkuptim", rrëfyesi do të deklarojë: "E kisha të pamundur ta shkruaja këtë paragraf edhe nëse do të zgjidhja një gjuhë më asnjanëse, atë të zhveshur së jashtmi nga përjetimet personale dhe t'i jepja personazhit një emër i cili nuk do të kishte ngjashmërinë më të vogël me timin. Nuk do të mundja me asgjë të çlirohesha nga mendimi se lexuesit, sido që të jetë, do ta kuptonin se aty isha unë vetë dhe jo ndonjë pjellë e shpirtit të flaktë të shkrimtarit Besnik Mustafaj". Në fillim të librit "Shkrimtari paralajmëron lexuesit e tij të dashur se nuk bëhet fjalë për roman autobiografik, edhe nëse një nga heronjtë e tij ka emrin e Besnik Mustafaj". Ndërkohë, në vazhdim këmbëngul në këtë premtim (siguri), ndërsa elementë të tjerë që paraqiten në libër kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me realitetin e tij. Sigurisht, bëhet fjalë për marrëveshje që ka lidhje me romanin postmodern, kufijtë fluide ndërmjet *fiction* dhe realitetit, dhe rrjedhshmërisë në subjekt, në karaktere, krijimin e vetvetes, përfshirjen e lexuesit. Një rast veçanërisht i njohur i mëparshëm dhe analog me orvatjen e Besnik Mustafaj është ai i shkrimtarit amerikan Philipe Poth. Në një nga romanet e tij postmoderne, te Ngjarjet me nëntitullin Autobiografia e një romancieri, Zukerman, alter ego e Poth-it, në mjaft vepra të tij, komenton në letrën e tij drejtuar shkrimtarit se shumë libra të tij nuk janë gjë tjetër veçse rishpikja e vetvetes dhe plotëson: "Ke shkruar për metamorfozat e vetvetes kaq shumë herë sa tashmë nuk e di më se kush je apo kush ke qënë. Ajo që je është një tekst në lëvizje".

Shkrimtari Besnik Mustafaj ka lindur në 1958. Është poet dhe romancier dhe ndër më të lexuarit jashtë shtetit, ndërsa vepra e tij është përkthyer në shumë gjuhë. Në 1999 ka marrë Çmimin e rëndësishëm Medicis në Francë për romanin e tij "Boshi". Ka qënë ambasador në Francë (1992-1997), anëtar i Kuvendit të Shqipërisë dhe ministër i jashtëm (2005-2007) në qeverinë e Berishës.

Këto dy cilësi, ajo e shkrimtarit dhe e politikanit, janë parametri thelbësor i romanit "Autobiografi në teleskop". Libri nis me pjesëmarrjen e Besnik Mustafaj si ministër i jashtëm i Shqipërisë në konferencën e shteteve mesdhetare. Në hotelin në Monako, përpara fluturimit për në Nikea, i afrohet Ana B., këshilltare e presidentit të Sllovenisë. Megjithë keqkuptimet, ata të dy do të zhvillojnë një marrëdhënie erotike. Ndërkohë, Ana B. është e njëjta protagoniste me atë të romanit "Boshi"; skena erotike me Arturin. Në këtë mënyrë, të dyja cilësitë, ajo e politikanit dhe e shkrimtarit, luajnë rolin e protagonistit në roman. Vazhdimisht, politikani Mustafaj është në kundërshti me shkrimtarin Mustafaj, i cili akuzon politikanin për privim të lirisë së tij. Madje, edhe "njohja" e tij me Ana B., rezulton nga mohimi i ministrit të jashtëm për të pranuar propozimin e presidentit të Sllovenisë për të pirë një kafe, sepse shkrimtari Mustafaj parapëlqeu të lexonte një përmbledhje poetike të Homer Aritzit.

Vetë Mustafaj duket se në të vërtetë është i ndarë mes këtyre dy cilësive të tij. Madje thuhet se në 2007 dha dorëheqjen nga pozicioni i ministrit të jashtëm për t'iu përkushtuar të shkruarit letrar. Në një intervistë të tij të vjetër dhënë Filip Drakondaidi (Hapi, 28 nëntor 2008), ka deklaruar: "[…] mbetem një shkrimtar që bën edhe politikë, jo një politikan që shkruan libra. Letërsia, për rrjedhojë, ka përparësi, pasi më lejon të ruaj lirinë time të brendshme dhe më mbron nga ndotja e politikës". I referohej me trishtim situatës që mbizotëronte në skenën politike të Shqipërisë, duke theksuar se "pushteti ka kaluar në duart e nomenklaturës së vjetër, në duart e njerëzve që kanë lidhje me mafian".

Mustafaj, shumë herë, ndërfut edhe një vetvete të dallueshme në rrëfimin e tij, përveç atë të shkrimtarit dhe të politikanit. Ky rrëfimtar vëren konfliktin ndërmjet ministrit të jashtëm dhe shkrimtarit: "sepse duhet të isha dëshmimtar në këtë grindje të dy të panjohurve që me shumë gjasa janë binjakë, kaq shumë ngjanin me njëri-tjetrin"(fq. 437)-«ne të tre»-. Në vazhdim, shënon: "Shkrimtari ishte egërsuar më shumë. Ndërkohë, politikani ishte bërë një grusht njeri dhe i heshtur dëgjonte me kokën e futur ndër supe" (fq. 438). Kështu, libri zhvillohet në një roman për "konfliktin" ndërmjet politikanit dhe shkrimtarit. Ky fluiditet intensifikohet me alternativën e përdormit



të vetës së parë dhe të tretë njëjës, të distancuar, (edhe pse kjo e fundit shfrytëzohet në mënyrë të veçantë në historitë e tij të shpeshta si të futura në kuti).

Rrëfimi zhvendoset nga e tashmja në të shkuarën e afërt (kapitujt në Nikea dhe në Bruksel) mbrapsht, në kohën e regjimit komunist të Enver Hoxhës pas Luftës së Dytë Botërore, deri në rënien e tij. Madje, përshkruhen edhe referime në kohë më të vjetra të historisë shqiptare. Në Bruksel, Mustafaj do të takojë në një darkë jo zyrtare me emigrantë shqiptarë, të njohur të vjetër, ish nxënës dhe miq. Në këtë mënyrë, kujtesa do të aktivizohet, për të kujtuar vitet e regjimit komunist. Çështjet e tjera që shqetësojnë shkrimtarin janë lidhja e politikës me krimin, krimi i organizuar i emigrantëve shqiptarë, problemi i refugjatëve në Europë, por mbi të gjitha, e kaluara komuniste e Shqipërisë: frika, Sigurimi, përndjeja e fantazmave për të gjetur "armiqtë e popullit", akuzat e paqëna ndaj qytetarëve, denoncimet e spiunëve, tronditja e besimit, edhe mes miqve, internimet, burgimet, shkatërrimi i jetëve. Mustafaj tregon kundërshtitë në Shqipërinë e të tashmes dhe të së shkuarës. Kritikon, psh. ish zyrtarë të regjimit komunist, të cilët u privonin lirinë qytetarëve, por që sot shkruajnë dhe botojnë kujtimet e tyre duke mbrojtur të drejtën e tyre në lirinë e shprehjes.

Një pjesë e librit ka karakterin e romanit të pjekurisë. Me interes të veçantë është fakti se romanin e përshkon aventura e shkrimit. Duke shfrytëzuar teknikat moderniste, shkrimtari na fut në laboratorin e tij, duke na paraqitur variante të ndryshme të historisë së tij, duke përsëritur skena të ngjashme, shumë pak të ndryshme nga njëra-tjetra, por me këndvështrime të ndryshme, duke adaptuar dyfaqësi, duke shpalosur plane dhe qëllime për shkrimin, në përgjithësi duke zhvilluar romanin brenda romanit dhe duke zbuluar përpara syve të lexuesit lindjen e një libri.

Shkrimtari adapton teknika të shumëllojshme, si mbyllja, shmangiet, parandalimet, përsëritjet e qëllimshme, historitë absurde që deri diku arrijnë në kufijtë e realizmit magjik dhe zakonisht jepen me doza të forta humori, fakt i cili kontriubon në kënaqësinë e leximit të tekstit (psh. gjeli që bëri vezë, gënjeshtrat dhe fuqia e mbinatyrshme e Selami Beshirit, ndërhyrja e Shqipërisë në zgjedhjet amerikane që të mos zgjidhej Obama). Komentet e rrëfyesit, i cili, siç u përmend edhe më lart, lëviz me rehati ndërmjet rrëfimit në vetën e parë dhe rrëfimit në vetën e tretë, janë të shpeshta, ndërsa ndonjëherë i drejtohet vetë rrëfyesit. Mustafaj dallohet për aftësinë e tij rrëfimtare dhe teknikat rrëfimtare të papërsëritshme. Në këtë mënyrë, leximi i romanit është një aventurë unike leximi.

botuar në revistën letrare *tovivlio.net*
më 22.6.2021

Përktheu nga greqishtja: Maklena Nika

Emilio Solomou (Αιμιλίος Σολωμού) – shkrimtar qipriot, fitues i Çmimit Letrar Europian për Letërsinë 2013. Në shqip qarkullojnë dy romane të tij nga Botimet Toena: "Ditari i një pabesie" dhe "Urrejtja, gjysma e hakmarrjes".

Romanin "Kronikat e Mjegullës" i Bashkim Hoxhës, botohet në rumanisht

HISTORIA NË SHNDËRRIMET E MJEGULLËS

Nga Cristiana Maria Hâncu, Rumani

Kronikat e mjegullës, romani i parafundit i shkrimtarit të mirënjohur shqiptar Bashkim Hoxha, tani i arritshëm përmes këtij përkthimi rumun nga Cristian Besleage, i propozon lexuesit që i përket së njëjtës hapësirë ballkanike, solidare dhe të përbashkët, një përpjekje të çkodimit të historise nëpërmjet një eksperimenti narrativ.

Organizuar në formën e një përmbledhjeje narrative dhe, historikisht, trans-figurative, teksti përmbledh, në hapësirën e tij relativisht të vogël, një shekull të historisë shqiptare. Shekulli i kaluar, ai që shpaloset deri tek ne, si një interval thelbësor i transformimit, përcaktimit dhe fiksimit të një identiteti të veçantë etnik, në bërjen e tij progresive historike. Nga vjeshta e vitit të Pavarësisë, deri më tani, nga 1912 deri në bashkëkohësinë më aktuale, atë të fokalizimit në perspektivën e njëqindvjetorit të saj retroaktiv.

Nga pikëpamja narrative, për t'u treguar historia merr hua dy vektorë nga hapësira e këtij romani. Ajo na arrin përmes dy trajektoreve të dallueshme të personazheve, dhe ndonjëherë kryqëzohen, në mënyrë të konsiderueshme, drejtimet e kundërta të dy protagonistëve Hëna dhe Azis Beu, që përfaqësojnë dy boshtet paralele të orientimit dinamik të veprimit, por edhe shfaqjen e dy poleve të kundërta, duke përbërë, megjithatë, përmes tërheqjes dhe refuzimit, çiftin simbolik të romanit.

Emri i personazhit ("Hëna", në shqip) e vë Hënën nën simbolizmin hënor, e cila nuk është vetëm ajo e transformimit dhe rritjes, por edhe stigma patetike e ritmeve biologjike dhe dritës në intensitetin e errësirës. Ndonjëherë konsiderohet si një shenjë e keqe dhe licencë seksuale, por është, në të njëjtën kohë, një simbol i pavetëdijshmes dhe i vlerave të natës dhe pjesa primitive e shpirtit të paqëndrueshëm, rebel, endacak, që i është lënë pre instiktit të aventurës, por që tërhiqet vazhdimisht dhe magjepset nga poli i kundërt, ai i fuqisë diellore.

Hëna kalon nëpër të gjitha trazirat e ngjarjeve të këtij shekulli të kaluar, duke evoluar në çelësin e një karakteri pikaresk, të dënuar me aventurën e adoleshencës së saj të hershme, e defavorizuar nga statusi i pasigurt shoqëror, vajza e paligjshme e një prifti dhe e një çingijeje, e hutuar nga epshi i njerkut të tij dhe i të tjerëve, jetime dhe e rrënuar nga varfëria ekstreme. Në një zell euforik, Hëna i ofron virgjërinë beut vendas, Azis Beut, duke rikonstruktuar një lloj "të drejte të natës së parë" dhe duke e vënë atë, disi të detyruar, në situatën e pranimit të tij, me hutim. Vijon, në formën e një "riparimi", martesa e vajzës me Masarin, stallieri shurdhmemec i beut, Hëna nuk mund të pranojë kontrastin e padurueshëm midis "effluvia jasemini" nga jataku i beut dhe "halesë" të tmerrshme të shtëpisë së saj të re dhe e braktis burrin e saj të ri.

Masar nuk mund t'i mbijetojë traumës.

Zgjedhja e një ekzistence rebele të të mbijetuares, aventurat pikareske do të shfaqen njëpasnjëshëm, një bashkëjetese në pyll me Cubin rebel dhe një martese rrethanore, me Dhimitrin fshatarak, pas lindjeve të shumta me atësi së ndryshme, frytet e të cilave do t'i lihen një ekzistence haptazi rebele, ekzistenca e tyre konspirative dhe ekzekutimi i dy djemve të saj do ta ngrinin papritur atë në dinjitetin e "nënës së qytetit", në vitet e çlirimit dhe diktaturës së Enver Hoxhës.

Në pjesën më të madhe, në rrafsh personal, iniciativat e Hënës do të shkaktojnë përparimin e ngjarjeve, në sfondin e një përqendrimi gradual të historisë, por edhe të relativizimit progresiv të perspektivave të saj, në dritën e personazheve të ndryshëm.

Hëna vetë riformulon, krejtësisht ndryshe, episodin e aventurës së saj të parë, bazuar në rrethanat e fundit historike, si dhe atë të ngritjes së flamurit shqiptar në ballkonin e sarajeve së Azis Beut, në ditën e shpalljes së pavarësisë, në varësi të tërheqjes-pakënaqësisë që bën atë të rijetojë me obsesion të dyja ngjarjet dhe t'i lidhë ato.



Shkrimtari Bashkim Hoxha së bashku me përkthyesin e romanit të tij në rumanisht, Cristian Besleage

Dhe zhdukja misterioze e Masarit shkakton të paktën katër hipoteza shpjeguese.

Elementi hënor i personalitetit të saj tërhiqet në mënyrë të papërballueshme nga simboli i fortë dhe diellor i personazhit që ndodhet në polin e kundërt. Ajo ia sulmon shtëpinë me gurë, kthehet për episodet verbuese të joshjes, vendoset me autoritetin e pushtetit popullor në sarajet e Azis Beut dhe e poshtëron publikisht, duke e asgjësuar atë përgjithmonë. Por duke formuar së bashku me të çiftin autentik, simbolik dhe paradoksal, mbi të cilin bazohet paralelizmi i trajektoreve të tyre.

Emri mysliman i beut, pasardhësi i një serie Eqeremësh, Halilësh, Dalipësh, Muharremësh, Selamësh dhe Samedinësh, është trashëgimtari i një simbolizmi përcaktues onomastik. Azis, një fjalë me etimologji arabe, që do të thotë „I forti", më vonë merr kuptimin "i dashur, i çmuar, i dashuruar", duke nënkuptuar forcën e karakterit të Azis Beut, me një natyre centripetale, por një forcë tërheqëse me shfaqje pasive.

Më shumë i pavullnetshëm në fillim, Azis Beu hyn në politikë, pas ngritjes së flamurit, duke provuar dhe, me qendrueshmëri, fisnikërinë themelore dhe po aq shumëvlerëse, në kushtet e një realiteti kontradiktor të regjistruar në të ashtuquajturin *Dekalog i Shqiptarit*, i shpikur prej tij.

Në mënyrë domethënëse, djali i beut studion histori. Ferdinandi, „trimi në paqe" (Frithu = Paqe dhe Nanth = Trim, në gjermanishten e vjetër) bartësi i emrit të vetëm të kaurit që ndërpret një vazhdimësi onomastike myslimane do të përkulet më mëdyshje dhe pa rezultat përfundimtar, mbi faktin historik që të gjithë personazhet e hetuara interpretojnë në mënyrë polikrome dhe kameleoniane, nga një shumësi këndesh optike, perspektivash dhe interesash.

Në incidencën e kësaj shumëllojshmërie, Dafina, një çingie, e cila "kishte provuar turq, grekë, francezë, italianë, një amerikan, dy bullgarë, një serb, shqiptarë po se po, me shumicë", ia përshtat rregullisht serinë panoramike të qilimave të saj nëpër mure realitetit historik, gjithnjë në ndryshim, të këtij shekulli të trazuar: "peisazhe nga më të ndryshmet. Venezia. Stambolli. (...) Një peizazh kinez ". Midis këtyreve ishin ndërfutur, me kalimin e kohës, një peizazh gjerman me një katedrale dhe një peizazh pyllor rus. Në të njëjtën mënyrë hanxhiu Luc Dema ndërron njëpasnjëshëm emrin e tavernës, e cila në fillim quhej «Stambolli», pastaj «Bella Venezia» dhe, së fundmi, «Volga». Dhe vetëm vdekja e ndalon atë që ta ndryshojë, përsëri, në "Pekin", pasi punëtorët do të vendosin një "yll" me pesë cepa.

Po kështu, gjatë gjithë historisë, tufa popujsh të huaj: romakë, sllavë, normanë, venedikas, turq, rusë ose kinezë kanë ushtruar ndikimin e tyre mbi tokën Ilire.

Ferdinandi shqyrton i çorientuar këtë mozaik interpretues, duke zbuluar, në një hulumtim të hollësishëm të personazheve konfuzë, asgjë më shumë se atë që Miguel de Unamuno e kishte quajtur "INTRAHISTORI", atë strukturë të thurur nga miliona ekzistenca të heshtura që bëjnë, në punën e tyre të përditshme, ekzistencën e Shqipërisë së thellë.

Dhe pasqyrimi i tyre në histori, një refleks i pasigurt, i gjithanshëm, i shtrembëruar, i përsëritshëm dhe i përpërsëritshëm, I PARA-FIGURUAR, I KON-FIGURUAR, I RI-FIGURUAR DHE I TRANS-FIGURUAR NË MJEGULLËN TË MBIPRANISHME, duke kontaminuar historinë me misterin e saj të plotë.

Risia e formulës narrative të propozuar nga Bashkim Hoxha, përmes këtij romani, tek lexuesi konsiston pikërisht në alegorinë relativizuese të këtyre metamorfozave të pashtershme, në avullin të vjetër, të ndryshueshëm të mjegullës.

"Lavderimet" e saj e hapin tekstin ose e ndërpresin atë, duke i dhënë kohë serisë së përshpejtuar të kërcënimeve të afërta ose mizorive që ndodhin, në mënyrë implicite, në ekzistencën historike, duke vendosur një ndalesë qetësuese, duke i pezulluar, me frymën e pastër të një psalmi.

Motivi i përsëritur, ose më saktë metafora e madhe tematike e mjegullës së kudogjendur, e mjegullës që del ngado, shpërndahet në askund dhe përhapet kudo, është futur në mënyrë të përsosur nga autori, duke përbërë ofertën e një filtri të mbinatyrshëm, në transparencën e paqartë të të cilit kodifikohet, fshehet ose zbulohet, duke u shpalosur para syve tanë në një mënyrë zbuluese, eksplicite.

Mbështetja lirike përbëhet nga pesë evokimet poematike të mjegullës. Ato ndajnë dhe përcaktojnë, në mënyrë aluzive dhe të pabarabartë katërpjesëshe, ekonominë e rrëfimit, duke pasur, në një farë mënyre, një vlerë parashikuese, paraardhëse të asaj që do të vijojë, në sekuencën e fakteve:

"Lavdërimi i parë i mjegullës"
"Lavdërimi i dytë i mjegullës"
"Buletini i mjegullës"
"Nëpër mjegull ecën fati im"
"Horoskopi i Mjegullës".

(Vijon në faqen 15)

In memoriam: PETRIT RUKA

Poeti i fjalës, i poezisë së bukur

Nga Sadik Bejko

1. Kur ikën një poet

Kur na ikën një poet, një mik, një bashkëkohës, nuk ka gjë më të mirë se të kthehesh e të lexosh edhe një herë poezinë e tij.

E lexon me ndalesa nga gulshet që befas të mblidhen në grykë. I ke lexuar më parë, i ke dëgjuar dhe të recituara nga kolegu yt poet që tashmë nuk është më dhe prapë ke dëshirë të lexosh një varg, një poezi, edhe një tjetër. Mund të ndalesh, të mendosh, të të pushtojnë ndjeshmëri e të të ngjallen shumë përfytyrime të shkuara që janë të tuat, vetëm të tuat. Mbase dhe ndonjë krisje në brinjë a në zemër, një therje si me thikë që ato poezi të kanë lënë në trungun tënd që kur i ke dëgjuar a lexuar për herë të parë. Se vërtetë, jeni miq, të një kohe a vendi, por ka dhe diçka që nuk duhet harruar, jeni në heshtje dhe rivalë. Poezia e atij që ke pranë, në se nuk të ka plagosur, nuk ka qenë poezi, nuk ka qenë prozë a tregim që merion vëmendje.

Tani që kolegu yt është një i ndjerë, ka ikur përgjithmonë, është shuar, ti lexon dhe një mjegulli, një vesë paqëtimi të ngjitet në sy. Dhe me vete thua atë urmin që në gjallje kurrë nuk e ke thënë: faleminderit o mik që ke qenë pranë meje, ta di për nder të madh që me vargun tënd më ke ngucur, më ke lënë pa mend, më ke bërë që edhe unë ta marr vrapin prapë nga e para në një maratonë poetësh që kurrë nuk ka të mbaruar.

Kështu me ndodhi këto ditë në ikjen e paralajmëruar të poetit Petrit Ruka. U ktheva të lexoj edhe një herë ato çka janë më e mira poezi e krijimtarisë së tij.

Poeti dhe vendlindja

Shkrime të tilla përcjellëse të një jete, të një poezie, fillohen me fjalët: unë jam njohur me poetin..., jam njohur këtu dhe aty.

Ne kemi lindur mund të thuash të njohur. Kam qenë mbi dhjetë vjet më i madh sesa ai. Ai ka lindur nëTuran, katër kilometra larg nga Tepelena, unë në malësinë e Gllavës, në kufi me Beratin, dyzetë kilometra larg.

Tepelena është një gjeografi e vështirë, e thyer si nga vetëtimat. Nën këmbët e fshatit Turan është lumi Vjosa, përballë tij nga lindja ngrihet si thikë gjer në qiell mali Shëndëlli. Në shpatulla, nga perëndimi, shtrihet Labëria, që shkon përtej maleve të Kurrveleshit e gjer në Vlorë, apo po deshe, dhe deri thellë në Jug, në Çamëri. Një trevë e mbjellë fort dhe rëndë me qafa e mjegulla malesh, me shumë folklor dhe me shumë legjenda e histori. Kush ka lindur poet aty, ka lindur i zënë peng në këto maja, hone e gryka, në këtë histori, histori që i gatuhet bashkë me baltën që bën lisat, që mandej i bëhet dhe gjeografi shpirtërore. Mali, bora, lumi, historia me mushka të ngarkuara me gurë e hekur, pemët e bukura të vendlindjes që prodhojnë gjethe e lule ku fshihen fruta, vizatohen e gdhenden me forcën e gravurave në eshtërat e atij djalit që ka lindur poet.

Kjo është një pasaportë që e jep vendlindja, para se ta firmosë nëpunësi i zyrës së Gjendjes Civile. Dhe Petrit Ruka poet e mbrojti, e rriti dhe e farkëtoi në vete deri në fund të jets së tij këtë vulë të fortë të vendlindjes. E mbrujti si pejsazh, si histori, si folklor, si vizion filozofik, si tejqyrë me të cilën mund t'i shohësh tej përtej vitet, shekujt, njerëzit, vajzat e bukura dhe gratë, plakat labe të fshatit dhe burrat e mëdhenj të shtetit.

"Shkolla" e Tepelenës

Më 1974, kur po punoja minator në Memaliaj, aty ishin trekatër poetë tepelenas. E dija që shkruante poezi inxhinier Martin Cukalla. Kisha parë në shtyp poezi të Petrit Rukës, të Qazim Shemajt nga fshati Qesarat, Perftef Liçi, nga Krahësi, më i ndrojturi i të gjithëve shkruante e fshihej si një trumzë mbas gëmushave.

Ilirian Zhupën 17-vjeçar menjëherë mbas gjimnazit e kishin futur nëntokë si minator, që të shtynte vagonat me qymyr. Këtë djersë adoleshenti, të përzjerë me qymyr të zi miniere, ai duhet ta flijonte te nëntoka pa asnjë mëkat, pa asnjë faj. Përse? Për një arësye, të paarësyeshme të asaj kohe, Iliriani vetëm me atë djersë mund "ta paguante", marrjen e së drejtës së studimit për në shkollën e lartë. Nuk mjaftoi kjo. Ai bëri dhe një libër me poezi... miniere.

Qazimi shkroi për "Daullen e festivalit", Petriti shkroi poezi për atdheun që fillon te zemra. Zyrtarë të kohës u thoshin që mua të mos më takonin, por ne takoheshim bashkë. Lexonim poezi. Ata që të tre, djem me ambicie, shkruanin, botonin dhe në shtyp filluan t'i quajnë shkolla e Tepelenës. Qazimi ishte gjithë "egërsi" burri, por me lofata e manushaqe Vjose, Petriti ishte temperamenti enthusiast me flokët kaçurrela, Iliriani meditativ, ardhur nga miniera, fliste më pak nga të gjithë.

Ajo që ua di për faleminderit, është se ne nga Tepelena, pavarësisht prirjeve a drejtimve që ndiqnim dhe ndoqëm, nuk e premë në besë njëri-tjetrin. Nuk e pamë njërin përballë tjetrit në gjyqe a në zyra shtetërore. Nuk u armiqësuam si shumë të tjerë të asaj kohe. Nuk u thyem para atyre që na donin me thonjtë në fytin e mikut a të kolegut.

Tipare të poezisë së Petrit Rukës

Si një që ka dhënë letërsi në Universitet, vihem shpesh përpara gazetarëve televizivë për të dhënë vlerësime mbi shkrimtarë, sido-

mos në raste kur ata ndërrojnë jetë. Është një punë e vështirë që të koncentrosh në pak fjalë veprën e një shkrimtari dhe mu në çastet ku ai nuk është më. Kjo më ndodhi dhe me Perit Rukën. Fjalët që mund të thuhen në raste të tilla janë nën pushtetin e dhembjeve dhe mund të thuhen me sy të veshur, si ato të xhamave fshehur nën avull. Duhet të kalojnë ditët, të ndahesh nga dhembja, për të qenë esëll, që të shprehësh diçka për të qenë.

Por, dhe pse jemi afër ngjarjes së hidhur, koha nuk pret për ta thënë fjalën e duhur mbi të, për ta bërë të denjë përcjelljen e kujtimit të tij, të një poeti që ka lënë vragë me penën e tij.

Për ta përmbledhur mendimin mbi poezinë e Petrit Rukës do të thoja se ai shkroi një poezi të ndjenjës, shkroi poezinë e motiveve labe me lëndë në legjenda dhe në histori, shkroi poezinë e vargut të bukur, një poezi që mund ta deklamoje.

Me që ishte edhe kineast, një art që kërkon patjetër imazhin, detajin, figurshmërinë e tejdukshme të ekranit, Petrit Ruka u dha jetë disa prej përfytyrimeve më të thella që janë të shkruara në metafizikën e shpirtit tonë, përfytyrime që jo çdo njeri mund t'i thotë, mund t'i bëjë të gjalla para syve tanë.

Në vitet e fundit në poezinë e tij pati një vërshim në ngjitje tema e dashurisë burrë-grua. Një nga poezitë e tij më të realizuara është ajo për gruan që "na e nxin jetën", por prapë e duam aq shumë. Poezitë erotike të Rukës janë nga ato që i japin një kulm jo vetëm poezisë së tij, por mund të renditen ndër lirikat më të qëlluara të kësaj teme në poezinë tonë. Në këto kohë të lëshimit "të frenave" ndaj erotizmit janë shkruar shumë poezi me këtë temë. Petrit Ruka ka sjellë poezi erotike elegante, ku cilësia e shkrimit është e një lartësie me nxehtësinë dhe energjinë pjellore që prodhon një ndjeshmëri e tillë.

Largimi nga natyra, shpopullimi i shumë vendbanimeve të hershme, braktisja e disa vlerave tradicionale ka sjellë revoltë e pezm te poeti. Kjo temë alternohet me vetminë dhe tëhuajëzimin që sjell jeta urbane. Në një vetmi të tillë të akullt e të muzgët poetit i fanepset e pluhuruar vetëm vetja e tij. Vargjet që e çojnë në vendlindje, në natyrë, te lumi Vjosa, te motra e vdekur, te nëna, te ati i braktisur në vdekjen e tij janë të një aktualiteti pikëllues që nuk mund ta ndryshojmë. Na mbetet vetëm fatalisht t'i nënshtohemi kësaj të keqeje... kundër natyrës sonë.

Ajo që ra në sy këto ditë të ikjes së tij ishte lehtësia me të cilën rrjetet sociale u përmbytën me poezinë e tij.

Pse ndodhi? Duke qenë një poezi e cilësisë më të mirë të shkrimit poetik, poezia e Petrit Rukës është një poezi e shkruar thjeshtë, e shkruar kulluar shqip, në një shqipe të bukur, tingëlluese. Poeti e pati kult thithjen e fjalës së bukur të folklorit, përtypjen e manjerës mjeshtërore të thurjes së vargjeve, të hartimit të figuracionit nga lirika tradicionale labe. Poeti e qëmtoi fjalën në këto livadhe të hershme. Sot fjala po bëhet metalike nga gjuha e vdekur mediatike, nga vërshimi i fjalorit teknologjik, nga ndërkombëtarizmat që na rrëmbejnë fjalë, konstrukte e frazeologji thjesht e kulluar shqip.

Këto modeleshkrimore dhe gjuhësore, fjalë, ndërtime folklorike të vjela nga këngët e mbledhura prej Thimi Mitkos i patën si lëndë të parë poetike edhe mjeshtra si Lasgushi, Konica, Fan Noli, Mitrush Kuteli etj.

Petrit Ruka piu ujë në kroje të tilla të lashta, por dhe në gurrat e poezisë së Naimit, të Ali Asllanit, të Çajupit etj.

Poezia e Petrit Rukës në këto vite të heqjes së barrierave ndikuese nga poezia botërore, bëri të kundërtën e asaj që bënë disa prej poetëve dhe prozatorëve që u lëshuan drejt imitimit a përqafimit të manierizmit të poezisë dhe të prozës botërore moderne të përkthyer.

Petrit Ruka në këtë fund të tij na erdhi si një poet i kulluar, disa do të thoshin poet "bio", poet shqiptar në vargëzim, në tematikë, në ndjeshmëri.

Në se poezia e tij ishte aq e rrjedhshme, e shlirët në derdhjen e saj, kjo mund të shpjegohet me punën e tij të pakursyer me fjalën, me vargun, mund të shpjegohet dhe me të gjitha ato që thamë më lart. Po mbase as këto nuk mjaftojnë...

Ai kishte lindur poet. Kishte lindur për ta ringjallur nga e para fjalën, vargun shqip.

SHAMI TË ZEZA QIELLORE

DY FJALË PËR LIBRIN

Ky libër poetik vjen pas 15 vjetësh që nga botimi i vëllimit të fundit "Në zemër bie shi" në vitin 2003.

Kam sjell këtu edhe një pjesë të krijimtarisë sime ndër vite, pak poezi të zgjedhura prej librave të mëparshëm, si një dëshmi e rreth katër dekadave kuturisjeje në rrugën e vështirë dhe të mrekullueshme të poezisë, e cila ka qenë një nga gëzimet e mëdha të jetës sime.

Njëherë u ndërmenda t'i "çukisja" sadopak ato për t'i përmirësuar, por pastaj hoqa dorë, i bindur se vetëm ashtu, të pahitura me moshën e tyre dhe timen kanë më shumë vlerë për të kuptuar se si rrjedh në kohë procesi misterioz i krijimit.

Pesëmbëdhjetë vjet nuk janë as shumë e as pak për të ngjizur një libër me poezi, i cili e ka të nevojshme të presë që të vijë Koha, e vetmja gjë që ndodh realisht në letërsi dhe që çuditërisht ka aftësinë e pashpjegueshme të zgjedhë vetë se çfarë do të shkojë para lexuesit, kur do të ndodh kjo gjë dhe në se do të ketë fat apo jo në takimin me ta.

Pa e ditur më parë, tani që po ndahet prej meje, po kuptoj se qenka një libër me këngë dashurie, një iso e gjatë malli për gjithçka vajti e shkoi, po mbi të gjitha për Gruan si rrënja e Jetës, një përpjekje për t'iu bashkuar korit mijëra vjeçar të himneve për të, një "mallkim" i bekuar i çdo poeti që nuk i shpëton dot kurrë magjepsjes së saj, gëzimit dhe vuajtjes më madhështore të çdo burri që nga djepi deri në varr…

E kur si shpëton dot kësaj mrekullie në jetë, vaj halli në këngë, e cila është ku e ku më e mundimshme për t'u ngopur dhe larë borxhet e jetës së tij me të.

Shpresoj t'ia kem dalë mbanë përmes frikës dhe ankthit më të thellë dhe më të bukur në këtë botë, asaj që ndjell fjala në shpirtin e çdo njeriu, i cili do që të këndojë a të qajë për të mos u ndjerë i vetmuar, që të ndahet e pjesëtohet sa më shumë me të tjerët, me dëshirën e pangopur qysh në lindje, që njerëzit ta duan sa më shumë, nëse kënga e tij iu ngjit pas shpirtit.

Këtë ai s'e di kurrë dhe më mirë që nuk e di, sepse përpjekja e tij do të ndalonte nëpër mundimet e tij të shumta fjalë pas fjale, do të dorëzohej dhe do të pushonte së kënduari.

Dhe kur pushon këngën, një njeriu, (pa le një poeti!) i ka ardhur koha për të vdekur, nga që nuk rron dot pa të.

Mezi pres ta kuptoj ose të ma thoni nëse ia ka vlejtur apo jo ky libër?

Autori



GJËRAT E MIA TË VOGLA

Erdhi koha t'i mbledh gjërat e mia të vogla,
si nëna, me bohçen e saj në sepeten
ku rrobat e vdekjes vinin era ftua.
Do nisem këto ditë t'i mbledh në vendlindje,
harruar atje, pikur për mua.

Them t'i mbledh përrenjtë e vegjël në një shishe,
t'i fus arat e vogla në një shamizë xhepi.
Të gjej këngët e parë
për drithërimën e një fqinje,
incizuar në gjethet e një plepi.

Do ta marr në xhep varrin e babait
si një kuti shkrepëse,
do t'i qep pas shpirtit përkëdheljet e Nënës,
do përdor si makinë qepëse zemrën time
me penjtë e artë të hënës.

Do t'i vë gjithë zogjtë në fole të veshëve,
aty do ta vë dhe gurgullimën e lumit,
do kopjoj tek sytë bel- kthesat e Vjosës,
tek meket pas zallit si gruaja
në dhomën e gjumit...

Do të shkoj t'i marr shokët, të gjallë e të vdekur,
t'i vë tek koka e krevatit si librat e fundit,
nuk kam ç'lexoj gjë tjetër në këtë shtëpi
me strehë të vogla,
sa krahu i pëllumbit...

Si Nëna, njësoj si Nëna, që i kish gati të tëra;
rrobat e zeza, shaminë e zezë,
palosur më dysh,
dy fletë lisi si kartëmonedha për taksën e Hadit,
m'i vini sipër sysh...

M'i fusni në xhep dy re të vogla Goliku*
si pak letër për këngën e pathënë
që varri se tret,
po nisem t'i mbledh gjërat e mia të vogla
është e vetmja punë e bukur që më prêt...

*Goliku,- mal në Tepelenë

TË VDESËSH NË JERUSALEM

- vaj për një ndarje -

E shenjtë humnera ku ke rënë
në ikjen tënde me nxitim,
përtokë është Molla që ke ngrënë,
e fundmja Evë e qiellit tim.

Si foshnjë ndër teka dëshpërimi
ia hipe Fatit si një kali,
pa ditur se si vetëmashtrimi
të thyhet si servis kristali...

Kur borë e parë s'të ish shkrirë,
në cërr të dimrave të tu,
ti shkele shpirtit tim të lirë,
ku ish tërfili gjer në gju.

Ti ndenje aq sa ç'rri një bletë
për pak aromë e pak nektar,
se trillet s'presin kurrë biletë,
se s'kanë atdhe e s'kanë orar....

Si të mos dije ç'është një dhimbje,
the: një më pak, si të ish lojë,
po kur e dije, pse më "linde,"
të vdekur, me monedhë në gojë?!

Ti kur e di që lind aborte,
mos "fli" me burra të vërtetë,
se këtë brengë si ikja jote,
s'ma tret as varri im i shkretë.

Por ja, tek ikën nëpër mjegull,
në zinë e dashurisë me kujë,
ku mbillem lis e mbijë si pjergull
ti bëhesh Hënë e ndrin nën ujë.

E falur qofsh përse nuk dite
si bëhet Fé një dashuri,
tek bie në flakën që më ngrite
unë hirin do ta bëj flori...

Veç ja, tani, tek varr - i – Krishtit,
të fundmen Lutje bëj për ty,
si unë të dashuroftë një tjetër
dhe kurrë mos u bëfshin dy...

Në Mur të Lotëve biblik,
të mbledhur shuk në një copë letër,
kjo këngë vajtimi, shkruar shqip,
mos e pastë një shoqe tjetër.

Dhe lamtumirë tek të them,
Maria Magdalena ime,
të vdesësh në Jerusalem...
të paktën vdekja është sublime...

PO PËRKTHEJ NJË GRUA

Tërë jetën
përkthejmë shenja në mendje,
hap e mbyll zemrën si një fjalor i pafund,
fillojmë me ujërat në barkun e nënës,
të parin e të fundit det që na tund...

Dhe bëjmë si bëjmë, sa shfaqet një grua,
që kthehet në kryeveprën
e letërsisë botërore,
skulpturë e përsosur gjer në majën e thoit,
lëmuar me puthje e dritëra hyjnore...

Ta dish sa po vuaj, moj grua e vogël,
tek përkthej mendjen tënde
plot dëshira biblike,
format e trupit që kopjohen me dorë,
si me qumësht blete
pas brinjëve nevrike...

Medet, të lexosh shijet e tua për burrin,
fshehur pas turpit,
si në zhguallin e një breshke,
është njësoj si ta shkruash "Iliadën" të tërë
në petalen e bardhë të një pjeshke...

Zoti im, si ta kryej këtë punë manastiresh,
pa e bërë dhi egroshe mendjen
sipër malit?
Kam frikë se do vdes te gjysma e qerpikëve,
te zilkat e kaçurrelave të ballit.

Si përkthehen gjinjtë me gjuhën e gojës,
pa i pirë përmendësh si foshnjë
te sisa e nënës?!
Pastaj vithet e kofshët buzë ndonjë lumi,
shqipëruar në gjuhën e barit e të hënës?!

Ah, hajde të t'i gjesh në fjalorët e rëndë,
ëndrrat sarhoshe
që të fryhen në mbrëmje,
pastaj të të akordosh mbi gjunjë si kitarë,
në re, në sol...
në dhembje!

Je deng i madh papirusesh me dëshira,
biblioteka e botës
në lëkurë të është shkruar.
Nuk di si do t'ia bëj te paragrafi i buzëve,
me fjalorët e Zotit në duar!

Po mbase bëhem një mjeshtër si Noli,
në të përkthyer e sipër
e mësoj mjeshtërinë.
Ndërkohë që të lutem
me fyej pëshpërimash
ma mbaj me iso nga poshtë dashurinë!...

Ej, miq të moçëm sa vera e Krishtit,
them ta lë poezinë ca kohë,
sa të qajë për mua!
Në më pafshi në rrugë të përhënur
mos pyesni!
Sa ua thashë, o njerëz,
po përkthej një grua...

ROMANI I BASHKIM HOXHËS PËRKTHEHET NË RUMANISHT

(Vijon nga faqja 13)

Ndërfutja lirike që rendit shpalosjen epike, lind kristalizime të "LAVDERIMEVE", me një bukuri të tillë që ky lavdërim trans-figurativ i mjegullës, i këtij elementi vëllazëror-të gjithëpranishëm, mund t'i shtohet si një plotësim të pastajshëm Këngës françeskane të famshme, ai Lavdërim i Krijesave të Ndërtuesit, Cantico delle Creature, Lavderimi i Krijimit (Laus Creaturarum) i Shenjtit serafik të Asizit, modeli i parë poetik i krishterë, mahnitës në thjeshtësinë e tij të përsosur.

Duke vendosur kështu midis krijesave, pranë "Messer-it Vëllait tonë Diellit, plot rrezet, me shkëlqim të madh" dhe "Motra Hënë, e qartë, e ndritshme dhe e bukur", pranë këtyre vatrave të mëdha të dritës dhe qartësisë, dhe një element të ri, të pasigurt dhe të përulur: "Mjegulla, Motra e Historisë, e gjithëpranishme, mbështjellëse dhe zbuluese". Ajo që u krijua nga Ndërtuesi dhe gjithashtu u vendos, për ne në Korin Lavdërues të Krijesave, në vëllazëri dhe për zgjimin e aftësive dalluese.

Sepse, që nga lashtësia e baladave, mjegulla vazhdon, si një element mbizotërues, mbi Shqipërinë mitike. Siç ndodhi edhe me Kështjellën e Rozafës, ndërtuar me hidhërim. Siç na tregoi Mitrush Kuteli: "Mjegulla ra mbi Bunën dhe e mbuloi plotësisht. Mjegulla qëndroi atje për tre ditë dhe tre net. Pas tre ditësh dhe tre netësh, filloi të frynte një erë e lehtë, e cila e shpërndau, e ngriti në qiell dhe e dërgoi lart në kodrën e Valdanuzit. Atje, në majë të kodrës, punonin tre vëllezër. Ata po ndërtonin një kështjellë. Ata ngrinin murin gjatë ditës, por natën shëmbehej ... "Shkrimtari shqiptar, i cili jetoi për shumë vite mes nesh në Rumani, ka kthyer në prozë baladën e famshme ballkanike të sakrificës për ndërtim dhe themelim, si baladë simotër të baladës rumune Mjeshtri Manole, në tokën shqiptare.

Prej asaj kohe deri më sot, mjegulla vazhdon dhe ushqehet, pandërprerë, nga papërcaktueshmëria mjegullore e ajrave, duke qenë motivi letrar më shqetësues nga të gjithë, dhe, i mbivendosur në histori, filtri më i qartësuar dhe më i çmuar.

Talenti i veçantë i Ismail Kadaresë evokon mjegullën, e thërret atë dhe e vendos gjithnjë në peizazhin shqiptar, duke e ri-përfytyruar atë edhe në zemrat e njerëzve, si dhe atë në mes të Natyrës: me mjegull, avull, re, tym, pluhur, ngjyrë qumështi, madje edhe me filtrin e lotëve në dritën e syve, të cilat ne i zbulojmë duke zbritur, pa marrë vesh, nga faqet e tij, mbi peisazhet e natyrës ose të njeriut, duke u grumbulluar deri në "prosopope" dhe duke personifikuar një Mbretëri të Mjegullave në vendin e tij.

Romani i Bashkim Hoxhës ringjall, në mënyrën më të përsosur, simbolin e vjetër, e ngarkon atë me vlerë narratologjike dhe në të njëjtën kohë u jep instrumenteve historike këtë simbol të të papërcaktuarit, në të cilin format nuk dallohen akoma, ose në të cilin format e vjetra që janë duke u zhdukur nuk janë zëvendësuar akoma nga forma më të sakta, duke thirrur në mënyrë imperative për dallimin e vetëdijes, për t'u ndriçuar dhe për t'u dalluar.

Duke ia sjellë ofertë, njekohësisht, zbulimin e misterit në çelësin lirik të "Lavdërimeve":

O mjegull!
E kam kërkuar tempullin tënd për të blatuar një sakrificë,
po ku ta gjej.
Tempulli yt është i lëvizshëm dhe ndërron formë si vetë ti.

Mjegull, hapu pak!
Hapu pak, ashtu siç hapet perdja e një skene për të zbuluar çfarë ka ngjarë.
Më zbulo peizazhe, histori, njerëz.
Mos i fshih!

Nuk do?

Më duhet t'i kërkoj ndihmë diellit.
Kur del ai, ti davaritesh.
Por dielli në këto anë është përtac.
Edhe kur del,
përmes mjegullës duket si një hënë e zbehtë.
E zbehtë.

Mjegull,
Më duhet e vërteta!

Tregimi i Kadaresë, "Ur-Libri" dhe vitvdekja e Borges, 1986

"UR-LIBRI" DHE VITI 1986

Nga ***Enver S. MORINA***

Jorge Luis Borges vdiq me 14 qershor 1986. Tregimi i Ismail Kadaresë "Ur-Libri" është shkruar rreth një muaj më pas, me 11 korrik 1986. Në tregim vijnë "*egërsimi i tiranit*" e "*netët me hënë*" dhe rrinë afër "*komunizmi*" dhe "*internimet*".

Nëse thuhet se një nga format më të hershme letrare është tregimi atëherë për ta shpjeguar dhe gjetur veten, shkrimtarët i rikthehen në vazhdimësi kësaj gjinie "të veçantë" duke i ngritur vlerat e të shprehurit rrëfimtar në majat e botës krijuese në miniaturë. Tregimet e "*Një mijë e një net*ëve" erdhën përmes librin në kohën moderne. Naim Frashëri e vjershëroj historinë e Skënderbeut. Mijëra vjet më parë Homeri rrëfej për një udhëtim plot gërshetime ndjesish e përjetimesh, të cilat u kthyen në një odisejadë sakrificash rrëfimtare për të gjithë brezat. Xhovani Bokaçio, Henri Xhejms, Franc Kafka, Horhe Luis Borhes dhe të tjerë. Tregimi erdhi në teatër nga anë të tjera të dramatizimit skenik. Në romane, si formati më i madh letrar, nëpër fragmente. Po, destopia e "pastër" e librit në tregim?! Me kështillën e Arbërit, tregimi "*Ur-Libri*" i Kadaresë në analogji me rileximin e munguar të tre tregimeve të Jorge Luis Borges "*Biblioteka e Babilonit*", "*Utopia e një burri të lodhur*" dhe "*Libri i rërës*"...

Rrëfimi dhe artifici fotografik i Arbër Salihut: Kur miku im Arbëri[1] fotografoj xhamin e dritares së trenit të linjës Durrës-Tiranë ishin në proces "parlamentar" që hapësirat e hekurudhave të asfaltoheshin. Vite më pas, u rrënua stacioni i trenit në Tiranë, sikurse edhe aksi hekurudhor në hyrje të Pogradecit. Ishin të njëjtë shina që nuk ekzistojnë më. Tonelata çelik derdheshin për skrap. Pak ditë më pas sivëllai i asaj fotografie u prezantua në Explorer Gjeografic, një artific i shpërfytyrimit të egërsisë ndaj lëvizjes të një treni!

Poeti Arbër Salihu mori shkas nga ribotimi i tregimit të Ismail Kadaresë "Ur-libri" në ExLibris, të më përkujtoj se këtë tregim duhet rilexuar nëse do ta njohësh jo vetëm Borgesin në shqip por "diskursin akademik të llojit të artificit në letërsi". Dita e diel ishte e largët dhe mbi komodinën "e punës së përditshme" përveç të gjitha botimeve të tregimeve në shqip të Borges ("Rilindja", "Onufri", "Botimet enciklopedike", "Eugen", "Botimet Dudaj", "Mësonjëtorja", "Bargjini", "Bota Shqiptare", "Dudaj", "Zenit", "Ilar", "Pika pa sipërfaqe") vura vëllimin e 9 të kompletit të Ismail Kadaresë dhe numrin 124 te "ExLibris"...

Nën shembullin e një kërkese të një politikani nga provinca[2], të gjithë deputetet e Parlamentit të Ri i duhej t'i nënshtroheshin një regjimi prove 48 orëshe në një bunker nëntokësor me një titull libri të përzgjedhur për lexim, si akt prove besueshmërie dhe sakrifice në mbrojtje të kërkesave të vetave që e kanë votuar dhe në shërbim të mirëqenies së tyre. Shëmbëlltyra i ngjasonte një rileximi të Ferrit të Dantes dhe përjetimit të inkuizicionit mesjetar. Ishte një mënyrë besueshmërie për vigjilencën që kanë deputetet dhe banorët që e rrethonin. E drejta e lejimit të një libri ishte një uverturë që ju gëzua fillimisht çdo deputet kur dihet se vdekja nuk të lë asgjë në varr. Pas një kohe shndërrohesh në kalcium dhe qindra vjet më pas në grimca të imëta bashkëdyzuar me dheun dhe asgjë. Ky "Dikushi" në tregim përballet me Eudoro Asevedon që është personazhi që i ngjason Borgesit, edhe pse shkrimtari argjentinas jo vetëm është i papërsëritshëm nga labirintet e pasardhësve por edhe i paarritshëm nga juria e nobelistëve para 14 qershorit 1986. Këtë nuk arriti as Umberto Eco për të gjallë, kur ngjarjet i vendosi në abacinë e trëndafiltë të shekullit XV.

Dy personazhet e "*Utopia e një burri të lodhur*" përplasen tek "*Ur-Libri*". Edhe si matematikë përmes algjebrës deskriptive.[3] Në vend që të thoshte si personazhi "*Mua s'më do gruaja*" e përgjithësoj konfliktin e çastit. Klithi "Mua nuk do t'më duan lexuesit!" Ndoshta jam çliruar nga vetja për t'i torturuar ata. Jo pa shkas njëri nga gazetarët më tha se tregimin kushtuar prindit dhe 17 Janarit "*Njollat e hirit pas shiut të akullit*" duhet rilexuar disa herë. Nuk pata guxim t'i them se edhe unë vet duhet rilexuar, pa mundur të ndryshoj a plotësoj!

Biblioteka totale dhe libri universal: Sipas shënimeve, tregimin Ismail Kadare e ka shkruar në korrik 1986, një muaj pas vdekjes së Jorge Luis Borges. Mund të jetë menduar kohë më parë, por ç'koincidencë, vjen si homazh post mortum!?

Ndoshta, me vdekjen e Enver Hoxhës çlirimi ëndërrohej më bindshëm, por historia e popullit shqiptar vështirë se do të shkruhej nga vet ata. Do të mungojnë portretet e jetës imagjinative që do t'i ngjasojnë veprës së shkrimtarit simbolist francez Marcel Schwob (1867-1905) "*Jetë imagjinare*" shkruar dhe i botuar tre vite para lindjes së Lasgushit dhe Borgesit.

Kështillën e mikut, Arbërit, se "*Ur-Libri*" i ngjason "*Bibliotekës së Babelit*" e anashkalova për një çast. Por ishte i pashmangshëm. Qoftë edhe si hapësirë e faqeve dhe numrit të shkronjave.

Vërejtja e Borges se njëri nga tregimet nuk përkthehet dot në gjuhët e tjera nuk kapërdihet lehtë. As në shekullin XXI. Me qindra e mijëra përkthyes në të gjitha gjuhët e folura të botës janë në kërkim të gjetjes së tregimit. Ishte përkthyer edhe në gjuhën e vdekur, siç është latinishtja, për ta rilexuar farmacistët. As titullin nuk e përcaktojnë dot. U dyshua për një kohë në "*There Are More Things*". Në gjuhën shqipe "*Ka edhe gjëra të tjera*" por edhe pse shkronjat dallonin, kuptimi mbetët i njëjtë. Kulminacioni i kritikut: Teksti është tekst! Dhe më tej diskursi akademik lartësonte krijimtarinë e shkrimtarisë së "Çarkut të Prishtinës" që tash(më)[4] nuk ekziston "më".

Përmes mendimfjalisë pyetëse "*A s'është kjo gjë, shpikja, gjetja, risia, kinserisia, kriptokinserrisia, me fjalë të tjera, marifeti (merre si të duash) më i madh që ka shpikur njerëzimi, në krahasim me të cilin gjithë freskimet e mundshme të gjinive letrare s'janë veçse çikërrima?*" dhe "*A nuk e kishte joshur mendjen e kaq krijuesve të mëdhenj ëndrra e librit të përgjithshëm, përmbledhës, total, me fjalë të tjera, të një ur-libri?*" Ismail Kadare e shtron dilemën për të shtrirë çështjen ekzistenciale në "një libër" tashmë si lidhje shpirtërore imagjinative të materiales reale.

Në tregim vijnë "*egërsimi i tiranit*" e "*netët me hënë*" dhe rrinë afër "*komunizmi*" dhe "*internimet*".



1 Arbëri nuk ka të bëj me personazhin tashmë të rr'nuar dhe hapësirën në pritje të rr'nimit nga libri i parë dhe i fundit me tregime shkruar në moshën 33 vjeçare e botuar në atë 55 vjeçare.

2 Në të vërtetë politikani ishte i ardhur në kryeqytet nga fshatrat e braktisura nga njerëzit, rrënuar nga periudha e demokracisë.

3 Algjebrës deskriptive, në vend të përshkruese në urbanistikën arkitektonike kishte munguar si lëndë në shkollimin edukativ universitar tek objekti në lindje të kishës ortodokse serbe në Prishtinë.

4 Kllapat në funksion të shpjegimit të përsëritjes më pas.

Librin e hamendësuar "*Historia e Perandorisë Osmane me TV*" e kishte braktisur.

Librin e vogël alla George Perec e kishte pëlqyer "rrëfimtari" domethënë Tjetri.

Libri i synuar, libri total, në pjesën e dytë të tregimit.

Shkallëzimi krahasimtar dhe hutia e rrëfimtarit: Tregimi "*Ur-libri*" ndahet në tri pjesë.

Pjesa e parë, si hyrje, dialog i dy personazheve në gjetjen e temës së nga shembulli i librit të hamendësuar, librit të vogël për librin e synuar, librin total.

Pjesa e dytë përmes pyetjes së personazhit shpjegohet përbërja dhe përmbajtja e librit total që thotë se "*më tepër se pasuria e të dhënave, librin tim e bëri total e kundërta e tyre, domethënë mungesa.*" Zbrazësia e botës është pjesa tjetër "e mbetur" e plotënisë.

Hutia si mohim "*s'po kuptoj asgjë*" dhe buzëqeshja ironike e autorit (jo i Kadaresë por i personazhit në tregim-vër. e. s. m.) citojmë: "*... sa më tepër që libri të shkaktonte habitje, mundësisht, shastisje të bashkëbiseduesit, aq më origjinal ishte*" dhe "*... mungesa, heshtja, shkretimi, sidomos për tre-katër mijëvjeçarët e fundit të njerëzimit, atëherë kur ai ka qenë edhe më i zhurmshëm, është karakteristika kryesore, baza e ngrehës së librit tim.*"

Shpërfaqja e krahasimit si figurë është funksionale dhe kontekstuale njëkohësisht në terrinën dhe jetësimin e projektit të përkohshëm të shkrimtarisë. "*... si të ishte shtatzënë me djallin*" del si një figuracion ndërlidhjeje të kredos së shkrimtarit e jo si konflikt i errët. Megjithatë, krejt vepra mund të jetë një pakt me djallin që fundi do jetë asgjëja. E pamundshmja.

Pjesa e tretë, si një "shkencë rigoroze" borgesiane. Origjinaliteti. Jo përmbajtja por forma, jo bota dhe njerëzimi "*nga njeriu i Neandertalit gjer në ditët tona*" por un-i krijues u shkrimtarit "*sasia e faqeve ose e rreshtave që i kushtohej çdo periudhe.*"

Mijëvjeçarët-dy faqe, çdo shekulli-gjashtë rreshta, historia e qytetërimit-tetë faqe, shekullit njëzet-pesë rreshta.

Nënteksti shpjegues i autorit në librin total sikur na kthen tek njëqind faqet e "mërzitshme" shpjeguese të fillimit të romanit "*Emri i trëndafilit*". Të dhënat "e tepërta" dhe "të errëta" sikur na mërzisin. A nuk janë monotone e lodhëse ajo hyrje e gjatë në abacinë e shekullit XV? Kështu duhet të jetë edhe libri total 200 faqesh në të cilat 192 faqe përshkruhet mprehja e kockave, fërkimi i drurëve për të ndezur zjarrin, në kërkim të origjinalitetit dhe provës matematikore. "*Gjithë shpikjeve të mëdha të botës, më vështirësi u takonin një ose dy rreshta, mprehjes së kockës në trajtë thike i kushtoheshin gati dhjetë faqe të librit.*"

Marrëzia dhe pikëllimi shkojnë bashkë në këtë tregim, siç veprojnë bashkë përsosmëria krijuese rrëfimtare e Kadaresë me zbrazësinë përmbajtësore të një shekulli në gjysmërresht a dyzet shkronja.

Libri si urëlidhje dhe dy citate: Dëlirë për një projekt-libër total jo vetëm që janë të pavdekshme por edhe i njëjtësojmë me përpjekjet që kjo të jetë arritur me Biblën, por edhe dromcat e palimpsesteve në një të ardhme të largët që mund të jenë sizifiane, shterpe dhe të munguara.

Kthimi në tokë, tokësorja, arrihet përmes autorit të librit total kur thotë se "*Mua s'më do gruaja*", një refleksion si anë e kundërt e projektit imagjinar, përmes veçimit të librit në çantë dhe porosisë për kafenë e tretë të autorit rrëfimtar me njeriun e pasionuar pas librit total, si ur-libër kadarean.

Me mikun Arbërin, pimë vetëm nga një kafe. Përplasja vazhdon në të drejtën e krahasimit të tregimit "*Ur-Libri*" me "*Bibliotekën e Babelit*" dhe "*Utopia e një burri të lodhur*". Nuk doja ta bezdisim njëri tjetrin për diç që na mungon. Të dhënat e tjera na plotësojnë. Kur mësova moshën e mikut u ndjeva i tepërt të vazhdoj më tej. Këmbë u ktheva në shtëpi për ta plotësuar boshllëkun e harresës që tashmë është bërë rutinë e pritshme. Për t'mos i ngjarë Godosë dhe rikthimit të shikuesve në kinema e teatrot moderne.

I Treti ndërhyri në mbrëmjen e të nesërmes së takimit kur na urdhëroj të lexojmë tregimin "*Libri i rërës*" duke klithur si një psikiatër në çmendi: "Mos shpresoni kot të "*Biblioteka e Babilonit*", Njëri dhe të "*Utopia e një burri të lodhur*", Tjetri! Origjinalet janë bashkëvarrosur me Borgesin. Vetëm Ai mund t'i ndryshoj!"

Në shënimin në kopertinën e prapme të botuesit "*Pika pa sipërfaqe*" për "*Tregimet*" (2021) shkruan edhe "*Libri i librave*" ishte një temë e preferuar dhe e ripërsëritur e Borges-it përgjatë gjithë jetës dhe krijimtarisë së tij. Ky është libri i librave të tij."

Dhe këshilla e fundit nga një citat në postimin e fundit të prof. Dr. Zahrie Kapllanaj te Umberto Eco: "*Kisha vendosur t'i lexoj kronikat mesjetare, për të marrë ritmin e tyre dhe pafajësinë e tyre. Ato do të flisnin në vend timin dhe unë do të lirohesha nga dyshimi. Liruar nga dyshimi, por jo nga jehona e intertekstualitetit. Kështu zbulova çfarë shkrimtarët kanë*





ditur gjithmonë (dhe na e kanë thënë përsëri e përsëri), librat gjithmonë u flasin librave tjerë dhe çdo histori tregon një histori që tashmë ka qenë treguar më parë."

Po lexuesi? Le të rilexojnë!

Krahasimi dhe paradigma borgesiane: Të gjitha veprat imagjinative janë krahasime. Edhe vet citati është krahasim në "përballje" me dukurinë, ngjarjen, personin a individin. Janë të shumta krahasimet në një vepër letrare, siç janë edhe në tregimin "*Ur-Libri*". Edhe vet personazhi rrëfimtar dhe vepra e tij 200 faqe është krahasim. Sipas personazhit tjetër që të dal "*përpara universit për të dështmuar*", atë që nuk e arriti Bibla, Floberi[5], Ezra Paundi[6], Borgesi, një institucion në SHBA, në një format origjinal shkrimi kishte arritur tek Ai i cili kishte hartuar një libër të vogël.

Krahasimet e përgjithshme ndërtekstuale:

-freskimet e gjinive letrare s'janë veçse çikërrima...

-shkrimi i një libri total me projektin e parë kishte dështuar...

Krahasimet "mekanike":

-*... brezat e ardhshëm do të qeshin me ne si me të mëparshmit...*

-*... njeriu rrinte me orë të tëra seriozisht, si i lajthitur...*

-*... Ishte njëlloj si të përpiqeshe ta kuptoje këtë botë vetëm nëpërmjet leximit të fjalorit ose të enciklopedisë...*

-*... ngjanin si vocërrima...*

-*... një libër i vogël alla George Perec ...*

-*... si të ishte shtatzënë me djallin...*

-*... Si të qe kapur në grackë...*

Figura tjetër mbizotëruese është refleksioni parandjejor në të cilin Ismail Kadare ndërton përsëritjen pararendëse, të pashmangshme. Derisa në romanet e tij të mëdha vijnë imazhe të tëra në këtë tregim këto bëhen urë lidhëse e mendimit të personazheve, dukurive e ngjarjeve.

"*S'është hera e parë që flasim për këtë.*", thotë njëri personazh. Dhe e përsërit si shpjegim: "*Në të vërtetë, s'ishte hera e parë që bisedonim lidhur me artificin* në letërsi." "*Tregoma më në fund atë djall*", mendon, por i thotë "*Tregoma më në fund librin.*"

Po cilat janë e veçanta dhe karakteristika kryesore e librit? Citojmë: "*...mungesa, heshtja, shkretimi, sidomos për tre-katër mijëvjeçarët e fundit të njerëzimit, atëherë kur ai ka qenë edhe më i zhurmshëm, është karakteristika kryesore, baza e ngrehinës së librit tim.*"

Me paradigmën borgesiane, sikur rrëfimtari ka ndërhyrë për të qenë i pranishëm vet Borgesi në tregimin e Ismail Kadaresë, edhe pse është shkruar një muaj pas vdekjes së shkrimtarit argjentinas. Personazhi **Librin e Rërës** e quan libër djallëzor te Borges, **Ur-librin** e krahason me djall te Kadare.

Shkrimtarëve që njohin gjuhë të huaja nuk ju besohet! Fjalë të mëdha, pabesia ndaj tyre, por janë vjedhjet, retushimet dhe në fund vet krijimtaria e tyre është palimpsest, është citat për të vetdëshmuar në heshtjen e lexuesit për ndikimet dhe un-in krijues. Këtë e ka thënë e përsëritur i pavdekshmi Jorge Luis Borges. Pse mos ta trashëgojmë Ne paraardhësit që për popujt e zhdukur as që kemi ekzistuar ndonjëherë. Ne të vdekurit!

Epilog që nuk përfundon dhe libri në proces: Shkrimtari shpalli vdekjen e tij. Të gjithë studiuesit flisnin që duhet ta ketë marr çmimin Nobel për letërsi! Nuk jepet çmimi për "dhunën" që ushtron në jetë. Ne nuk e dimë saktësisht për veprat "terroriste" te Platonit! Nuk e dimë se ka bërë ndonjë vepër që do të dënohej, siç u dënua Sokrati. Përkundrazi.

Jorge Luis Borges vdiq me 14 qershor 1986. Tregimi i Ismail Kadaresë është shkruar rreth një muaj më pas, me 11 korrik 1986.

Borges te tregimi "*Libri i rërës*" shkruan për Librin e Librave, për Librin e rërës, për Librin e pafundmë, për Librin e padurueshëm dhe për Librin e përbindshëm.[7]

Te "*Për kultin e librit*" përveç që flet për ... *librin që 's'mbaron kurrë ...*" Borges citon: "*Mos u jepni qenve për ushqim gjëra të shenjta! Mos u hidhni derrave margaritarët tuaj, sepse ata vetëm do t'i shkelni me këmbë, e pastaj do të hidhen kundër jush për t'ju sulmuar!*" (Mateu, 8:6). [8]

Kadare te tregimi "*Ur-Libri*" shkruan për Librin "asgjë", Librin për gjithçka, Librin e përgjithshëm, Librin përmbledhës, Librin total për Ur-Librin.

Tre citate origjinale për fusnotën e shtatë:

...Kur lind ideja për diçka, ajo diçka është në prag. (377-378)[9]

... ndoshta njerëzimi s'ka nevojë për librin total, kjo është ndoshta edhe arsyeja që ai s'është shkruar. (378)

... Shumë gjëra njerëzimit s'i ka arritur ende, po kjo s'do të thotë se s'ka nevojë për to. (378)

---

5 Shkrimtari francez Floberi (Gustave Flaubert 1821-1880) sipas njërit personazh të Kadaresë në tregim për tjetrin "*merrte veten më shpejt, se ç'e prisja, për të më kujtuar Floberin, i cili, i pakënaqur nga ato që kishte krijuar,* ëndërronte të shkruante një libër "për asgjë", por që do të ishte në të vërtetë një libër për gjithçka..." (Faqe 375, sipas vëllimit 9 të kompletit, botim i "Onufri")

6 Pikëpamjet politike bënë që puna e poetit dhe kritikut amerikan Ezra Paundi (Ezra Pound, 1885-1972) të mbetej në hije. Ernest Hemingëay, megjithatë shkroi se "vepra më e mirë e tij-Cantos-do të qëndrojë për aq kohë sa ekziston letërsia"

7 Në pasthënie të librit për tregimin, Borges thotë: "Libri i rërës", një vëllim faqesh të panumërueshme..." (përktheu Azem Qazimi).

8 "Sfida e krijimit", libër me ese, studime, kujtime e biografi të autorëve të shquar hispanikë, të përzgjedhur dhe të përkthyer nga spanjishtja nga Bajram Karabolli, "Ilar", Tiranë, 2013)

9 Faqet sipas vëllimit të nëntë të veprave të plota të Ismail Kadaresë ("Onufri", Tiranë, 2008)

PSE ROMANI "NJËQIND VJET VETMI" ËSHTË PËRJETËSISHT I DASHUR

Nga Veronica Esposito

Në kyre të këtij viti bëra vizitën time të parë në Kolumbi. Gjatë qëndrimit tim, u njoha me shumë nga emblemat rreth të cilave rrotullohet imazhi i këtij kombi të mrekullueshëm. Është, sigurisht, kafeja, një nga më të mirat në botë dhe e njohur kryesisht nga amerikanët prej Juan Valdez-it me mustaqe. Ka gjithashtu shumë qytetërime të lashta indigjene, artifaktet e të cilave mund t'i gjesh në muze kudo. Më pas është piktori me famë botërore Fernando Botero, i cili ka përshtatur stilin e tij unik për të përshkruar ikona kombëtare të panumërta, si dhe torturën e ushtruar nga ushtarët amerikanë në burgun Abu Ghraib të Irakut. Dhe mbi të gjitha, kur arrijmë majën, është shkrimtari më i dashur i Kolumbisë, Gabriel García Márquez.

Ka një anekdotë që prek në zemër madhështinë e këtij shkrimtari. Ndërkohë që shkruante *Njëqind vjet vetmi*, ai takohej rregullisht me mikun e tij, autorin e madh kolumbian Álvaro Mutis, duke e përditësuar për ecurinë tek i rrëfente për ndodhitë e fundit nga romani i tij. Kishte vetëm një problem: asgjë nga ato që García Márquez-i i tha Mutis-it nuk ndodh në libër. Ai qëllimisht kishte sajuar një roman-hije të tërë ndërkohë që shkruante një nga librat më me imagjinatë dhe të ngjeshur në historinë e letërsisë moderne. Kjo është një masë e sa realiteteve konkurruese ekzistonin në mendjen e etur të García Márquez-it.

Po shkruaj për këtë shkrimtar sot pasi doja të kuptoja se pse vepra e tij më e madhe, *Njëqind vjet vetmi* ka pasur një sukses kaq të mahnitshëm. Ky roman i shkëlqyeshëm pretendohet të jetë një përpjekje për të shprehur çdo gjë që ka frymëzuar García Márquez-in përgjatë fëmijërisë së tij. Është quajtur një zanafillë e ditëve të fundit, gjëja më madhështore në spanjisht që prej *Don Kishotit*, dhe unike edhe nga standardet e kolosëve të periudhës Boom. García Márquez-i e shkroi në një vit të rrëmbyer në Mexico City, gjoja duke tymosur 60 cigare në ditë, i izoluar dhe i mbështetur nga e shoqja e tij për nevojat e jetesës. Për të parafrazuar kritikun Harold Bloom, nuk ka një rresht të vetëm që nuk përmbytet me detaj: "Është e gjitha rrëfim, ku çdo gjë e mendueshme dhe e pamendueshme ndodh njëkohësisht."

Ka suksese, pastaj suksese të bujshme, dhe më pas ka anije kozmike për në Mars – *Njëqind vjet vetmi* klasifikohet tek e fundit. Llogaritjet e shitjes së tij janë rreth 50 milionë në të gjithë botën, që e rendit krah librave, si *Aventurat e Sherlock Holmes, Lolita, Të vrasësh zogun përqeshës* dhe *1984*. Programet mësimore mund të ndikojnë për një pjesë të këtyre shifrave, por kur merr parasysh shitjet e pakta të sivëllezërve të tij të bumit të madh – Carlos Fuentos, Mario Vargas Llosa dhe Julio Cortázar – mund të llogaritet diçka më shumë se edukimi i lartë. As nuk është e lehtë të shpjegohet përhapja globale e *Njëqind vjet vetmi*: botuar të paktën në 44 gjuhë, është vepra në gjuhën spanjolle më e përkthyer pas *Don Kishotit*.

Mendoj se ajo që mund të thuhet për këtë libër është se kap diçka jetike për eksperiencën historike të qindra miliona njerëzve, jo vetëm në Amerikën Latine, por edhe në tokat e tjera të kolonizuara. Nii Ayikwei Parkes, shkrimtari çmimfitues britanik i lindur nga emigrantë ghanezë, ka thënë për librin: "I ka mësuar Perëndimit si të lexojë një realitet alternativ nga i tyri, i cili si shkëmbim hap dyert për shkrimtarët e tjerë joperëndimorë, si unë, dhe shkrimtarë të tjerë nga Afrika dhe Azia." Ai shtoi se: "Përveç faktit se është një libër i mrekullueshëm, u mësoi lexuesve perëndimorë tolerancën për perspektiva të tjera."

Është e vërtetë se ky libër ka transportuar diçka thelbësore për Amerikën Latine drejt vendeve të largëta, por unë do të shkoja më larg se kaq – do ta quaja *Njëqind vjet vetmi* librin më gjerësisht të lexuar të historisë amerikano-latine. E shoh si një vepër ku tradita e rrëfimeve të themeleve antike, si *Eneida* e Virgjilit dhe *Iliada* e Homerit – ose edhe, meqë po flasim për këtë, Biblën – një version modern i këtyre veprave që ka filtruar historinë përmes regjistrave mitikë dhe heroikë. Shqyrtimi i tij më 1970 në *The New York Times* – viti kur amerikano-veriorët më në fund morën përkthimin "më të mirë se origjinali" (duke perifrazuar García Márquez-in) – dijetari Robert Kiely tha: "Ky libër është një histori, jo e qeverive apo institucioneve të tilla formale që mban regjistra publikë, por e njerëzve, të cilët si pasardhësit e hershëm të Abrahamit, kuptohen më mirë për sa i përket marrëdhënies së tyre me një familje të vetme... është një zanafillë amerikano-jugore." Dyzet e katër vjet më vonë, kur García Márquez-i vdiq, *Times* e rishkroi atë opinion në nekrologjinë e tyre për shkrimtarin e madh, duke e quajtur *Njëqind vjet vetmi* "saga përcaktuese e historisë shoqërore dhe politike të Amerikës Latine".

Historia themelore që García Márquez-i rrëfen nuk është aq heroike sa ato të Virgjilit dhe Homerit: përkundrazi, e tija është prej zhgënjimesh, procesi i ngadaltë i një kontinenti për të gjetur zërin e tij, tejkalimi i përpjekjeve për t'i imponuar një histori dhe trajektore. Por megjithëse García Márquez-i do të rrëfente histori dhe ngjarje aktuale historike në libër, ai nuk do të shkruante diçka që ndiqte skllavërisht faktet. Frymëzuar nga Kafka dhe Joyce, García Márquez-i besonte se që të fliste të vërtetën e tij "nuk ishte e nevojshme të demonstronte fakte: mjaftonte e që autori të shkruante diçka që ajo të ishte e vërtetë, pa asnjë provë tjetër përveç talentit dhe autoritetit të zërit të tij".

Kjo do të thotë se, edhe pse *Njëqind vjet vetmi* buron nga politika shumë të vërteta kolumbiane, e tejkalon kontekstin e saj politik. Vetë autori ka thënë se ideja e romanit duhet të "trazojë jo vetëm prej përmbajtjes politike dhe shoqërore, por edhe prej fuqisë së tij për të penetruar realitetin, dhe akoma më mirë, prej kapacitetit të tij për të kthyer realitetin me kokë poshtë që të shohim anën tjetër të tij". Dhe kjo shkon mu në zemër të dhuntisë së tij: një eksponent udhëheqës i realizmit magjik, *Njëqind vjet vetmi* është i mbushur me thesare mashtruese që magjepsin imagjinatën e lexuesit. Aq të gjata sa janë këto rrëfime – murtaja e pagjumësisë, ose një grua aq e këndshme dhe e bukur sa ngjitet drejt e në parajsë – ato kanë gjithashtu një lidhje të padiskutueshme me jetën tonë të përditshme prozaike. Kjo është çfarë mund të bëjë miti letrar, që historia faktike nuk e bën dot – siç thotë García Márquez, kjo letërsi e kthen realitetin kokëposhtë dhe na tregon çfarë fshihet nën të.



Çfarë mund të jetë një mit themelor më i mirë për një kontinent thellësisht të thyer përmes linjave politike, historike dhe etnike, që ndërkohë gjithashtu dëshiron të artikulojë një eksperiencë zakonisht të kuptueshme? Jo vetëm kjo, kjo histori gjithashtu lejoi ata në anën tjetër – ata që krijuan këto kushte për shtypje dhe shfrytëzime – për të kuptuar dhe për të vlerësuar gjithashtu këtë eksperiencë të përbashkët. Ishte përmes këtyre akteve të imagjinatës që García Márquez-i farkëtoi lidhje të komunitetit. Siç tha më 1982, ndërkohë që pranonte Çmimin Nobel për Letërsi, "poetë, lypës, muzikantë dhe profetë, luftëtarë dhe faqezinj... neve na është dashur të kërkojmë veç pak imagjinatë, pasi problemi ynë vendimtar ishte mungesa e mjeteve tradicionale për t'i bërë jetët tona të besueshme. Ky, miqtë e mi, është thelbi i vetmisë sonë".

Duke i dhënë rrëfime të reja botës, García Márquez-i ndihmoi t'ia lehtësonte atë vetmi. Kështu na frymëzojnë libra si *Njëqind vjet vetmi:* na ofrojnë imazhe të reja, mite të reja, ide të reja dhe forma të reja kuptimi që kundërshtojnë ato që na mbajnë të ndarë dhe në moskuptim.

Megjithëse një autor nuk ka nevojë të jetë i motivuar politikisht që të krijojë art të tillë, ky është një akt politik i natyrshëm, pasi politika është e krijuar nga rrëfime – më shumë se kaq, varet nga këto më shumë se çdo gjë tjetër – dhe kurdo që arti krijon rrëfime pushtuese të reja, kundërshton autoritetin e politikanëve tanë. Më lejoni t'ju shpjegoj çfarë dua të them. Sa herë që dëgjojmë fjalimet e politikanëve, fushatat politike, politizimin legjislativ, e kështu me radhë, nuk është asnjëherë larg ideja e "kontrollimit të rrëfimit". Zgjedhjet përbëhen nga përcaktimi i rrëfimit që ti do dhe shpresa se do të rezonojë me votuesit; pastaj, kur arrin në zyrë, duhet të kapesh pas komandave të rrëfimit në mënyrë që të përkrahësh me sukses politikat për të cilat do që të mbledhësh mbështetje. Vendosja e rrëfimit tënd të preferuar për kombin është shumë thelbësore për të transformuar vullnetin tënd në ligj.

Sipas këtij nocioni të politikave, rrëfimet janë gjëra jashtëzakonisht të fuqishme. Prandaj burra të pasur dhe të fuqishëm (thuajse gjithmonë janë burra) kanë investuar miliarda dollarë për të ndërtuar perandori mediatike për të kapur prej fyti rrëfime kombëtare të caktuara. Kështu mediat, si Fox News dhe Breitbart, kanë bindur miliona njerëz që disa minoritete abuzojnë me programet e ndihmave sociale, ose që deficiti kërkon gjithmonë të shkurtohen shpenzimet qeveritare (përveçse kur bëhet fjalë për ushtrinë), dhe që islamikët radikalë janë vazhdimisht në prag të pushtimit të kombit tonë. Kundër këtyre rrëfimeve, e majta luan të vetën, dhe nëse unë e quaj veten si progresiv është pikërisht sepse e shoh rrëfimin e së majtës për botën shumë më tërheqës, të dhembshur, autentik, të sinqertë dhe më produktiv se e djathta.

Në mbretërinë e rrëfimeve arti mund të bëjë ndërhyrjet më të fuqishme në politikat tona. Nuk dua ta ul një libër si *Njëqind vjet vetmi* në një kornizë "liberale vs. konservatore" – edhe pse ky libër merret shumë me "Luftën Dymijëditëshe" të Kolumbisë, e cila ishte pikërisht një luftë mes liberalëve dhe konservatorëve, si çdo vepër e vërtetë arti, ajo mposht binare të tilla të gatshme për të na treguar se bota është shumë më misterioze dhe e ndërlikuar. Dhe vërtet, duhet të ketë një masë tjetër të suksesit të García Márquez-it: që na ka dhënë libra që na prekin thellë, edhe pse ne nuk dimë asgjë mbi burimin e materialit. Romanet e tij kanë ndryshuar rrëfimet tona edhe kur ato u rezistojnë interpretimeve të thjeshta, duke u rritur me shoqërinë ndërkohë që vjetrohet dhe mbetet bashkëkohore dhe e përshtatshme. Të citoj sërish Bloom-in: "García Márquez i ka dhënë kulturës bashkëkohore, në Amerikën Veriore dhe Europë, po aq shumë sa në Amerikën Latine, një nga grumbujt e dyfishtë të rrëfimeve të nevojshme, pa të cilat ne nuk do të kuptonim as njëri-tjetrin as veten tonë."

Në historinë moderne, arti i madh ka treguar gjithnjë mënyra të tjera për të parë botën. Duhet të na kujtojë gjithmonë se askush nuk ka monopol mbi të vërtetën dhe që edhe rrëfimet politike që mbajmë më me vendosmëri prapë kapin vetëm një pjesë të kësaj bote që është shumë më komplekse se ç'mund të thotë mendimi apo gjuha. Të përjetosh një vepër të lartë si *Njëqind vjet vetmi* do të thotë të kujtohesh për përulësinë që duhet të ndiejmë të gjithë kur përpiqemi të pohojmë çfarë është e vërtetë e çfarë false. Sigurisht, kjo nuk do të thotë se progresivët nuk duhet të përkrahin botën që ne duam me pasion dhe bindje – politika pikërisht këtë kërkon – do të thotë se dhembshuria dhe empatia jonë duhet të jetë gjithmonë pranë nesh, pavarësisht më çfarë kemi të bëjmë. Dhe duhet të kërkojmë gjithmonë të zgjerojmë pikëpamjen tonë të botës nëpërmjet librave. Edhe në këtë epokë të mbingopur nga media – kur kemi filma, TV, Facebook, seriale, Twitter, e kaq shumë të tjera – nuk besoj se ka një medium më të mirë për të përcjellë rrëfime sfiduese, të nuancuara, origjinale dhe të rëndësishme në mendjet tona. Janë pikërisht këto histori që e mbajnë *Njëqind vjet vetmi* të re, dhe e mban botën duke e lexuar atë.

Përktheu nga anglishtja E.H.

DY TREGIME NGA FRANZ KAFKA

I përktheu nga gjermanishtja Arb Elo

ANASHKALUESIT

Kur shkon të shëtisësh përmes një rrugice, dhe një burrë, i cili shihet prej së largu - se rrugica bën përpjetë dhe është hënë e plotë -, një burrë të vjen përkundër, nuk do ta kapësh atë, edhe në qoftë i dobët dhe i rreckosur, edhe nëse e ndjek duke rendur dikush nga pas që klith, por do ta lësh të shkojë tutje.

Sepse është natë dhe nuk është faji yt që rrugica bën përpjetë kur është hënë e plotë - dhe për më tepër: ndoshta këta të dy e kanë sajuar përndjekjen për t'u zbavitur, ndoshta ndjekin të dy një të tretë, ndoshta i pari përndiqet ndërkohë që është i pafajshëm, ndoshta i dyti mëton të vrasë, ndoshta të dy nuk kanë të bëjnë me njëri-tjetrin e secili mban përgjegjësi vetëm për vete kur rend për te shtrati i vet, ndoshta janë somnambulë, ndoshta i pari ka armë.

Dhe, fundja, a nuk të lejohet të jesh i lodhur, a nuk ke pirë goxha verë? Je i kënaqur pra që nuk e shikon dot edhe të dytin.

BISEDË ME TË DEHURIN

Kur dola prej prej portës së shtëpisë me hapa të vegjël u mbërtheva prej qiellit me hënë dhe yje dhe kupolë të madhe dhe sheshit qendror me bashki, prej kolonës së Maries dhe kishës.

Dola i qetë nga hija në dritën e hënës, kopsita pardësynë dhe u ngroha; pastaj bëra të përheshtet zhaurima e natës duke ngritur duart e nisa të përsias:

›E pse bëni njëherë sikur të qenkëshit vërtet. Doni të më bëni të besoj që qenkam i pavërtetë, qesharak, tek po qëndroj mbi kalldrëmin e gjelbërt? Porse ka shkuar shumë kohë kur ti ishe vërtet; ti o qiell dhe ti o shesh qendror nuk keni qenë në të vërtetë kurrë.‹

›E vërtetë është, akoma vazhdoni të jeni më sipër se unë, por sidoqoftë vetëm atëherë kur unë t'ju lë të qetë.‹

»Falë Zotit, Hënë, ti nuk je më Hënë, mirëpo ndoshta është e pakujdesshme nga ana ime që ty të sapoquajtërën Hënë ta quaj ende Hënë. Pse nuk je më aq e mbizellshme kur unë të quaj: › fener prej letre i harruar me ngjyrë të çuditshme‹. Dhe pse thuajse zmprapsesh kur unë të quaj ›Kolona e Maries‹ dhe nuk e dalloj më qëndrimin tënd kanosës o kolonë e Maries kur unë të quaj ›Hënë që hedh dritë të verdhë‹.«

›Ngjan tani vërtet që nuk ju bën mirë kur njeriu përsiatet rreth jush; juve ju zbehet zelli dhe shendi.‹

›O Zot, sa e rëndë duhet të jetë kur përsiatësi mëson së pari prej të dehurit!‹

›Përse gjithçka është e kapluar nga heshtja. Besoj që s'ka më erë. Dhe shtëpizat që rrokullisen shpesh mbi rrota të vogla mbi shesh janë ngulur fort me këmbët në tokë - heshtje - heshtje - nuk duket fare viza e hollë, e zezë, që i ndan ato përndryshe nga dheu.‹

Dhe nisa të rend. Renda pa pengesa tri herë rreth e përqark sheshit të madh dhe, meqë nuk hasa asnjë të dehur, renda, pa e ndërprerë shpejtësinë dhe pa ndier mundim, drejt rrugicës Karlsgasse. Hija ime rendte shpesh më e vogël se unë vetë përndanë meje nëpër mur, si në një hulli midis tij dhe truallit të rrugës.

Kur kalova pranë godinës së zjarrfikësve dëgjova zhurmë që vinte përkëtej nga unaza e vogël dhe pasi ktheva atje pashë një të dehur që po qëndronte ndanë kangjellave të shatërvanit duke mbajtur krahët horizontalisht dhe duke i rënë tokës me këmbët e ngulura në pantofla druri.

Fillimisht ndalova për ta lënë frymëmarrjen të qetësohej, pastaj shkova drejt tij, hoqa cilindrin nga kryet dhe u paraqita:

»Mirëmbrëma, zotëri i fismë zemërbutë, jam njëzet e tre vjeç, por nuk kam akoma emër. Ndërsa ju vini me siguri me ndonjë emër habingjallës - me ndonjë emër këngëtor po - prej atij qyteti të madh: Parisit. Era tërësisht e panatyrshme e oborrit flirtrrëshkitës të Francës ju mbështjell të tërin.«

»Me siguri ju kanë rënë në sytë tuaj të ngjyrosur ato zonjat e mëdha që qëndrojnë tashmë në terracat e larta e të ndritura, teksa kthehen me ironi ndër fustanët e prerë ngushtë, ndërsa bishti i tyre i ngjyer shtrihet edhe mbi shkallaret dhe dergjet akoma mbi rërën e kopshtit. - Apo jo, nëpër shtyllëza të gjata, të shpërndara kudo, ngjiten shërbëtorë me frake të prerë thuajse me përbuzje në ngjyrë gri dhe pantallona të bardha, me këmbët që kapen rreth shtyllëzës, mirëpo me bust shpesh të përthyer përpas dhe përanash ngaqë u duhet të ngrenë përdheut dhe të tendosin lart nëpër litarë

pëlhura të stërmëdha gri, ngaqë kryezonja dëshiron një mëngjes të mjegullt.« Meqenëse ai gromësiu thashë gati i tmerruar: »Vërtet, a është kështu zotëri, vini ju nga Parisi ynë, nga Parisi i stuhishëm, ah, nga ai mot i breshërt përmallues?« Kur ai gromësiu prapë, thashë i menduar: »E di: po më bëhet nder i madh tani.«

Dhe kopsita me gishtërinj shpejt pardësynë, pastaj fola me zjarr dhe drojtur:

» E di, ju nuk më përfillni të denjë për ndonjë përgjigje, por mua do të më duhej të çoja një jetë të dënesshme, nëse nuk do t'ju pyesja sot.«

»Ju lutem, aq i stolisuri zotëri, a është e vërtetë çfarë më kanë treguar. Ka në Paris njerëz që përbëhen vetëm nga tesha të ojnisura dhe a ka atje shtëpi që paskëshin veç portale dhe a është e vërtetë që ditëve të verës qielli është endshëm kaltër, i zbukuruar vetëm prej resh të vockëla e të bardha e të ngjeshura, që kanë të tëra forma zemrash? Dhe a ka atje një panoptikum që vizitohet shumë, ku ngrihen veç pemë me tabela të vogla me emrat e herojve më zulmëmëdhenj, të kriminelëve dhe të dashuruarve?«

»Dhe për më shumë pastaj ky lajm! Ky lajm i gënjeshtërt, i gënjyer hapur!«

»Apo jo?... Ato rrugë të Parisit degëzohen papritur, janë të degëzuara; janë të shqetësuara, apo jo? Nuk është gjithnjë çdo gjë në rregull; e si mund të ishte edhe nëse?! Ndodh ndonjëherë një aksident tek vjen rrugëve anësore me hap qytetëmadh që cik kalldrëmin veç paksa; ndonëse të tërë janë në kureshti, janë poashtu në frikësim nga zhgënjimi; marrin frymë shpejt dhe zgjasin krerët e vegjël telart. Mirëpo kur prekin shoshoqin përkulen thellë dhe kërkojnë ndjesë:

›Më vjen keq, - ndodhi pa dashje - shtyhen njerëzia, kërkoj të më falni, ju lutem - ishte goxha e pasjellshme nga ana ime - e pranoj vetë këtë. Unë quhem - quhem Zherom Farosh, jam shitës erëzash në Rue du Cabotin - më lejoni që t'ju ftoj për drekë nesër - edhe ime shoqe do të gëzohet shumë.‹ Kështu llomotisin, teksa rrugica është e mpirë dhe tymi i oxhakëve bie mes ngrehinave. Kështu është, do-s'do. Dhe nëse do të ishte e mundur që të ndalonin përnjëherë në një bulevard të rrahur nga gjindja të një lagjeje të fisme dy pajtonë: së pari hapin sejmenët dyert. Tetë qenujqër siberianë lazdrohen përposhtë dhe turren për gjah duke lehur në shpurën ku vozitet me hove kërcyese. Dhe atëherë flitet që janë të rinj parizianë të uniformuar që s'para kuptojnë shumë.«

Sytë e tij ishin të mbyllur fort. Kur unë heshta, ai futi të dyja duart në gojë dhe u shkul në nofullën e poshtme. Veshja e tij ish e tëra e pisët. Ndoshta e kishin hedhur nga ndonjë pijetore vere përjashta dhe akoma nuk kish marrë veten nga kjo.

Ishte ndoshta kjo pauzë e vogël, plotësisht e qetë, mes ditës dhe natës, kur na varet kryet, kur nuk e presim, nëpër zverk dhe kur gjithçka, kur nuk e vëmë re, bie në qetësi, ngase nuk e vëmë re, dhe pastaj përshuhet. Teksa mbetemi me kurm të harkuar të vetmuar, pastaj hedhim sytë përreth, porse nuk shohim më asgjë dhe nuk ndjejmë as kundërshtinë e ajrit, ndërkohë që mbahemi nëpër kujtesë, e cila qëndron në një largësi të caktuar ndër shtëpi me çati dhe fatmirësisht nëpër oxhakët me kënde, nëpër të cilët rrjedh e errëta teposhtë ndër shtëpitë, nëpërmjet papafingove teposhtë në odat e ndryshme të sojsoshme. Dhe është fat që nesër do të bëhet ditë, përgjatë të cilës, sado e pabesueshme na qenkësh kjo, do të mund të shohim gjithçka.

Atëherë i dehuri ngriti vetullat aq lart, sa mes tyre dhe syve u sajua një shkëlqesë, dhe sqaroi copa-copa: » Kjo është me një fjalë kështu - unë jam me një fjalë përgjumësh, prandaj do të vete të fle. - Kam, me një fjalë, një kunat në sheshin Vencel - atje do të shkoj tani, se atje banoj, se atje kam shtratin tim. - Po Iki. - Vetëm se nuk e di si quhet, me një fjalë, dhe se ku banon - mua më bëhet se paskam harruar - mirëpo kjo nuk luan rol, se vetë nuk di as në kam ndonjë kunat. - Tani po shkoj, me një fjalë. - Çfarë besoni ju, do ta gjej atë vallë?«

Iu gjegja pa u menduar: »Me siguri. Porse ju vini nga larg dhe shpura juaj rastësisht nuk gjendet pranë jush. Lejoëni t'ju heq udhën.«

Ai nuk u përgjigj. Atëherë i zgjata krahun që të mund që të mbahej gjëkundi.

KËSHILLA TË MREKULLUESHME NGA 25 AUTORË TË FAMSHËM MBI ARTIN E TË SHKRUARIT

Nga Emily Temple

E përktheu Engjëllushe Shqarri

Ka libra të panumërt që marrin përsipër t'u mësojnë njerëzve si të shkruajnë. Shumë syresh janë të mirë. Disa jo edhe aq të mirë. Siç ndodh me gjithçka. Megjithatë, sa herë që has një libër mbi të shkruarin nga një autor veprën e të cilit e adhuroj emocionohem shumë. Dua të them, është një gjë kur merr këshilla nga një profesor, kritik apo redaktor, por një gjë krejt tjetër t'i dëgjosh ato nga dikush që ka punuar në minierë dhe ka nxjerrë flori – nga njerëz që mund të të mësojnë, por *edhe* nga ata që e vënë atë në jetë atë që thonë. Për këtë qëllim, kam përpiluar një listë me 25 udhëzues dhe libra të gjata frymëzues për këtë zanat nga autorë të famshëm, bashkë me disa këshilla nga secili libër. Një *amuse-bouche* [diçka për të ëmbëlsuar gojën]mund të them. Kini parasysh se kam përjashtuar antologji me ese nga autorë të shumtë, edhe kur një apo më shumë prej tyre (dhe/ose redaktori i librit) janë shkrimtarë të famshëm, si edhe libra që të mësojnë "se si të bësh diçka" nga autorë që njihen kryesisht për kësisoj librash si Natalie Goldberg dhe John Gardner. Lista sigurisht është në zgjerim e sipër dhe e paplotë (Shoh se Dean Koontz ka botuar një libër se si të shkruajmë *bestsellerë*, por nuk botohet më!), kështu që mund ta shtoni vetë në fund, si t'ju duket arsyeshme.



***Krijimi i subjektit dhe të shkruarit e letërsisë që e mban lexuesin në ankth*, Patricia Highsmith**

Për të pasur shtysën e nevojshme, rrjedhën e vazhdueshme që të mbaroni së shkruari një libër, duhet të prisni derisa ta ndieni se rrëfimi brenda jush është pjekur. Kjo gjë ndodh me ngadalë, gjatë periudhës së përgatitjes dhe krijimit të subjektit dhe nuk e nxitoni dot, sepse është një proces emocional, një ndjesi e brendshme përmbushjeje, njëlloj sikur një ditë të vjen t'i thuash vetes, "Kjo është vërtet një histori e madhe dhe mezi po pres që ta rrëfej!" Vetëm atëherë mund të nisni ta shkruani.

***Të shkruarit*, Marguerite Duras**

Personi që shkruan libra duhet të veçohet gjithnjë nga të tjerët dhe të mbyllet në hapësirën e vet. Me këtë kam parasysh një lloj vetmie. Vetminë e autorit, e të shkruarit. Si fillim, njeriu duhet të pyesë veten se çfarë është hapësira që e rrethon – konkretisht në çdo hap që bën në shtëpi, në çdo çast të ditës, në çdo lloj drite, qoftë drita që vjen nga jashtë, apo drita e abazhurëve të ndezur gjatë ditës. Një vetmi e tillë e vërtetë, fizike kthehet në heshtjen e padhunueshme të të shkruarit. Për këtë nuk kam folur me askënd. Në kohën e vetmisë sime të parë, ndërkohë kisha zbuluar se puna që duhet të bëja ishte të shkruarit. Por, këtë ma kishte konfirmuar edhe Raymond Queneau. Mendimi i vetëm që Raymond Queneau më ka dhënë ishte kjo fjali: "Mos bëj gjë tjetër përveç të shkruarit."



***Mbi të shkruarin*, Samuel R. Delany**

Përgjithësisht, rregullat e një shkrimi të mirë janë një numër gjërash që *nuk* duhen bërë. Në thelb, shkrimi i mirë ka të bëjë me shmangien e rrëmujës të panevojshme. (Por, kjo nuk do të thotë të shmangësh kompleksitetin.)

Shumë prej këtyre rregullave mund t'i programosh në kompjuter. Po t'i zbatosh pak a shumë në çdo draft të parë të shkrimit, këto rregulla të tregojnë se ku je duke rrëshqitur. Po t'i rishikosh me kujdes, do të përmirësohet qartësia, lexueshmëria dhe gjallëria e tekstit.

. . .

Një krijim letrar që ngjason shumë me çdo krijim tjetër letrar, si për sa i takon përmbajtjes apo stilit, subjektit apo qasjes retorike, është në vetvete i keq. Sado paradoksale mund të tingëllojë, një shkrim i *mirë* që u përmbahet një numri kufizimesh (dua të them, kur të shkruarit është i mirë, por asgjë më shumë) prodhon letërsi shumë të keqe. Vjen një çast kur të kuptuarit e kësaj gjëje më në fund i bën shumicën e shkrimtarëve t'i rrinë larg të shkruarit.

Ndërsa, *të shkruarit e talentuar*, është diçka tjetër. Duhet të kesh talent për të shkruar letërsi artistike.

Të shkruarit e mirë është i qartë. Të shkruarit e talentuar është energjik.

Shkrimi i mirë i shmang gabimet. Shkrimi i talentuar i bën gjërat të ndodhin në mendjen e shkrimtarit – me gjallëri, me forcë—gjë që nuk e bën dot shkrimi i mirë, i cili mbaron tek qartësia dhe logjika.



***Arti i biografive*, Mary Karr**

Një biografi e madhe jeton ose vdes 100 për qind në bazë të zërit që përçon. Ajo është sistemi i transmetimit të përvojës së autorit – kablloja me valë të gjata që transmeton me qartësi të shndritshme çdo piksel të përvojave të brendshme dhe të jashtme të dikujt. Çdo zë ndërtohet me zgjuarsi për të vënë në dukje talentin apo mënyrën e të parit të botës nga talenti personal i shkrimtarit. Një biograf e nis rrugën duke kërkuar kuturu—duke hedhur në letër fakte, duke ritreguar anekdota. Një shkrimtari mund t'i duhet të shkruajë me qindra faqe sprovë për të arritur një mënyrë të rrëfyeri e cila të shfaqet si një mënyrë unike e tij dhe e përvojave të tij, por kur shkrimtari ia del mbanë, si përvojat fizike edhe ato të brendshme i vijnë në mend me qartësi dhe vepra e tij përfton një ngarkesë elektrike. Për lexuesin, ky zë duhet të jetë i pranishëm që në fjalinë e parë.



***Zen-i në artin e të shkruarit*, Ray Bradbury**

Deri tani *keni* punuar apo jo?

Apo keni ndërmend t'i vini vetes një lloj plani posa që të mbaroni së lexuari këtë artikull?

Çfarë lloj plani?

Pak a shumë diçka e tillë. Një mijë apo dy mijë fjalë në ditë gjatë njëzetë viteve të ardhshme. Në fillim, mund të provoni të shkruani një tregim të shkurtër

në javë, pesëdhjetë e dy tregime të shkurtra në vit, për pesë vite. Do t'ju duhet të hidhni poshtë apo të digjni shumë pjesë nga materiali që keni shkruar, përpara se të ndiheni rehat me këtë formë komunikimi. Do bënit mirë t'ia nisnit që tani dhe të bëni punën që duhet të bëni.

Sepse unë besoj se më në fund sasia do t'ju shpjerë tek cilësia.

Si kështu? Miliarda skicat e bëra nga Mikelanxhelo, da Vinçi, Tintoretto i përgatiti ata për cilësinë, deri sa një ditë arritën të bënin skica unike, peizazhe unike me zotësi dhe bukuri të pabesueshme.

Një kirurg i madh hap e rihap një mijë, dhjetë mijë trupa, inde, organe, duke përgatitur kështu, përmes sasisë, çastin kur zotëron cilësinë e duhur për të bërë një ndërhyrje operatore tek një krijesë e gjallë.

Një atlet mund të vrapojë 16,000 km për t'u përgatitur për një garë 100 metrash.

Sasia ju jep përvojë. Cilësia mund të vijë vetëm nga përvoja.



***Nga vendi ku ëndërroni: Procesi i të shkruarit të letërsisë*, Robert Olen Butler**

Ju lutem, hiqni dorë nga zakoni i të thënit se keni *një ide* për një tregim të shkurtër. Arti nuk lind nga idetë. Arti nuk lind nga mendja. Arti lind nga vendi ku ëndërroni. Arti lind nga pavetëdija juaj; ai lind nga thelbi juaj përvëlues.

E keni të qartë? E kuptoni se çfarë po ju them? Nëse dëshironi të futeni në letërsi me mendime, nëse mendoni se mund ta analizoni rrugën që duhet të ndiqni për të krijuar një vepër arti, do të jemi plotësisht në kundërshtim nga pikëpamja filozofike me atë që arti është dhe me vendin nga lind. Por, nëse e keni një aspiratë të tillë dhe jeni i hapur ndaj ndjeshmërive dhe nëse e kuptoni këtë që po ju them, atëherë thojini mendjes të mos përzihet në këtë punë. Për të krijuar një vepër arti, duhet të kërkoni në një vend krejtësisht tjetër brenda vetes.



***Aspektet e romanit*, E.M. Forster**

Kujtesa dhe inteligjenca janë të lidhura ngushtësisht, sepse nëse nuk mbajmë mend, nuk jemi në gjendje të kuptojmë. Nëse në kohën që mbretëresha vdes, kemi harruar se është edhe mbreti, nuk kemi për ta kuptuar kurrë se nga se vdiq ajo. Krijuesi i subjektit pret nga ne që të mbajmë mend, ne presim prej tij që të mos i lërë gjërat të vagëta. Çdo veprim apo fjalë duhet të ketë rëndësi; duhet të jetë ekonomik dhe i kursyer; edhe kur është i ndërlikuar, duhet të jetë organik dhe pa gjëra të kota. Subjekti mund të jetë i vështirë apo i lehtë, mundet dhe duhet të përmbajë të fshehta, por nuk duhet të çorientojë. Dhe teksa ai shpaloset, kujtesa e lexuesit duhet t'i bëjë roje nga sipër (si ndriçimi i topitur i mendjes ku inteligjenca është cepi i dalë i ndriçuar) dhe të riorganizojë dhe rishqyrtojë vazhdimisht, duke gjetur ide të reja, zinxhirë të rinj shkaku dhe pasoje dhe kështu ideja përfundimtare (kur subjekti ka qenë i bukur) nuk do të përbëhet nga ide apo zinxhirë, por nga diçka estetikisht kompakte, diçka që romancieri mund të kishte bërë të njohur që në fillim, por po ta kishte zbuluar menjëherë, nuk do të arrinte të ishte e bukur.



***Të drejtuarit e zanatit: Një udhëzues i shekullit të 21 për të notuar në detin e rrëfimit*, Ursula K. Le Guin**

Gjithçka nis nga tingëllimi i gjuhës. Prova e një fjalie është, a tingëllon mirë? Elementet bazë të gjuhës janë fizike: zhurma që fjalët bëjnë, tingujt dhe heshtjet që i bëjnë ritmet të përcaktojnë marrëdhëniet mes tyre. Si kuptimi edhe bukuria e shkrimit varen nga këta tinguj dhe ritme. Kjo është e vërtetë si për prozën edhe për poezinë, ndonëse efektet zanore të prozës zakonisht janë më të pakapshme dhe gjithnjë të parregullta.
Shumica e fëmijëve e pëlqejnë tingullin e gjuhës në vetvete. Ata jepen pas përsëritjeve dhe fjalëve-tinguj të ëmbla dhe pas kërcitjeve dhe valëzimeve të fjalëve onomatopeike; bien në dashuri me fjalët muzikore apo që u bëjnë përshtypje dhe i përdorin në të gjitha vendet e gabuara. Disa shkrimtarë e ruajnë këtë interes të lashtë dhe dashuri për tingëllimat e gjuhës. Disa të tjerë e "humbasin" ndjesinë gojore/dëgjimore të asaj që lexojnë apo shkruajnë. Kjo është një humbje e pakthyeshme. Vetëdija e tingëllimës së asaj që shkuan është një aftësi thelbësore për një shkrimtar. Për fat të mirë, është shumë e lehtë ta kultivosh, ta mësosh apo ringjallësh.



***Të shkruarit e letërsisë*, Edith Wharton**

Origjinaliteti i vërtetë përbëhet jo nga një mënyrë e re, por nga një vizion i ri. Ai vizion i ri, personal arrihet vetëm duke parë për një kohë të gjatë objektin e përfaqësuar deri sa të bësh atë tëndin si shkrimtar; ndërsa mendja që do ta bëjë këtë farë të fshehtë të mbijë, duhet të jetë e aftë ta ushqejë atë me një pasuri të grumbulluar njohurish dhe përvojash. Për të ditur qoftë edhe një gjë të vetme, njeriu duhet të dijë diçka rreth shumë e shumë rreth gjërave të tjera, por, sikundër ka vënë në dukje Matthew Arnold shumë kohë më parë, duhet edhe të dijë më shumë më tepër për subjektin që do të shkruajë se sa mund të duket nga një paraqitje e pjesshme e tij; dhe thënia e z. Kipling "Çfarë duhet të dinë ata për Anglinë që vetëm Anglia e di?" mund të merret si një paralajmërim simbolik për artistin krijues.



***Këtë vit shkruani romanin tuaj*, Walter Mosley**

Gjëja e parë që duhet të dini në lidhje me të shkruarin është se është diçka që duhet ta bëni çdo ditë – çdo mëngjes apo mbrëmje, në çfarëdo kohe që kini. Në kushte ideale, koha që vendosni ta bëni është edhe koha kur keni për të bërë punën më të mirë.

Ka dy arsye për këtë rregull: të ndihmon të bësh punën dhe të lidh me mendjen e pavetëdijshme.

Nëse doni që romanin tuaj ta përfundoni brenda vitit, duhet t'i përvisheni punës! Nuk keni asnjë çast për të humbur. Nuk keni kohë të prisni sa t'u vijë frymëzimi. Hedhja e fjalëve në letër kërkon kohë. Sa kohë? Unë shkruaj tre orë çdo mëngjes. Është gjëja e parë që bëj nga e hëna deri të dielën, për pesëdhjetë e dy javë në vit. Ka ditë që nuk shkruaj, por ndodh rrallë që të mos shkruaj më shumë se një ditë në muaj. Të shkruarit është punë serioze që kërkon një farë vijimësie dhe disipline.

Megjithatë, vullneti dhe rregullsia janë vetëm fillimi i disiplinës dhe shpërblimeve që do t'ju sjellë të shkruarit e përditshëm.

Gjëja më e rëndësishme që kam zbuluar në lidhje me të shkruarin është se është kryesisht një veprimtari e pavetëdijshme. Çfarë kam parasysh me këtë? Kam parasysh se një roman është më i madh se mendja juaj (ose mendja e vetëdijshme). Lidhjet, gjendjet shpirtërore, metaforat dhe përvojat që kujtoni gjatë të shkruarit do t'ju vinë nga një vend në thellësi të brendësisë suaj. Ndonjëherë do të habiteni se kush i ka shkruar ato fjalë. Ndonjëherë do të rrëmbeheni nga pasioni i zjarrtë që lidhet me udhëtimin e ndërlikuar përmes zemrës së dashur të protagonistit tuaj. Çaste të tilla ju vinë kur jeni të lidhur me atë vend në thellësi të qenies suaj, një vend që ushqen zellin që ju ka nxitur fillimisht dëshirën për të shkruar.
Mënyra për të shkuar në këtë vend të pavetëdijshëm është duke shkruar çdo ditë.

***Letra një shkrimtari të ri*, Colum McCann**

Mos shkruani ato që dini, shkruani për të mësuar ato që *doni të mësoni.*

Dilni nga lëkura juaj. Kjo jua hap botën. Shkoni në një vend tjetër. Hulumtoni atë çka shtrihet përtej perdeve tuaja, përtej murit, përtej qoshes, përtej qytetit tuaj, përtej kufijve të vendit që njihni.

Shkrimtari është eksplorator. Ai e di se duhet të shkojë diku, por nuk e di as nëse ajo diku-ja ekziston.



Ajo duhet krijuar. Një Galapagos i imagjinatës. Një histori krejtësisht e re e asaj që jemi.

Mos e shpenzoni kohën kot, duke parë brenda vetes. Kjo është e mërzitshme. Në fund, kërthiza juaj do të ketë vetëm push. Duhet ta shtyni veten të dilni jashtë, shkrimtar i ri. Mendoni për të tjerët, mendo për një vend tjetër, mendoni për një largësi e cila më në fund do t'ju kthejë në shtëpi.



***Çfarë është*, Lynda Barry**

Është një pikënisje e mirë, sepse kur e di se çfarë ndjesie të shkaktojnë imazhet e vërteta, e ke më të lehtë të dallosh këtë ndjenjë kur shkruan letërsi. Kjo do t'i shërbente gjithkujt që ka ndonjë farë kureshtjeje rreth të shkruarit apo të mbajturit mend, veçanërisht njerëzve që kanë dashur gjithnjë të shkruajnë, por që kanë qenë tepër të paqartë qoftë edhe për të provuar dorën.

Çfarë është kjo? E zakonshmja është e jashtëzakonshme. E zakonshmja është e jashtëzakonshme. E zakonshmja është gjëja që kërkojmë ta kemi përsëri kur dikush vdes, apo na lë, apo nuk na dashuron më. Ne e quajmë atë "gjëra të vogla". Themi, "janë ato gjërat e vogla që më mungojnë më shumë". Gjërat e zakonshme. Është një gjë e vogël që na i sjell papritur në kujtesë. Ne themi, "na i kujton", por kjo është më shumë se rikujtesë – është një përflakje – një përmbytje. Edhe zjarri edhe përmbytja janë kujtesë. Është një shkëndijë dhe e çarë kaq e zakonshme sa që nuk e diskutojmë fare. Atomi ndahet. Gjëja e vogël.

***Feja e një shkrimtari: jeta, zanati, arti*, Joyce Carol Oates**

Çfarë këshille mund të marrë përsipër një shkrimtar më i vjetër t'i japë një më të riu? Vetëm atë që ai ose ajo do të kish dashur t'i jepnin vite më parë. Mos u dekurajoni! Mos vështroni vjedhurazi dhe mos u krahasoni me të tjerët ndër shokë! (Të shkruarit nuk është garë. Askush nuk "fiton" vërtet. Kënaqësia gjendet tek përpjekja dhe rrallë në shpërblimet e mbrame, nëse ka ndonjë të tillë). Dhe përsëri, *shkruani ato që ju thotë zemra*.



***Shkrimi i qetë: Rreziqet dhe kënaqësitë e jetës krijuese*, Dani Shapiro**

Një herë, gjatë një interviste kur Ann Sexton-in e pyetën se si kishte mundur të shkruante poezi kaq të errëta dhe të dhimbshme, ajo u përgjigj se dhimbja gdhend kujtime më të thella. *Dhimbja gdhend kujtime më të thella*. Mendoni për një kohë në jetën tuaj kur keni përjetuar një tronditje të beftë, një tradhti, një lajm të tmerrshëm. Ndoshta ju kujtohet koha, lloji i flladit, një tavllë duhani gjysmë plot, një e gërvishtur në dyshemenë prej druri, pulovra e ngrënë nga mola që kishit veshur, një sirenë në distancë. Dhimbja gdhend detaje, po. Por, do të thosha se këtë e bën dhe një gëzim i madh. Emocioni i madh, ka thënë Virginia Woolf, duhet të lërë gjurmë. Filloni të shkruani, mos lëvizni dhe rrini i qetë, shtyhuni përpara drejt atij emocionit të fortë dhe do ta zbuloni përsëri.



***Rregullat e vallëzimit: Udhëzues për shkrimin dhe leximin e vargjeve metrike*, Mary Oliver**

Rishikimi është absolutisht i domosdoshëm. Nëse diçka është tepër e lehtë për ta ndryshuar, falënderoni zotat, por mos prisni t'ju ndodhë përsëri. Përkundrazi, prisni që të keni nevojë ta përmirësoni atë që u është dhënë, të vazhdoni strukturën e papërsosur që ka prodhuar puna juaj fillestare. Në fund të fundit, kjo është ajo që përbën shkrimin e poezisë – të marrësh pasionin dhe, pa e lënë të ftohet, ta derdhësh në një kallëp. Për një punë të tillë do t'ju ndihmojnë të gjitha pasuritë e zakonshme: energjia, ndershmëria, durimi. Por asnjë nuk është me aq dobi sa interesi për gjuhën, i cili është pothuaj mani. Në fakt, është thelbësor. Sepse ndjenjën nuk e nxjerr në pah emocioni. Atë e nxjerr stili.

***Ron Carlson shkruan një histori*, Ron Carlson**

Shkrimtarëve u thonë të shkruajnë për ato që dinë dhe, në vështrim të parë, duket një këshillë e mirë. Është e mirë për faktin që, duke ua dhënë këtë këshillë nxënësve, mësuesit i paralajmëronin ata të mos vazhdonin të shkruanin letërsi fantastike shkencore pa ndonjë vlerë (ndalimi i kohës tek *Planet Dwindgore,* që na ngatërroi të gjithëve) dhe nga historitë televizive (Dil përjashta,



Roki, e kemi rrethuar vendin!), nga e cila askush nuk mësonte gjë. Ata donin që nxënësit e tyre të vinin më pranë shtëpisë, të fillonin të përdornin gjuhën për të zgjidhur histori të vështira të jetës së tyre. Dhe unë për këtë jam: Shkruani për ato që dini, por, do të shtoja: Si mund ta dini çka dini përpara se ta keni shkuar atë? Çfarë mund t'ju mësojë procesi i të rrëfyerit? A dini gjithçka deri në çastin përpara se të filloni të shkruani një histori? "Të shkruarit e asaj që dini" tepër shpesh shndërrohet në kontroll të elementëve të historisë dhe kjo e pengon shkrimtarin të shkojë përtej fakteve dhe gjërave të lidhura ngushtë me faktet, tek një vend që është më pranë të vërtetës së historisë së tij. Unë do ta formuloja kështu këshillën: shkruani *në drejtim* të asaj që dini, duke krijuar një inventar, dhe përdoreni me kujdes imagjinatën e cila mund të bëhet një instrument i fuqishëm ndijimi.



***Libri çudibërës: Udhëzues i ilustruar për krijimin e letërsisë imagjinare*, Jeff VanderD**

Siç është vënë në dukje. imagjinata, mishngrënësi më i panginjur, mund të ushqehet pothuaj me gjithçka dhe gjithçka mund të kthehet në narrativë. Akti i të bërit shkrimtar—i angazhimit ndaj mësimit të zanatit apo artit të të shkruarit—ka të bëjë kryesisht me krijimin e strukturës së asaj që pjell imagjinata dhe është një proces i vazhdueshëm për të arritur një mjeshtëri të pakapshme (ka gjithnjë një derë tjetër). Por, lindja e këtyre shkëndijave fillestare është një nga të paktat pjesë të shkrimit që lehtësohet me përftimin e përvojës—me kusht që ky impuls të mos ndrydhet. Që do të thotë, nëse e shpërbleni imagjinatën duke ia hedhur idetë në letër dhe duke ia shtjelluar më tej, qoftë dhe fragmentin më të vogël, imagjinata do t'ju shpërblejë me një rrjedhë pak a shumë të vazhdueshme idesh. Nëse e largoni apo e mpakni entuziazmin e nënvetëdijes për t'u angazhuar në një lojë krijuese, rrjedha mund t'ju thahet.

***Mbi të shkruarin*, Stephen King**

Vriti të dashurit e tu, vriti të dashurit e tu, edhe kur të ther në zemrën tënde egocentrike prej kalemxhiu të vogël.



***Mbi të shkruarin*, Eudora Welty**

Si tregimtare, për mua, përgjithësimet rreth të shkruarit janë të vonuara dhe më vënë në siklet dhe, po të tregohesha e zgjuar, do t'i kufizoja duke thënë se, çdo përfundim tek i cili besoj, është pjesë përbërëse e tregimit në fjalë, e pandarë nga e tëra. Mësimi më i besueshëm që kam nxjerrë nga puna deri tani është i thjeshtë, shkrimi i çdo tregimi pa dyshim të hap një perspektivë të re, por dhe të krijon një problem të ri; dhe se asnjë tregim i shkuar nuk lidhet në ndonjë mënyrë të njohur me një tregim të ri dhe nuk të premton ndonjë ndihmë në çastin që mendja shkruese mund të ketë nevojë dhe dëshirë që t'i vijë ndihma. Ndihma që ofrohet nga jashtë kornizës së tregimit do të ishte në vetvete një ndërhyrje.



***Më rrënqeth: Ese mbi letërsinë*, Benjamin Percy**

P: Cili është çelësi i mbajtjes në ankth? P: Ta tregoj më vonë.



***Të lexosh si shkrimtar: Udhëzues për njerëzit që i duan librat dhe për ata që duan t'i shkruajnë ato*, Francine Prose**

Për çdo shkrimtar, aftësia për ta parë një fjali dhe dalluar atë që është e tepërt, atë që mund të ndryshohet, rishikohet, zgjerohet dhe, sidomos, të hiqet, është thelbësore. Është kënaqësi ta shohësh atë fjali të shkurtohet, të zërë vend dhe, më në fund, të dalë në një formë më të lëmuar: e qartë, ekonomike, e mprehtë.



***Jeta e shkrimit*, Annie Dillard**

Shkrimtari hedh poshtë pikërisht fillimin e një vepre. Piktura i mbulon gjurmët e saj. Piktorët punojnë nga poshtë lart. Versioni më i fundit i një pikture u mbivendoset versioneve më të hershme dhe i zhduk ato. Ndërsa shkrimtarët punojnë nga e majta në të djathtë. Kapitujt që duhen flakur janë në të majtë. Versioni më i fundit i një vepre letrare fillon diku nga mesi i veprës dhe forcohet nga fundi. Versioni më i hershëm vazhdon të mbetet si një gjë e ngathët në të majtë; fillimi i veprës e përshëndet lexuesin duke i dhënë dorën e gabuar. Në faqet dhe kapitujt e parë gjithkush mund të gjejë kapërcime të guximshme drejt askundit, të lexojë fillimet guximtare të temave të braktisura, të dëgjojë një ton të braktisur me kohë, të zbulojë rrugë qorre, të dallojë copëza të kota dhe me mundim të mësojë një mjedis që del se është i pavërtetë.

Ka shumë iluzione që ia dobësojnë vendosmërinë një shkrimtari për të flakur tej një punë. Kur i ka lexuar tepër shpesh faqet e shkruara, ato faqe do të kenë një cilësi të nevojshme, tingëllimin e të paevitueshmes, si një poezi e mësuar përmendësh; ato faqe do t'i përligjin përsosmërisht ritmet e tyre të njohura. Shkrimtari i ruan ato faqe. Mund t'i mbajë kur përmbajnë në vetvete disa virtyte që u japin forcë, por tekefundit, atyre u mungon virtyti bazë, lidhja dhe harmonia me thelbin e librit. Ndonjëherë shkrimtari i lë kapitujt e fillimit nga mirënjohja; nuk i sodit apo lexon dot ato pa ndier përsëri lehtësimin e amshuar që e bëri me krahë kur filluan të shfaqen fjalët e para – lehtësim për faktin se ishte në gjendje të shkruante diçka. Në fund të fundit, ai fillim e ndihmoi të arrinte aty ku kish ndërmend të shkonte; me siguri edhe lexuesit i nevojitet si një bazë. Por jo, nuk i nevojitet.



***Udha e të bërit shkrimtar: Reflektime mbi artin dhe zanatin e rrëfimit*, Charles R. Johnson**

Po të mos e kontrolloj veten, fjalët në krijimtarinë time letrare priren natyrshëm të jenë të gjata, me imazhe dhe ide të mbivendosura mbi imazhe dhe ide të tjera, duke u tendosur dhe përdredhur, ndonjëherë duke u gërshetuar dhe kaluar në mënyrë dialektike nga teza në antiteza, të lezetuara me presje dhe gjysmë presje dhe kllapa për paranteza (si kjo), deri sa vjen një çast kur nuk mund të ndërfutësh më gjë tjetër në to. Gjithnjë e kam parë fjalinë dhe paragrafin si njësi energjie që duhet çliruar. Po, e vërtetë, i përdor fjalitë e gjata për ritëm dhe muzikalitet. Por, pothuaj gjithnjë pas tyre, vendos një fjali të shkurtër. Sikurse u thosha studentëve të mi, në këtë rast, teknika është që të marrësh një fjali të thjeshtë, pastaj ta "komplikosh" (d.m.th, ta zgjerosh) kryefjalë, folje, pastaj kundrinë.
Që të jem e sinqertë, mendoj se fjalia e gjatë, elegante është diçka e bukur në vetvete. Një subjekt i plotë që vlen të studiohet më vete.



***Zog pas zogu: Disa udhëzime mbi të shkruarin dhe jetën*, Anne Lamott**

Përsosuria është zëri i shtypësit, armikut të popullit. Do t'ju mbajë të ndrydhur dhe të papërgjegjshëm gjatë gjithë jetës, duke qenë pengesa kryesore midis jush dhe versionit të parë, shumë të dobët krijues. Mendoj se përsosuria mbështetet në besimin e ngulët se, nëse vrapon me kujdesin e duhur, duke shmangur çdo gur gjatë rrugës, nuk do të vdisni. E vërteta është se gjithsesi keni për të vdekur dhe se ka shumë njerëz që as nuk e shohin rrugën nën këmbët e tyre dhe ia dalin shumë më mirë se ju dhe ndërkohë bëjnë edhe shumë më qejf.

***Versioni nr.4: Mbi procesin e të shkruarit*, John McPhee**

Kur jeni në kërkim të fjalëve, fjalorët me sinonime dhe antonime janë të dobishëm, megjithatë, ata nuk i shpjegojnë fjalët që renditin. Gjithashtu, janë edhe të rrezikshëm. Ata mund t'ju bëjnë të zgjidhni një fjalë shumërrokëshe dhe të paqartë kur një fjalë e thjeshtë dhe e qartë do të ishte më e mirë. Vlera e një fjalori në këtë rast nuk është që ta bëjë shkrimtarin të duket se ka një fjalor të pasur me fjalë të paqarta. Vlera e fjalorit qëndron në ndihmën që mund t'ju japë për të gjetur fjalën më të mirë të mundshme për misionin që ajo fjalë duhet të përmbushë. Mësuesit e të shkruarit dhe të gazetarisë njihen për krahasimet e tyre me patericat, duke lënë të kuptohet se asnjë shkrimtar me personalitet apo i zoti nuk do t'i përdorte ato. Në më të mirën e tyre, fjalorët janë ndalesa pushimi në kërkim të fjalës së duhur. Fjalori është pikëmbërritja juaj. Supozoni se shihni një mundësi për përdorimin e një fjale tjetër nga fjala "synim". Lexoni listën e sinonimeve të fjalorit: "synim, qëllim, skemë, objektiv, objekt". Por, fjalori nuk e lë me aq. Ai vazhdon t'ju tregojë dallimet midis tyre deri në fund—se si secila nga fjalët e renditura aty ndryshon nga të tjerat. Disa fjalorë nuk e zgjasin, duke dhënë thjesht sinonimet, pa bërë dallimet mes tyre. Ju doni llojin e parë ku merrni jo thjesht një listë fjalësh; ata që ju tregojnë dallimet mes tyre, thua se po shihni vijat e një tende, ku secila është në ngjyrë të gjelbër me një nuancë të ndryshme. Kontrolloni fjalën "vertikal". Fjalori ju thotë – besojeni apo jo - se "vertikal," "perpendikular," dhe "pingul" ndryshojnë secili nga dy të tjerët. E njëjta gjë, "plastike, e epshme, e përpunueshme, e lakueshme, elastike, e punueshme, që përshtatet". Po ashtu, "besnikëri, bindje, përkushtim, devocion, besim i thellë".

JOVAN M. BIZHYTI

Gjeneral Spiro Moisiu